

ETIKA

Dymujore

Fryma e mëshirës dhe e tolerancës

Ngadhënjimi mbi njeriun

Mëso të jesh shpirtmadh

Të kapërdish zemërimin

Kto njerëz janë jetim...

Imam Vehbi Ismaili

Arkitektura e hershme Islame

Mirëkuptimi



Editorial

I dashur lexues!

Këtë numër të revistës Etika e kemi ndarë për të trajtuar temën e mirëkuptimit, një temë sa e gjerë aq edhe shumëdimensionale, nevoja për të cilën haste çdo ditë duke filluar nga jeta personale deri në marrëdhëniet shumë të gjera mes shteteve dhe kombeve.

Në këto ditë është shtuar përherë edhe më shumë nevoja për mirëkuptimin, e cila në të shumtën e rasteve shprehet me fjalën tolerancë. Bëhet fjalë për tolerancë fetare, etnike etj. Megjithatë çdo person që ndalon një çast dhe mendon rreth atyre që ndodhin në realitet nuk do ta ketë të vështirë ta kuptojë se organizimet dhe aktivitetet e shumta që mbahen në emër të tolerancës dhe mirëkuptimit janë shumë larg asaj që synohen apo shpallin publikisht. Mbase shumëkujt mund ti bie në sy sjellja e dyfishtë e shteteve perëndimore ku sundon demokracia, që të paktën në kuptimin e përgjithshëm të saj do të thotë se pakica bën edhe atë që vendos shumica si e drejtë, ndërsa po këto shtete në vendet e botës së tretë dhe në veçanti ato islame kërkojnë të shpaloset fryma tolerante ku pakicat duhet të miklohen mbase edhe të barazohen me shumicën zgjedhëse.

Fryma e mësimave islame e shprehur qartë në tekstet e shenjta dhe burimore të këtij besimi, pra në Kuran dhe traditën profetike (hadith), por edhe përvoja disa shekullore e konkretizuar në veprime e shteteve dhe perandorive të kaluara të botës islame tregojnë më së miri se fryma e mirëkuptimit tek muslimanët ka ekzistuar përherë, madje e shprehur edhe në formën më të lartë të saj, në lejimin e të jetuarit sipas botëkuptimit fetar apo mënyrës etnike të pakicave që përfshihen brenda kufijve të shteteve muslimane.

Nisur edhe nga debatet e kohëve të fundit të nisura nga disa botime dhe të lançuara aq sa diskutimi të mbulonte edhe fusha më të gjera të trajtimit i kemi ndarë një vend edhe shkrimeve që trajtojnë frymën mirëkuptuese me të cilën qe e mbrujtur perandoria osmane, kjo për faktin se dokumentimi i kësaj periudhe është më i lehtë, por edhe për impaktin që ajo ruan ende në brezat dhe fatet e tyre historike aktuale. Megjithatë kemi arsye të forta të besojmë se në librat e historisë islame që nga koha e halifëve të drejtë dhe dinastive të mëvonshme islame si emevitët, abasitët etj. gjenden shembuj të shumtë dhe aq të rallë sa që ruajnë të veçantën edhe për ditët tona në lidhje me këtë temë që po trajtojmë.

Lexim të këndshëm!

Në këtë numër do të lexoni:

Fryma e mëshirës dhe e tolerancës

Hasan Kamil Jëllmaz

Tolerancën para së gjithash duhet ta kërkojmë te i Dërguari i Allahut, i cilësuar si Pejgamberi i mëshirës, sepse edhe vetë Kur'ani e prezanton atë si Profetin e mëshirës dhe dhembshurisë.

4



Fryma e mëshirës dhe e tolerancës
Hasan Kamil Jëllmaz

| 4 |

| 6 |

Një kornizë për të drejtat e njeriut

Ahmet Tashgetiren

Opinione mbi tolerancën dhe solidaritetin

Mesut Erdal

| 10 |

| |

Mbështetja reciproke

Shemsetin Kurush

Në qoftë se njerëzit që bartin ide dhe ndjenja të njëjta nuk mund të lartësohen drejt më së mirës dhe sublimes, padyshim që shkaku kryesor i kësaj situatë është mungesa e mbështetjes reciproke

14



Mbështetja reciproke

Shemsetin Kurush

| 12 |

Ngadhënjimi mbi njeriun

Mustafa Ozdemir

| |

| 14 |

| |

Mëso të jesh shpirtmadh

Ismet Ezzxhan

Puna që kryejnë është e rëndësishme dhe kërkon kujdes, gatishmëri dhe sakrificë të mëdha.

20



Të drejtat e pakicave në të drejtën islame

Hamdi Dëndyren

| 18 |

| |

| 20 |

Mëso të jesh shpirtmadh

Ismet Ezzxhan

| |

Ballakni dhe toleranca osmane në shek. XVII

Qani Nesimi

Ardhja e shtetit Osman Ballkanin e gjeti në një pozitë shumë të vështirë sa i takon respektimit të së drejtës nacionale dhe fetare të tjetrit.

28



Pacifizmi në islam

Harun Jahja

| 22 |

| |

| 26 |

Islami dhe sistemi botëror i tolerancës

Zymer Ramadani

| |

Ballakni dhe toleranca osmane në shek. XVII

Qani Nesimi

| 28 |

Përkthyes:

Adelina Muça
Alban Kali
Ali Bardhi
Artur Tagani
Elona Sytari
Elvira Puka
Ermal Nurja
Evans Drishti
Klementina Rrepa
Naim Drijaj
Nexhat Ibrahim
Zymer Ramadani

Viti: III Numri: 13
Korrik - Gusht 2008
Rexheb - Shaban 1429

Boton

Progresi Sh.p.k:
Shkodër / Shqipëri

Redaktor: gjuhësor-letrar:
Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik:
Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Korrik - Gusht 2008

|32| Të kapërdish
zemërimin
| | *Osman Nuri Topbash*

I pafuqishëm |38|
Evans Drishti

|40| Mrekullia e Krijuesit
Bima mizëgjuajtëse
| | *Ali Iljazi*

Ajetet Kuranore për
mirëkuptimin |42|
Naim Drija

|44| Njohja e të ndaluarës
dhe e të lejuarës çështje e
domosdoshme në islam
| | *Flamur Sofiu*

Poezi |47|
Alban Kali

|48| Imam Vehbi Ismaili
Islam Dizdari

Një ditë me mualimin |51|
nga Tetova:
Mahmud ef. Asllanin
Ahmet Ramadani

|54| Arkitektura e hershme
islame
| | *Muhitin Serin*

Të dhëna rreth hoxhallarëve |56|
të trevave të ndryshme të
Maqedonisë
Ermal Nurja

|60| Shëndeti dhe familja
Naim Drija



Të kapërdish zemërimin

Osman Nuri Topbash

Njeriu, i ardhur në këtë botë si panorama e bukurive hyjnore, është lënë kokë më kokë vetëm me veprat e mbrapshta dhe mëkatat e egos së tij...

32



Njohja e të ndaluarës dhe e të lejuarës çështje e domosdoshme në islam

Flamur Sofiu

"O ju njerëz, hani nga ajo që është në tokë e që është e lejuar dhe e mirë, e mos shkoni pas gjurmëve të djallit se ai është armik i hapët i juaji"

44



Imam Vehbi Ismaili

Islam Dizdari

Imam Vehbi Ismaili ndërroi jetë. U shua edhe një dijetar i shquar i kombit tonë, një njeri që gëzoi popullaritet të madh...

48



Të dhëna rreth hoxhallarëve të trevave të ndryshme të Maqedonisë

Ermal Nurja

Në këtë punim jemi përpjekur të shqipërojmë të dhëna rreth disa hoxhallarëve nga treva të ndryshme të Republikës së sotme të Maqedonisë.

56

Adresa:

L: Vasil Shanto Rr: Çajupi
Shkodër

Tel: +355 69 20 76 768

Shtyp: ArbëriaDesign, Tetovë

Tel: +389 44 35 33 71

Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@hotmail.com
etikaeditor@yahoo.com

Çmimi: 1 Euro / 150 Lek / 60 DEN

Ngjyra: Progresi

Tel: +355 69 20 76 768

+355 69 20 58 855

Fryma e mëshirës dhe tolerancës

E vërteta është se toleranca ishte pjesë e jetës sonë të cilën fatkeqësisht e paskemi harruar. Ndërsa sot nuk jemi duke gjetur vendin e duhur ku ta vendosim.

Kohët e fundit toleranca si pa e kuptuar po zë vend ndjeshëm në prehrin e aktualitetit. A mos vallë toleranca ishte një term i panjohur për ne deri tani...?! Apo ekzistonte, por ne e kemi harruar...?! Apo e kemi vendosur si relike në raftet e pluhurosura...?! E vërteta është se toleranca ishte pjesë e jetës sonë të cilën fatkeqësisht e paskemi harruar. Ndërsa sot nuk jemi duke gjetur vendin e duhur ku ta vendosim. Teksa disa e studiojnë tolerancën në përmasa të gjera dhe të gatshëm për të përfshirë brenda saj çdo sjellje që nuk është në kundërshtim me islamit...po të njëjtën ndjeshmëri sikur e kursejnë ndaj myslimanëve. Disa të tjerë e studiojnë tolerancën në përmasa aq të ngushta sa nuk gjejnë njeri që ta përvetësojë tërësisht. Për këtë arsye duhen vështruar edhe një herë hapësi-ra dhe kufijtë e saj.

Tolerancën para së gjithash duhet ta kërkojmë te i Dërguari i Allahut, i cilësuar si Pejgamberi i mëshirës, sepse edhe vetë Kur'ani e prezanton atë si Profetin e mëshirës dhe dhemb-

shurisë. Në një ajet të Kur'anit thuhet: "I dashuri im! Ne të dërguam ty vetëm mëshirë për botët..." (Enbija, 107)

Veçoritë e mëshirës së Pejgamberit sipas dijetarëve myslimanë:

"Ai është mëshirë për botët..." sepse ata të cilët iu bindën atij mbartin lumturi si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër.

"Ai është mëshirë për botët..." sepse me ardhjen e tij u eliminuan ndëshkimet në masë të Allahut kundrejt njerëzve pabesimtarë siç ishte në periudhat e mëparshme.

Ai si përfaqësues i një pjese të vogël të dhembshurisë hyjnore është burim mëshire...jo për një vend, komb, krahinë, fis por... për gjithë njerëzimin. Ai me këtë virtyt mëshire të dhuruar nga Krijuesi i gjithësisë sillet me njerëzit gjithnjë me butësi, ngrohtësi, dashuri e dhembshuri. Në Kur'an kjo cilësi i servirej njerëzve kështu: "Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë padyshim që njerëzit do të largoheshin prej teje". (Ali Imran, 169).

Bazuar në ajetet që prezantojnë mëshirën e Profetit, edhe feja e kumtuar prej tij rezultoi si fe e mëshirës. "Unë u dërgova me fenë e lehtësimi dhe të mëshirës" (Ibn Hanbel, VI, 116, 223). Ndërsa në një hadith tjetër thuhet: "Kush sillet me mëshirë me njerëzit në këtë botë, Allahu në ahiret do të urdhërojë melekë të posaçëm të cilët do të sillen me mëshirë ndaj tij". (Ibn Hanbel, I, 5). Në një thënie profetike të përcjellë nga Amr b. As thuhet: "Kur e kishin pyetur Profetin se cila ishte puna më e dobishme, e virtytshme i Dërguari i Allahut ishte përgjigjur:

- Fjala e mirë, të ushqesh të tjerët, mëshira dhe virtyti. (Ibn Hanbel, VI, 204).

Nisur nga ajetet dhe hadithet përkufizimet e bëra mbi dhembshurinë dhe mëshirën e Profetit përbëjnë themelin e islamit. Islami...është bindja ndaj urdhrit të Allahut dhe sjellja me mirësi e dhembshuri ndaj krijesave të Tij. Kjo mëshirë, thelb i islamit, përfshin çdo qenie të krijuar nga Allahu, si rezultat i atributit fuqi.

Allahu së pari dëshiroi që pro-

fetët ta mbanin mbi supë këtë virtyt dhe të cilët do të kishin mirësinë t'ia përcillnin gjithë njerëzimit si bazë në formimin e karakterit të tyre.

Mëshira dhe dhembshuria profetike nuk pranon ankesa dhe rënkime, sepse ankesa është rezultat i dobësisë, paafësisë. Duke ditur se gjithçka ndodh sipas një plani të caktuar hyjnor, njeriu....kujt mund t'i ankohet?! Në dhembshuri ka mërzitje...lot...ndjeshmëri, por kurrë ankesa dhe rënkime. Nuk është e mundur që pa shkrirë trupin të mund të arrijmë në detet e shpirtit. Duhet ta mirëpresësh vuajtjen, për të shijuar kënaqësinë pas saj. Mos u dëshpëro për atë që të vjen nga Zoti yt. Kurrë mos thuaj "U shkatërrova nga vuajtjet". Por pa e provuar këtë gjendje nuk do të arrinim kurrë të kuptonim zemrat e mërzitura...të pikëlluara! Profeti, fryma e mëshirës, na këshillon gjithnjë të jemi afër njëri-tjetrit dhe të takohemi në detin e thellë të dashurisë.

E nëse sot te myslimanët dhe bota islame ka një tablo tjetër, gabimi duhet kërkuar ose tek myslimanët të cilët nuk kanë arritur ta kuptojnë drejt islamin ose tek ata të cilët i frikësohen fuqisë së myslimanëve dhe tentojnë t'i zhveshin virtytet hyjnore të islamit duke e paraqitur dhe e njollosur atë si fe terroriste. Gjithnjë duhet të arrijmë të kuptojmë dhe të interpretojmë drejt fraza "myslimanizmi është tjetër...myslimanët janë tjetër", pasi që nuk është e drejtë t'ia veshësh islamit gabimet e një myslimani.

Në vendin tonë dhe në botën islame është detyrë e çdo individi të diskutojë rreth tolerancës. Teksa Islami ecën drejt majave në gjithë botën është e qartë përpjekja keqdashëse e fuqive të huaja të cilat mendo-

hen ta paraqesin islamin në sytë e të tjerëve si burim terrorizmi. Ndërsa si mjet për arritjen e këtij qëllimi përdorin median duke ndikuar drejtpërdrejt në mendjet njerëzore, duke skalitur në qeniet e tyre një frymë antiislame, ndërsa nga ana tjetër shkaktojnë si pa kuptuar një sërë prapambetjesh në shoqërinë tonë. Kjo lloj prapambetje që po cenon gjithnjë e më tepër rregullin e bashkësisë islame, e cila nuk do të jetë e lehtë për t'u eliminuar. Për këtë arsye është emergjente nevoja për t'i bashkuar njerëzit rreth frymës së tolerancës duke respektuar si ekzistencën, ashtu edhe çdo mendim e ide të të tjerëve.

Këshillohet që njerëzit të mos shihen si një tip i vetëm, por të vlerësohet çdo njeri sipas gjendjes dhe situatës që paraqesin para Krijuesit të tyre. Në bazë të kësaj myslimanët gjatë gjithë historisë njerëzore duhet të prezantohen, pasi të jenë në të vërtetë, të bashkuar si kurrë ndonjëherë.

Është e rëndësishme të mos paragjykojnë njerëzit me takimin apo lidhjen e parë. Gjatë gjithë historisë bazuar në këtë pikëpamje nuk është hasur në asnjë problem me njerëzit të cilët përvetësojnë ide të ndryshme nga feja jonë. Përkundrazi çdokush ka jetuar i lirë në besimin dhe fraksionin e tij përkatës pa iu cenuar asnjë e drejtë. Fakti që njerëzit ndahen në besimtarë e jobesimtarë nuk i ka shtyrë myslimanët të anojnë nga njëri apo tjetri grup, gjithnjë ka mbizotëruar toleranca mes tyre. Gjithsesi në këtë as-

pekt një punë e madhe bie mbi supet e çdo qytetari, popullit dhe kryesisht qeverisë.

Ç'të drejtë kanë të presin tolerancë nga të tjerët ato vende që deri tani nuk e kanë përveçësuar frymën e tolerancës? Sot për të formuar një mjedis tolerant çdokush është aleat...por sa keq që çdokush e pret këtë nga pala tjetër!

"Kush sillet me mëshirë me njerëzit në këtë botë, Allahu në ahiret do të urdhërojë melekë të posaçëm të cilët do të sillen me mëshirë ndaj tij"

Toleranca është virtyti që zë fill në brendësinë e çdo individi dhe zhvillohet duke u pasqyruar jashtë. Te moçmit na mësonin që në vend që të jeni "shpirtngushtë" bëhuni të hapur me të tjerët duke u bërë "shpirtgjerë". Ata që posedojnë zemër të gjerë janë të qëndrueshëm, i shohin njerëzit me të njëjtin sy, pa paragjykime e dallime, ndërsa ata që posedojnë një zemër të ngushtë humbasin nga mostoleranca, vënë si parim të tyre paragjykimet e dallimet mes shtresave njerëzore. Me një fjalë Islami është fe e mëshirës dhe e dhembshurisë, e mbi të gjitha fe e tolerancës ndëreshoqërore.

Një kornizë për të drejtat e njeriut

Njeriu në asnjë periudhë nuk është lënë më shumë mënjanë se sa është lënë pikërisht në këtë kohë. Njeriu është bërë pre e padronëve që u kanë mbaruar edhe ndjenjat njerëzore dhe ato teknologjike.

Reçeli në kavanoz

Qëndron me vend ajo fjala e shkrimtarit "sa i magjishëm që paske qenë...", ne jemi sikur se ata që në largësi lëpijnë reçelin që është në kavanoz. Ata që kanë kavanozin në dorë, janë kampionë të përhershëm të të drejtave të njeriut... Ata krijojnë fjalë të magjishme për reçelin që është në kavanoz... Por të marrin frytë prej tij është vetëm në iniciativën e tyre... Atyre që shohin nga larg u mbetet të mendojnë sikur e kanë lëpirë dhe e kanë ngrënë reçelin. Pasi rregulli i forcës, i krijuar përpara të drejtave të njeriut, òa është formuar brenda gjithë despotizmit edhe në aspektin e marrëdhënieve ekzistuese dhe për këtë arsye nuk mund të pohoni edhe faktin që gjuha nuk ka prekur në reçel.

Njeriu është i detyruar ta zgjidhë këtë fjalëkryq. Kjo pasi me zhvillimin e teknologjisë dhuna sikur institucionalizohet edhe më tepër, bëhet edhe më e hollësishme dhe më e pashmangshme. Ju bëheni pjesëtarë të një rregulli të skllavërisë universale pa qenë në dijeni të humbjes së

të drejtave tuaja. Njeriu në asnjë periudhë nuk është lënë më shumë mënjanë se sa është lënë pikërisht në këtë kohë. Njeriu është bërë pre e padronëve që u kanë mbaruar edhe ndjenjat njerëzore dhe ato teknologjike.

Cilën të drejtë përdorim?

A mund të flisni atje për një të drejtë të vetme të njeriut? Jo, pasi ekzistojnë lobingët. Ekziston shtypi dhe forcat ekonomike. Një njeri i vetëm përdor vetëm të drejtën që i takon brenda ekuilibrit të këtyre forcave. Kjo është si puna e luanit me tigrin që grinden me njëri-tjetrin për një gjueti dhe, nëse ka mbetur ndonjë copë mishi aty rrotull, atë e kollofit menjëherë dhe luanja e cila sillet mes tyre. Ja pra kështu është edhe kjo. Kjo është edhe pasqyra e të drejtave të njeriut në Amerikë dhe në Evropë. Këto janë shoqëritë liberale. Ata marrin për bazë lirinë individuale. Cilën liri individuale? A është e mundur të mendosh i lirë dhe gjithashtu të jetosh i lirë brenda këtij ekuilibri force? Ju do të mendoni sipas atyre që u jepen nga organet e shtypit, do të ngopeni me thërmijat që u përhapen nga përplasja e

uniteteve ekonomike dhe do të freskoheni nga një qiell apo një pjesë e natyrës që ka shpëtuar nga përplasia e tyre. Ja pra, ku e keni edhe xhenetin e kësaj bote liberale.

Po bota tjetër? Bota e vlerave kolektive... Atje nuk ka përfytyrë. Pasi ato e kanë shtypur despotin. Dhe është pikërisht njeriu i atij shteti që do të përdorë atë që partia komuniste e ka quajtur të drejtë. E drejta është ndryshe për atë që është në majë dhe ndryshe për atë që është poshtë. Dy tipa njerëzish... Njeriu komunist dhe ai jo komunist. Edhe në këto ditë bile ku erërat e lirisë i kanë tejkaluar perdet e hekurta, janë këto padronë të shtypur që përcaktojnë kufijtë e të drejtave të njeriut.

Po këtu kush e formon rregullin e të drejtave? A duhen vite për të thënë se në vendin tonë që është si një dashuri e zezë për të bërë legjislacionin civil, të drejtat janë përcaktuar sipas parimeve të të drejtave. Të bësh legjislacion në vendin tonë, të përcaktosh drejtësinë e njerëzve sikurse edhe në disa shtete që janë edhe ideali ynë, akoma nuk është bërë as lobing. Secili

e ka për zemër një legjislacion të shumicës. Kurse në perëndim ku akoma nuk është ndriçuar e drejta e masave të popullsisë dhe ku nuk janë mundësuar akoma grupimet në këtë spektër, nuk dihet se kush dhe si është krijuar legjislacioni i shumicës.

Të llosh që nga njeriu

Për të zgjidhur këtë fjalëkryq është e nevojshme të fillosh që nga njeriu, po aq sa është e rëndësishme që starti të bëhet vazhdimisht prej aty. Dhe kjo duhet bërë edhe kur përcakton të drejtën e një njeriu të vetëm, edhe kur përcakton kufijtë e të drejtës së njeriut brenda shoqërisë, edhe kur nisesh të krijosh një sistem me bazë në të drejtat e njeriut... Fillimisht të kuptosh njeriun. Vetëm kur nuk e harrojnë qenien e njeriut, mund të jeni në rrugë të drejtë me të drejtat e njeriut. Në të kundërt, është i pashmangshëm komentimi i të drejtave tona dhe humanizmit. Dhe kjo nuk është një kornizë e të drejtave dhe e një humanizmi sipas jush, por një kornizë sipas rregullit që ka krijuar i forti.

Duke u nisur nga ky këndvështrim mund të analizoni edhe të drejtat e njeriut në aspektin praktik dhe teorik.

Ana teorike e çështjes lidhet me përcaktimin e njeriut. Pyetja se ç' është njeriu përcakton thelbin e çështjes së të gjitha të drejtave të njeriut. Duhet të keni një pikë referimi themelore të njeriut që të arrini të bëni edhe përcaktimin e të drejtave sipas tij. Në të kundërt, nuk ka kuptim as ndarja e të mirës nga e keqja. Edhe analiza e të drejtës dhe e të padrejtës mbetet pa bazë. Momenti se çfarë i jepni njeriut bën që ju të silleni për-

shtatshmërisht me të drejtat e tij dhe për sa kohë që nuk i jepni jeni në kundërshtim me to. Për të përcaktuar një gjë të tillë duhet parë përkufizimi i njeriut.

Aspekti i dytë i planit teorik të temës është pyetja se kush do ta përcaktojë njeriun? Kush do t'i përcaktojë veçoritë e tij? Kush vizatohet një kornizë të një njeriu që do të bëhet bazë e të drejtave të njeriut? Kush do të jenë këta? Filozofët, tradhtarët, diktatorët, sociologët, antropologët apo mjekët, biologët? Apo çdo njeri do të bëjë përcaktimin e vetes së vet dhe kështu do të krijojë një vetëdije për drejtësinë?

Ndërsa në praktikë, çështjen e të drejtave të njeriut e përbëjnë pyetje të tilla si: kush do të përcaktojë kornizën e të drejtave? Kush do ta bëjë zbatimin? Kontrollorët kush do t'i kontrollojë? Kufijtë e të drejtës a do t'i përcaktojë vullneti i shumicës? Si do të dalë në pah vullneti i shumicës? Si do të vazhdohet nëse do të ketë devijime në bazën e vullnetit të shumicës? Si do të pengohet ngacmimi që vullneti i shumicës i bën të drejtave të pakicës? Ata të cilët provojnë vullnetin e shumicës, nëse bëjnë

Ju do të mendoni sipas atyre që u jepen nga organet e shtypit, do të ngopeni me thërmimet që u përhapen nga përplasja e uniteteve ekonomike dhe do të freskoheni nga një qiell apo një pjesë e natyrës që ka shpëtuar nga përplasja e tyre. Ja pra, ku e keni edhe xhenetin e kësaj bote liberale.

disa marrëveshje me fuqitë dhe i drejtohen dhunës ndaj shumicës dhe mbi të gjitha nëse përgatisin një platformë juridike, për këtë si do të pengohet një gjë e tillë? Këto janë pyetjet më praktike të nevojshme për zgjidhje për të drejtat e njeriut. Nuk mund të thuhet se kjo që njeriu i ditëve të sotme ka arritur, t'u gjejë një zgjidhje të pëlqyeshme këtyre problematikave.

Për t'u kthyer sërish në përkufizimin e njeriut... Sistemet profane, jashtë feje, laike dhe ateiste janë të mendimit se përkufizimi i njeriut mund të bëhet përsëri nga ana e njeriut. Në këtë drejtim janë bërë përpjekje të shumta që nga kohët e hershme. Janë krijuar teori të ndryshme për njeriun. Janë bërë përkufizime të njeriut nga ana shpirtërore, fizike e sjelljes. Po përfundimi? A ka dalë ndonjë mendim apo ide e përbashkët? Jo, nuk ka ndonjë përkufizim të tillë. Atëherë cilit filozof do t'i përcaktoheshin kufijtë e të drejtave të njeriut sipas përcaktimit të njeriut? Apo a mund të kompozoheshin të gjitha këto përcaktime dhe a mund të dalë një përcaktim i ri për njeriun? Edhe sikur të dalë një përcaktim i tillë a nuk do të ishte brenda kapacitetit njerëzor të njeriut?

Mosarritja e të shpjeguarit të ekzistencës së Krijuesit

Nëse vihet re me kujdes në këndvështrimin e parë ka një mospërputhje themelore. Pikërisht për këtë njeriu është krijuar dhe bën sikur nuk e sheh atë, Krijuesin. Njeriu sipas këtij mendimi "Është krijuar krejt bosh". Sido që të jetë ka ardhur në këtë botë dhe me veten e vet luan në këtë jetë. Edhe çështja e

të drejtave të njeriut nuk është gjë tjetër vetëm se nga përpjekjet e përcaktimit të rregullave të kësaj loje. Të gjitha këto përfytyrë janë një vazhdimësi e kësaj loje.

Ana e dobët e këtij mendimi është e qartë. Njeriu është krijuar dhe është bërë e mundur ekzistenca e tij nga asgjëja. Ka një qenie që e ka krijuar atë: pa zhdukur parimin e një krijuesi profan, laik, mendimin ateist, zotëruesi i gjithësisë nuk ka të drejtë të prodhojë asnjë teori për njeriun. Të gjitha teoritë e prodhuara janë të gabuara dhe pa baza. Parimi i Krijimit dhe i Krijuesit nuk janë zhdukur. Ose më saktë nuk ka qenë e mundur të shpjegosh një gjithësi pa krijues dhe njeriun. Me gjithë këtë mendimi ateist, laik dhe profan kur u nis të përkufizonte njeriun si një grabitës të drejtash, doli në pah drama që jeton sot ai.

Edhe ana praktike që përfshin në të pyetje të tilla, si: kush do t'i përcaktojë të drejtat e njeriut, kush do t'i bëjë zbatimet, provat dhe kush do t'i vërë në provë provuesit është po aq e rëndësishme sa ajo teorike. Me të vërtetë kush duhet t'i përcaktojë të drejtat e njeriut? Ç'është e drejta? Cila qenie mund të arrijë sukses në këtë drejtim? Tek kush ekziston forca e veçantë që do të përcaktojë kufijtë e të drejtave të miliarda njerëzve brenda miliona viteve që nga ekzistenca e deri në ditët e sotme dhe kush do t'i bëjë të lumtur këta njerëz?

Vallë një forcë e tillë mos ndoshta ndodhet tek njeriu? Nëse i lihet njeriut, vëmë re se ai nuk pranon parim tjetër përveç forcës. A është e nevojshme të japim edhe shembuj se si kalon "poshtë kafshës" kur ai bashkon forcën fizike me atë

**Me gjithë këtë
mendimi ateist, laik
dhe profan kur u
nis të përkufizonte
njeriun si një
grabitës të drejtash,
doli në pah drama
që jeton sot ai.**

mendore? Ne shohim me mijëra shembuj gjatë historisë se si një njeri që gjen forcë për të vendosur rregulla mbi njeriun e hyjnizon veten e tij duke krijuar dhunë të ndryshme. Dhe kjo nganjëherë ndodh në zbatim të dëshirës së tij, nganjëherë duke thënë "dëshira ime është ligj" dhe nganjëherë duke formuar edhe sistemin e drejtësisë të forcës së tij....

Situata mbetet e pandryshueshme edhe kur e ndan forcën e një njeriu të vetëm me disa të tjerë. Dhe këtë herë dëshira e dy apo tre vetëve kthehet në sistemin e drejtësisë.

Po marrëveshja sociale? Edhe në këtë rast kur të gërmoni yjet e tyre, do të vini re poshtë tyre ka forca të organizuara, ku dalin në pah suksese të cilat kanë bërë të mundur të pranohen aktet terroriste të tyre si një vullnet i popullit. Pra, në këtë botë, në këtë ambient ku takohen këto forca të organizuara, a kemi me të vërtetë një marrëveshje sociale të masave të gjera të popullit? Jo, s'është e vërtetë. Edhe nëse ka një marrëveshje sociale, kjo nuk është një marrëveshje so-

cial e masave të popullsisë, kjo është thjeshtë një marrëveshje që kryetarët e çetave të organizuara kanë bërë për të ndarë mirësitë e kësaj botë. Ndërsa ngrëniet dhe pirjet kanë qenë vetëm të drejtat e njeriut...

Nëse kufijtë e të drejtës së njeriut do t'i përcaktojë njeriu, pyetja e parë që do të bënte secili do të ishte "Pse jo unë?" Dhe kjo pyetje nuk ka përgjigje, pasi çdo njeri ka edhe ndjenjën e "për të qenë sa më afër hyjnizimit të nefsit të vet". Në aspektin njerëzor nuk mund të ketë përcaktues tjetër veç forcës. Kurse kur fillon gara e forcës, aty nuk do të mbesë gjë tjetër veç kacafytjes. Dhe kjo do të jetë në mënyrë kafshërore... Ndoshta edhe më e tmerrshme...

Aq sa është e rëndësishme të përcaktosh kufijtë e të drejtave të njeriut, po aq e rëndësishme është edhe zbatimi i tyre brenda një sistemi dhe provimi i zbatuesve. Cila është ajo formulë e cila pengon të tjerët të përdorin të drejtën për keq? Demokracitë që thuhet se e kanë realizuar më së miri këtë ekuilibër, akoma s'kanë zgjidhur çështje të tilla si diktimi i pakicës, ai i shumicës, diktimi i lobingëve, i mjeteve të komunikimit. Pse vallë?

Çështja duhet parë edhe në këndvështrimin e Islamit.

Islami është i vetëdijshëm se çdo qenie duhet të thotë: "Për njeriun kjo është e mirë, kjo është e keqe, kjo është e drejta, kjo është dhuna". Kjo është një e vërtetë e qartë. Dallimi është në identitetin e forcës që do të vendosë rregull për njeriun. Islami përkundrajt mendimeve profane, laike, ateiste të drejtën e vendosjes së rregullit për

njeriun nuk ia jep njeriut. Të shpalosësh një drejtësi është një autorizim shumë i madh në këndvështrimin e Islamit. Ai që beson se e ka këtë autorizim, do të dallohet shumë shpejt nga të tjerët, ose do t'i drejtohet ndjenjës së hyjnizimit të vetvetes ose do të kalojë në idhujtari ndaj qenieve më të fuqishme se vetja si: hëna, dielli, guri, njeriu i vdekur, një kryetar shteti etj. Islami nuk e lejon këtë. Islami nuk pranon ndonjë gjë tjetër dalluese prej njerëzve apo ndonjë masë tjetër më të lartë se sa "devotshmëria". Ndërsa devotshmëria nuk përcakton dallimin e forcës së njeriut ndaj njeriut por masën e robërisë ndaj Allahut. Islami e fut njeriun në garën e devotshmërisë dhe jo në atë të forcës. Devotshmëria është pra gara e robërisë. Ndërsa robëria është shprehje e pafuqishmërisë, e nevojës dhe jo e dhunës. Nga robëria nuk arrihet në dhunë.

Sipas Islamit burimi i çdo të drejte që përcakton edhe kufijtë e të drejtave të njeriut, është vullneti i Allahut. Forca e plotfuqishme është Ai. Thelbin e të drejtës duhet ta përcaktojë Allahu. Rregullin për njeriun duhet ta vendosë Allahu. Ai që vendos rregullin më të drejtë është Allahu.

Ky mendim brenda vetvetes është mjaft i drejtë. Pasi Allahu Teala i cili krijoi njeriun, është zotëruar i plotë për njeriun. "Sikur t'i ishte thënë: Mos u bëj!, nuk do të ishte bërë" njeriu. Sa bukur e ka thënë Sulejman Çelebi: "Nëse thotë mos u bëj, shkatërrohej njeriu" pasi është Allahu që e ka krijuar atë. Dija e njeriut është brenda dijes hyjnore. Edhe përkufizimi i njeriut aty është. Duke filluar që nga qelizat e deri tek majat e gishta-

Islami nuk e lejon këtë. Islami nuk pranon ndonjë gjë tjetër dalluese prej njerëzve apo ndonjë masë tjetër më të lartë se sa "devotshmëria". Ndërsa devotshmëria nuk përcakton dallimin e forcës së njeriut ndaj njeriut por masën e robërisë ndaj Allahut.

ve të gjitha janë aty. Si mundet që dija dhe shkenca të jenë të paditura nga hyjnorja? Dija e plotë është aty. Aty është përcaktimi i çdo gjëje. Prandaj edhe autorizimi për të përcaktuar të drejtën i takon Allahut. Prandaj edhe kufijtë e jetës të përcaktuara nga Allahu i Lartë, janë më të mirat dhe më idealet.

Një tjetër pikë e këtij botëkuptimi është edhe fakti që të drejtat e njeriut nuk kanë lidhje me bashkëkohoren. Islami i qëndron mendimit se kufijtë themelorë të të drejtave të njeriut janë përcaktuar që me krijimin e tij. "Njeriu është krijuar në formën më të bukur" Kufijtë e të drejtave të njeriut janë përmbajtje e kësaj thënieje kaq të bukur. Kjo është e tillë edhe për njeriun e parë edhe për njeriun e sotëm. Prandaj për Islamin nuk ekziston mendimi i njeriut primitiv. Të ndash njeriun sipas shkallëve, të ndash në grupe të drejtat e njeriut sipas shkallës së zhvillimit të teknologjisë, janë gjëra që nuk i zë botëkuptimi i Islamit. Ky është një tregues i qartë se perëndimori duke thënë se të drejtat ndryshojnë dhe

zhvillohen me kohën në mënyrë të vetëdijshme, i ndan njerëzit dhe njeriu që është i kufizuar në zhvillimin e teknologjisë, është më pak njeri dhe ka më pak të drejta. Kjo është edhe arsyeja se në kohën tonë Perëndimi i sheh njerëzit e shoqërisë jashtë saj si njerëz të grupit të dytë.

Ai që e sheh njeriun si njeri dhe që e ngre lart nderin e tij është Islami. Atëherë me të vërtetë ai që kërkon masën njerëzore brenda kufijve të të drejtave të njeriut, duhet t'i drejtohet Islamit. Që nga përcaktimi i njeriut e deri tek përmbajtja e të drejtave të tij...

Islami edhe në praktikë ka sjellë garancitë më të besueshme të të drejtave të njeriut. Këto janë pikërisht besimi tek Allahu dhe në jetën e Ahiretit. Ai që e merr këtë masë nga Allahu, do të ndjejë si një përgjegjësi ndaj Tij edhe domosdoshmërinë e të parit të kësaj mase. Ata të cilët mendojnë se kjo është një ndjenjë përgjegjësie abstrakte janë ata që nuk u besojnë Allahut dhe Ahiretit duke kaluar çdo lloj kufiri njerëzor dhe duke kaluar në dhunë, dhe këto shihen çdo kohë. Ata janë simbole të skllavërimit të vetë njeriut që i është larguar besimit të vërtetë duke kaluar në idhujtari.

Ashtu sikurse autorizimi për të përcaktuar të drejtën e njeriut është në forcën, vullnetin dhe dijen e Allahut, ashtu duhet provuar edhe ndjenja e përgjegjësisë ndaj Tij dhe zbatimit të tij. Kjo ndodh në të gjitha aspektet: sociale, politike dhe juridike.


Opinione mbi tolerancën dhe solidaritetin

Në kuptimin pozitiv të fjalës toleranca është virtyti social që përcakton nivelin e qytetarizimit dhe civilizimit si nga ana e të perceptuarit, edhe nga ana e të menduarit.

Origjina e fjalës “tolerancë” vjen nga latinishtja dhe rrjedh nga folja *tolerare* e cila ka disa kuptime në të atë gjuhë, si: mbështetem, përballoj, qëndroj, vazhdoj etj. Mendohet se toleranca është mënyra e të vepruarit ose të gjykuarit ku tregohet respekti maksimal kundrejt besimit apo mendimit të lirë të individëve të tjerë. Nëse niveli më i lartë i renditur i tolerancës është respekti ndaj të drejtave dhe lirisë së tjetrit atëherë, gjykimi ndryshe, përpjekjet për të shpëtuar besimin, jetën dhe veprimtarinë e njeriut nga njëtrajtshmëria dhe monotonia e saj është e vlefshme të besohet se toleranca do të bëjë të mundur fitimin e një pasurie, ndërgjegjësimin dhe posedimin e një vizioni të thellë.

Në kuptimin pozitiv të fjalës toleranca është virtyti social që përcakton nivelin e qytetarizimit dhe civilizimit si nga ana e të perceptuarit, edhe nga ana e të menduarit.

Tolerancë është pranimi i çdo individi së bashku me mënyrën e tij të menduarit apo të gjykua-



rit. Ndoshta përmbledhja e këtij termi është e lehtë, por fitimi dhe arritja e posedimit të këtij fenomeni është tepër e vështirë. Ky fenomen kërkon domosdoshmërisht një edukim me themel të fortë si dhe një nivel të caktuar qytetarizimi.

Toleranca apo solidariteti nuk janë pa limite. Toleranca e pakufizuar do të ishte buri i disa faktorëve negativë, si: humbja e vlerës së individëve, humbja e disa qëllimeve dhe idealeve, mosndjeshmëria, të qenit indiferent.

Toleranca dhe solidariteti që ne fitojmë nga Kur’ani është se Allahu (xh.sh) i krijoi njerëzit dhe u dhuroi atyre të drejtën e lirisë për të zgjedhur dhe veçanërisht lirinë e të vepruarit për

të përcaktuar vetë më tej ahi-retin. Gjithashtu brenda kor-nizës së kësaj lirie njeriu do të sprovohet. Për sa i përket përzgjedhjes së vlerave Allahu na tërheq vëmendjen që të jemi të solidarizuar dhe tolerantë ndaj asaj që ai toleron, si dhe të jemi intolerantë ose të paktën ta refuzojmë me zemër atë të cilën Allahu nuk e toleron.

Për këtë Allahu u tërheq vëmendjen njerëzve që ata të jenë të kujdesshëm në zbatimin e detyrave të tij dhe secilin prej nesh e pranon ashtu siç është në formën e vet. Çdo njeri është i detyruar të përgjigjet për veprat e tij dhe askush nuk do të gjykohet përveçse prej veprimeve të veta. Allahu i drejtohet Muhamedit (a.s.) në Kur’an

: “O ti Muhamed! Ne nuk të bëjnë Ty mbikëqyrës të tyre, si dhe nuk je i përgjegjshëm për veprat e njerëzve. Ti je vetëm thirrës. (Enam, 107)

Në këndvështrimin historik termi tolerancë është shfaqur si kundërshtim apo reagim i formuar gradualisht për shekuj me radhë në perëndim kundrejt shkatërrimit të fanatizmit fetar. Sipas shpjegimeve të Leonard Binder në perëndim si rrjedhojë e tolerancës ka ardhur pranimi i një grupi të krishterësh në një grup tjetër, megjithëse me rregulla dhe kushtetuta të ndryshme. Ndërsa për sa i përket botës islame, ajo i ka mundësuar popujve me besim dhe fe të ndryshme bashkëjetesën nën një çati me to. Madje mbas hixhretit të Profetit (a.s.) në shek.VII-të do të hartohet edhe “Dokumenti i Medinës”, i cili përmendet dhe cilësohet nga historianët myslimanë si ligji dhe kushtetuta e parë qytetare pasi që mes të tjerash në të parashikohet edhe regjistrimi i të gjithë banorëve. Kjo kurrësi nuk mund të konsiderohet vetëm si tolerancë apo mirësi, por si një domosdoshmëri e drejtësisë dhe mëshirës që karakterizon shpirtin islam.

Një fenomen në të cilin kanë insistuar perëndimorët është dhe toleranca fetare. Kur’ani famëlartë për këtë na informon 14 shekuj përpara kur thotë:

“Në fe nuk ka dhunë, është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetave dhe i beson Allahut ai është kapur për lidhjen më të fortë e cila nuk ka shpëputje. Allahu është dëgjues dhe i dijshtëm.” (Bekare, 256)

Me këtë ajet kuranor del në pah vendosja e rregullit dhe e zbatimit. Shkaku i zbritjes së këtij ajeti duke u bazuar në tefsir është fakti se përpara islamit në Medine ishte një lloj respekti dallues nga të tjerët ndaj atyre që ishin të krishterë apo hebrenj. Disa gra nga fisi Evs dhe Hazreh të cilave u vdesin fëmijët, i japin fjalën Allahut se, nëse fëmijët e tyre do të jetojnë, ato do t’i bëjnë o hebrenj, o të krishterë. Me ardhjen e islamit disa persona të cilët dëshironin të qëndronin në fenë e tyre si të krishterë detyroheshin nga familjarët dhe të afërmit e tyre që të pranonin fenë islame. Me zbritjen e këtij ajeti doli mirë në dukje se në fe nuk mund të ketë dhunë dhe detyrim. Në këtë aspekt mund të përmendim edhe suren Kafirun ku thuhet: “Ju keni fenë tuaj dhe unë kam fenë time.” (Kafirun, 6)

Toleranca apo solidariteti nuk janë pa limite. Toleranca e pakufizuar do të ishte burimi i disa faktorëve negativë, si: humbja e vlerës së individëve, humbja e disa qëllimeve dhe idealeve, mosndjeshmëria, të qenit indiferent.

Për këtë arsye njerëzit mund të jenë ndjekës të feve dhe besimeve të ndryshme, mirëpo duhet ti rikujtojmë lexuesit se këto mendime fitohen gjatë jetës, njeriu nuk i posedon ato kur lind. Këtu del në pah edhe një herë e drejta e lirisë së zgjedhjes së njeriut.

Dijetari i madh islam Gazali thotë:

“Edukimi me moralin e Alla-

hut, si dhe pasqyrimi i emrave të tij, si: Rrahman, Rrahim, Halim, Gafur, Kerim dhe Afuv njëkohësisht do të thotë përvetësim i mirëfilltë i tolerancës dhe i solidaritetit.”

Edhe në jetën aktuale me në krye Profetin tonë dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij, e kanë përqaftuar dhe pranuar tolerancën që na jepet në ajetet e Kur’anit.

Është tepër me vlerë fjala e Adolph L. Winmar : “Profeti (a.s.) sa herë që ka bërë një marrëveshje me njerëzit, asnjëherë nuk ka përdorur forcën dhe detyrimin. Gjithmonë i ka lënë të lirë të jetojnë fenë dhe besimin që ata kanë dëshiruar.”

Dhe kur e shikojmë në një këndvështrim të tillë me të vërtetë Profeti është një shembull i mirëfilltë i tolerancës. Për sa i përket tolerancës në Kur’an M.

Picktholl shprehet në këtë mënyrë: “Në këndvështrimin historik toleranca fetare është demonstrimi më i lartë i kulturës së një populli”.

Shtetet perëndimore kur filluan të qëndrojnë larg ligjeve fetare të besimit që kishin u bënë më tolerantë, ndërsa myslimanët kur lanë pas dore ligjet fetare mbetën pas në frymën tolerante dhe në fusha të tjera kulturore tepër të rëndësishme. Përpara se të vinte Islami toleranca nuk është konceptuar kurrë si një pjesë e fesë. Si përfundim ky mendimtar thotë: “Islami është ajo fe e cila i siguron të gjithë njerëzve të drejta të barabarta, si dhe respekt të madh dhe tolerancë kundrejt mendimeve dhe veprimeve të singërta”.

Ngadhënjimi mbi njeriun

Pushtimi i njeriut është i harmonizuar me natyrën njerëzore të zemrës së tij e cila duhet qëndisur me dashuri, ëmbëlsi, elegancë dhe hijeshi.

Ne duhet të ndjekim rrugën në të cilën kanë ecur thirrësit më të mëdhenj të njerëzve si profetët, sahabët apo edhe dijetarët e mendimtarët e dëgjuar.

Brenda meje kristalizohet një mendim apo shembull i tillë:

U mundova të hyj nga një derë e cila ndaj të vërtetës ishte e mbyllur pasi njeriun e kishin hutuar të drejtat dhe të shtrembëtat, të bukurat dhe të shëmtuarat e kësaj bote. Përballë më doli një tjetër derë. Mbasi e shemba këtë përsëri më doli një derë e tretë. Pa menduar fare e shemba edhe këtë, por këtë herë u përballa me një mur të pakapërcyeshëm. U përpoqa të ngjitem nëpër të dalat e murit, por nuk përfitova asgjë prej kësaj. Duke u sforcuar të kapërcej këtë mur ai sikur shtohet edhe më shumë. Më pas hoqa dorë për t'i kaluar këto dyer dhe mure të larta dhe iu drejtova zemrës. Zemra ishte e hapur... aty hyra plot dashuri, u njoha

me të duke shtrënguar duart. Më pas u përshëndetëm dhe u përqaftuam...

Rruga ndërmjet syve dhe zemrës ishte e ngushtë, ecëm... muret u zhdukën, dyert humbën dhe u takuam më në fund...

Pushtimi nuk është një lëvizje rebele. Fatih Sulltani i dashuruar pas botës me një bindje të prerë por me një mënyrë të butë dhe të lehtë, do të ndryshonte rrjedhën e jetës duke iu afruar njeriut njerëzisht dhe me metodën e paraardhësve të tij myslimanë. Ai ndriçoi horizontet e Bizantit i cili ishte prangosur nga muret e larta dhe errësira. N.q.s. pushtimi do të ishte një lëvizje rebele, atëherë në Kostandinopojë (Stamboll) nuk do të mbetesh gur mbi gur apo kokë mbi trup! Fatih Sulltani nuk pushtoi vetëm gurët dhe tokën e Bizantit, por mbi të tjerat ai pushtoi zemrat e njerëzve. Kështu ushtritë, komandantët dhe të gjithë njerëzit e njohën Fatih

Sulltanin si pushtuesin më të madh të zemrave.

Fatih Sulltani ishte i lidhur fort pas udhërrëfyesit të tij, Akshemsedinit, i cili punonte për të formuar personalitete dhe trima të tjerë si Fatih Sulltani që do të korrnin pushtime të mëdha duke nisur nga pushtimet e zemrës me dashuri dhe tolerancë.

Dijetarët dhe mendimtarët, pushtuesit e mëdhenj të cilët kanë jetuar pas profetit dhe sahabeve janë munduar në këtë mënyrë të formojnë individët e një shoqërie të cilët kanë mbetur të hutuar përballë të drejtave dhe të shtrembëtatave të kësaj bote.

Pushtimi i njeriut është i harmonizuar me natyrën njerëzore të zemrës së tij e cila duhet qëndisur me dashuri, ëmbëlsi, elegancë dhe hijeshi. Kjo është rruga që kanë ndjekur trimat e Horasanit për pushtimin e Anadolit. Përveç kësaj rruge, të tjera të cilat të çojnë drejt pushtimit

të njeriut, janë të zëna. Natyra e njeriu nuk mund të shkojë përshat me natyrën rebele, sepse ky është një veprim që nuk i bie ndesh vetëm njeriut si individ por edhe fatit të tij.

Njeriu ka vullnet të lirë. Ti afroresh këtij vullneti me dashuri dhe tolerancë është e njëjtë sikur të ndriçosh shpirtin e njeriut. Të besosh ose jo, të jetosh ose jo, kjo nuk është gjë tjetër vetëm se një shkëndijë e cila shuhet dhe ndizet brenda kësaj kohe. Por vazhdimësia e kësaj shkëndije nuk është e lidhur me rebelizmin. Rebelizmi është një lëvizje e cila errësinë i shton edhe më shumë errësinë dhe përveç kësaj errëson edhe horizontet e ndriçuara.

Kushti i parë i pushtimit është të drejtoresh nga njeriu. Fatih Sulltani përpara se të drejtohej Stambollit, iu drejtua njerëzve që jetonin aty. Ai ka-loi në veprim mbasi përcaktoi se besimet dhe qëllimet e individëve të asaj shoqërie ishin të ekuilibruara dhe kushtet e sulmit ishin të përshtatshme. Përfundimi i sulmit varet nga koha dhe vendi ku do të zhvillohet. Një vend dhe kohë e papërshtatshme bëhet shkak për një shkatërrim fatal.

Për të pushtuar njeriun duhet të gesh çastin e përshtatshëm kur zemra e tij e pranon realitetin. Në të kundërt një sulm i nxituar, këshilla të papërpunuara do të çonin dem mijëra njerëz.

Një ndër detyrat tona më të rëndësishme është të sistemojmë në qelizat tona të mirën, të bukurën, të drejtën...

Por përveç kësaj kemi një detyrë më të rëndësishme, të jetojmë. Të jetojmë duke mos e

përzier të bukurën dhe të drejtën me harbutllëkun tonë. Të jetojmë fenë e fundit, Islamin duke pasur parasysh ligjet e tij, sepse nuk ka rrugë tjetër që di t'i jepte përparësi njeriut. Jetesa për të cilën flasim, për t'u bërë realitet nuk ka nevojë për ftesa dhe thirrje, sepse në vetvete ajo ngërthen një thirrje, një ftesë.

Po të ekzistojë drejtësia...

Fatih Sulltan Mehmeti një ditë prej ditësh vizitoi një burg. Aty takohet me dy priftërinj të cilët ishin të burgosur dhe i pyet se për çfarë shkak ata ndodheshin aty. Ata u përgjigjën:

-Ne na burgosën, sepse i thamë perandorit se në një kohë të afërt Stambolli do të kalonte në duart e turqve.

Atëherë Sulltan Mehmeti II u tha:

-N.q.s. është kështu tregomëni a do të më ik duarsh Stambolli?

Priftërinjtë i thanë:

-Nëse na jep leje të shëtisim nëpër vend, do të ta japim një përgjigje.

Kështu me lejen e Fatih Sulltanit priftërinjtë dolën nga burgu. Mbas pak kohësh ata shkuan në qytetin e Bursës ku shohin se një fshatar kishte ardhur në gjykatë 3 ditë me radhë, por përsëri nuk e kishte gjetur gjykatësin në zyrën e tij. Më në fund gjykatësi erdhi ditën e katërt dhe fshatari nisi t'i tregonte hallin që kishte:

-Komshiu im pa të drejtë ka



vrarë një nga kafshët e mia duke e gjuajtur me gurë. Për këtë dua që ju ta detyroni komshiun tim të më dëmshpërblejë. Mbas u mendua pak gjykatësi i tha:

- Zotëri në të vërtetë unë isha me leje, por meqenëse nuk jam gjendur në gjykatë për 3 ditë me radhë më takon mua të paguaj për kafshën tuaj.

Dhe për këtë i paguan fshatarit vleftën përkatëse të kafshës. Priftërinjtë kthehen te Sulltan Mehmeti II dhe i thanë: N.q.s. myslimanët do të jenë gjithmonë të drejtë si tani, atëherë Stambolli nuk do t'u ikë prej duarsh asnjëherë. Por n.q.s. ju e humbisni drejtësinë, atëherë do t'u ikë edhe Stambolli.

Pas kësaj përgjigjeje Sulltan Mehmeti II i la të lirë priftërinjtë.

Mbështetja reciproke

Në goftë se njerëzit që bartin ide dhe ndjenja të njëjta nuk mund të lartësohen drejt më së mirës dhe sublimes, padyshim që shkaku kryesor i kësaj situatë është mungesa e mbështetjes reciproke. Sa ka rëndësi ndjenja e tolerancës në marrëdhëniet ndërnjerëzore, po aq rëndësi ka edhe mbështetja e ndërsjellët.

Njeriu nuk është një qenie e përsosur. Krijuesi e ka sjellë njeriun në botë si krijesa që “ka nevojë për t’u edukuar”. Procesi i edukimit pa dyshim që do të realizohet shkallë-shkallë ashtu siç kërkojnë edhe ligjet hyjnore. Është gati e pamundur që të gjithë pjesëtarët e një shoqërie të marrin një edukim të përkryer. Për këtë arsye nuk mund të presim nga çdokush sjellje “tejet të matura”. Prandaj edhe jemi të detyruar “të durojmë” çdokënd.

Profeti ynë i nderuar, Muhamedi (a.s.), ka thënë: “Më i miri

ndër njerëz është ai që jeton mes njerëzve dhe bën durim ndaj çdo situatë të vështirë që buron prej tyre”. Jeta shoqërore kërkon durim dhe rezistencë ndaj problemeve. Vetë shoqëria ndërtohet mbi bazën e karaktereve të ndryshme njerëzore, të cilët kanë të kushtëzuar përputhjen me njëri-tjetrin duke plotësuar anët e kundërta mes tyre.

Njeriut, në kërkim të përfuturit nga dhuntia e të jetuarit në shoqëri, patjetër që interesat vetjake, ndjenjat, përplasjet e ideve etj. do t’ia vështirësojnë mbështetjen e ndërsjellët me elementë të tjerë të shoqërisë. Nëse kjo shoqëri do që ndërtohet mbi baza fetare, padyshim që kjo përplasje interesash nuk do të ekzistonte.

Nga ana tjetër përplasjet e ideve janë gati të pashmangshme sepse çdokush mbart një botë të brendshme me ndjenja e mendime të larmishme. Veça-

nërisht të mos harrojmë se mendjet njerëzore janë aq të shumta sa edhe numri i tyre. Edhe pse në çështje kryesore mendimet mund të jenë të ngjashme, në çështjet dytësore mendimet nuk mund të jenë të tilla.

Gjithashtu jemi dëshmitarë të tendencës së njeriut për të “treguar vetveten”, botën e tij të brendshme, të ndajë me të tjerët mendimet dhe botën e tij.

Secili prej nesh dëshiron të pasqyrojë botën e brendshme dhe ta ballafaqojë me të tjerët. Përherë dëshirojmë të ndajmë me dikë tjetër një ngjarje të jashtëzakonshme që mund të na ketë ndodhur, një mendim që buron nga ne apo një vlerësim tonin vetjak. Edhe kur jemi pranë miqve dhe shokëve tanë, në një bisedë me ta, në fakt ajo çfarë dëshirojmë realisht është të ndajmë me ta mendimet e ndjenjat tona apo të flasim ato gjëra që na tërheqin vëmendjen etj. Por harrojmë se edhe ato që



qëndrojnë përballë nesh, kanë ndjenjat dhe mendimet e tyre personale. Çdo njeri edukohet ndryshe qoftë nga ana emocionale apo mendore.

Kërkojmë dhe presim përherë që tjetri të na kuptojë krejtësisht, duke mos bërë qoftë edhe një tentativë për të kuptuar botën e tij të brendshme.

E ç'të drejtë kemi të kërkojmë diçka që në radhë të parë as vetë nuk e kryejmë?

Shkaku i këtyre sjelljeve është mungesa e edukimit të egos sonë, pamundësia për t'u çli-ruar nga egoizmi dhe të çliro- hesh nga ai para së gjithash është një çështje edukimi. Në këtë kontekst nëse duam të ngrihemi në një shkallë të lartë, duhet të mirëkuptojmë ndjenjat dhe mendimet e të tjerëve pa- varësisht se kjo mund të na du- ket shumë e vështirë. Edukimi i vetvetes fillon pikërisht nga ndjenja e mirëkuptimit ndaj të tjerëve.

I dërguari i Allahut i dëgjon- te deri në fund arabët bedevi (endacakë arabë pa ndonjë for- mim kulturor) pavarësisht fjalë- ve të tyre jo të sjellshme duke u munduar t'i kuptonte dhe ndih- monte ata. Sahabët duke parë sjelljet e tyre jo të përshtatshme dëshironin t'i mbanin ata larg ose i largonin nga Profeti, por Muhamedi (a.s.) dilte kundër këtij qëndrimi duke u shpre- hur: "Nëse shihni një person në nevojë, ndihmoheni atë!"

Allahu Fuqiplotë shprehet shumë qartë kur thotë: "Ne pa- dyshim që do t'ju sprovovjmë!"

E në cilën sekondë të kësaj jete kalimtare nuk sprovohemi?! Nëse kemi përreth njerëz na duhet të durojmë çdo gjë që bu- ron prej tyre, ndërsa kur të jemi të vetëm fillikat, atëherë duhet të durojmë tekat që lindin nga egoja jonë.

Çështja ka edhe një aspekt tje- tër, nëse çdo mysliman kërkon që përmes vlerësimit të me-

ndimeve dhe ndjenjave të vë- llait mbi ato personale të arrij- më përfundime edhe në jetën praktike, padyshim që shpirti i "konsultimit" që Islami kërkon, do lind vetvetiu. Një shoqëri si kjo ku çdo individ vlerëson me- ndimet e tjetrit, padyshim që do jetë më dinamike dhe më e gjallë se asnjë tjetër.

Një njeri që arrin ndjenjën e vlerësimit dhe mirëkuptimit është tashmë një individ i kul- turuar. Edhe sikur njerëz të tillë të mos kishin të njëjtat mendi- me, kjo divergjencë "opinio- nesh" nuk do ishte tjetër vetëm se një larmi e dobishme.

Zemra na uron që, ashtu siç vetë Allahu (xh.sh.) thotë, "Myslmanët të jenë sa të më- shirshëm, të mirëkuptueshëm dhe tolerantë ndaj njëri-tjetrit, aq edhe të rreptë dhe kundër- shtarë ndaj mohuesve të fesë".

Toleranca e osmanëve

Bazuar në burime të qarta historike mund të shprehemi se populli mysliman nën udhëheqjen e familjes otomane, gëzonte disa privilegje të cilat e dallonin atë nga popujt e tjerë myslimanë të asaj kohe, të cilat e bënin atë plotësisht të meritueshëm për të qenë në krye të myslimanëve. Ai ishte popull i gjallë, i zhdërvjellët dhe ambicioz, ishte i pastër nga ndikimet e huaja, pasi bënte jetë të natyrshme dhe të lirshme, prandaj edhe sëmundjet shoqërore dhe morale të cilat kishin prekur popujt e tjerë, nuk kishin arritur të depërtonin deri tek turqit e vjetër.

Osmanët u shfaqën me një sistem bashkëkohor i cili ishte më ideal i pikëpamjet demokratike që zotëronte, gjë që tregonte kulturë dhe kështu që hodhi themelet e tolerancës dhe qëndrueshmërisë në vend, në sajë të një sistemi që i jepte të drejtën e vet që i takon secilit.

Toleranca është baza e demokracisë. Nuk mund të flasësh për demokraci në një vend që nuk ka tolerancë. Duke u bazuar në tolerancë, Osmanët ndërtuan një demokraci bashkëkohore e cila i kalonte të gjitha vështirësitë dhe pengesat që i shfaqeshin herë pas here. Kështu Osmanët kishin fituar besimin dhe mbështetjen për të qenë në krye të myslimanëve, si dhe të vetmit që praktikisht ishin të aftë t'i kthenin krenarinë e përhumur ato shekuj besimit Islam. Shteti islam arriti në këtë gjendje në sajë të politikës tolerante që praktikonin osmanët. Nuk është e mundur t'i mbash njerëzit të mbledhur me pahir nën çadrën tënde. Kjo gjë vërehet edhe në ajetet



kuranore në suren Bekare, ajeti 256 ku thuhet: **“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e gënjeshtërtja. Kush nuk i beson të pavërtetave dhe i beson Allahut, ai është kapur për lidhje të fortë e cila nuk këputet. Allahu është dëgjues dhe i dijsëm”**. Kurse në ajetin 99 të surres Junus thuhet: **“Sikur të kishte dashur Zoti yt, do të besonin tek Ai ç’ka në tokë. A do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?”**

Edhe shembulli më i lartë i njerëzimit, Pejgamberi (a.s.), ka pasur për bazë tolerancën edhe pse ka dashur që të gjithë të pranojnë Islamin.

Në një nga pikat e marrëveshjes që u lidh në Medinë theksohet se hebrenjtë kanë fenë e tyre dhe myslimanët kanë fenë e tyre. Kurse në marrëveshjet që u bë me të krishterët theksohet se nuk do të cenohej jeta e askujt. Pasuria, feja, faltetoret dhe çdo gjë, e madhe apo e vogël qoftë, do të ruhej.

“Nuk do të largohej asnjë peshkop nga detyra e tij, asnjë prift nga famullia e tij dhe nuk do të largohet asnjë murg nga manastiri i tij”.

Në një letër që Pejgamberi (a.s.) i shkruan etio-

pasve thuhet:

“Sado që të jetë pasuria e tyre, çfarëdo qofshin ato kisha apo manastire, ato janë pronat e tyre, të cilat as nuk do të sulmohen, as nuk do të sulmojnë kënd.”

Edhe pas Pejgamberit (a.s.) udhëheqësit e bashkësisë dhe shtetit islam, kalifatit, vazhduan të ndiqnin të njëjtat rregulla dhe principe.

Umeri (r.a.) kur ngadhënjeu mbi të krishterët tha: “Askush nga të krishterët nuk do të detyrohet që të bëhet mysliman. Ju jap fjalën se do t’ju mbrohet jeta, malli dhe tokat tuaja. Nuk do ndërrohet feja me pahir dhe nuk do të ndërhyjë askush në punët e fesë dhe riteve tuaja”.

Këtë lloj orientimi kanë ndjekur të gjithë drejtuesit e shtetit mysliman ndër shekuj duke treguar një kujdes të veçantë. Edhe osmanët gjithashtu i kanë dhënë rëndësi të madhe këtij sistemi që kur e morën në dorë pushtetin; dhe deri në lëshimin e tij u treguan të drejtë dhe të vendosur në këtë drejtim. Poqe se Osmanët do të kishin ndryshuar drejtim do të ishte e pashmangshme humbja e identitetit dhe etnicitetit që është sot.

Gjatë kohës së Osmanëve, në të gjitha vendet ku ata kanë sunduar, janë marrë nën mbrojtje të gjithë njerëzit, qofshin ata të besimit islam apo të besimeve të tjera. Ne si shembull për këtë mund të marrim mosmarrëveshjet që lindën mes jomyslimanëve në lidhje me fenë në Jeruzalem dhe gjykimin e drejtë të Osmanëve në lidhje me këtë çështje. Osmanët nuk kanë ndërhyrë asnjëherë në punët e fesë së jomyslimanëve dhe për këtë ka qenë e mundshme mbrojtja e fesë dhe e kombit.

Një ditë të xhuma, një nënshtetas turk mysliman u nxeh dhe u grind me një nënshtetas grek të krishterë. Kur ata dolën përpara gjykatësit mysliman osman (kadi) ky i fundit duke u bazuar në faktet e paraqitura i dha të drejtë shtetasit grek. Kjo gjë vërtetohet deri në ditët e sotme në arkivat e Sicilisë dhe arkivat e shteteve të tjera. Edhe tregu bile është ndaluar të bëhet në ditë festash të jomyslimanëve në mënyrë që njerëzit atë ditë të kryejnë ritet fetare dhe mos t’u bëhet padrejtësi atyre duke i nxjerrë të punojnë ditë të tilla.

Në kohën e perandorisë osmane ka pas harmoni midis anës fetare dhe asaj etnike. Nën sundimin e shteti osman përveç myslimanëve kishte edhe katolikë dhe ortodoksë të shteteve të ndryshme.

Me gjithë arritjet, përparimin dhe teknologjinë që kemi në ditët e sotme, nuk është e mundur të arrihet drejtimi që kanë pasur osmanët, pavarësisht nga fetë e ndryshme jomyslimane që praktikoheshin nga nënshtetasit e tyre. Dhe kjo u arrit vetëm me anë të tolerancës.

Duke hasur temën e tolerancës osmane historiani Gibbons shprehet se: “Në kohën kur hebrenjtë masakronin shumë myslimanë dhe gjyqet e inkuizicionit përhapnin vdekje, njerëzit që ishin nën sundimin osman edhe pse me fe të ndryshme, jetonin në paqe dhe hare”.

Mund të japim edhe shumë shembuj të tjerë që përshkruajnë historinë mbi tolerancën e osmanëve perëndimorë.

Ja çfarë shkruan Brockelman mbi tolerancën osmane: “Turqit myslimanë ditën e ngadhënjimit në Kostandinopojë, mund t’i kishin eliminuar shumë mirë të gjithë të krishterët, po të donin, por kjo nuk është pjesë e fesë të tyre dhe një gjë e tillë nuk u lejohet. Prandaj edhe sulltan Fatih Mehmeti II ndoqi gjurmët e gjyshërve të tij në lidhje me qëndrimin e tij ndaj jomyslimanëve.”

Kurse murgu Gridar në kronologjinë që shkroi e cila përfshin vitet 1595-1640, shprehet kështu për sulltan Ahmed I: “Sulltan Ahmed i donte paqen, ishte i dashur dhe i mëshirshëm me besimtarët e krishterë dhe ushqente mëshirë ndaj tyre”.

Një shembull tjetër i spikatur dhe i lartë i Mahmutit të II, i cili duke reflektuar nga gjendja që ishte në vitin 1837, në Shumnu u mbajti një fjalim jomyslimanëve lidhur me kujdesin dhe vendimet tolerante, ku mes të tjerash u tha:

“Ju grekët, armenët dhe hebrenjtë jeni robër të Perëndisë dhe nënshtetasit e mi. Tjetër gjë që feja juaj është e ndryshme nga ajo që ne besojmë.”

Sipas ligjeve të shtetit osman ju të gjithë jeni të mbrojtur, ju paguani taksat dhe ato do të përdoren për sigurimin dhe mirëqenien tuaj”.

Siç kuptohet edhe nga ky fjalim Osmanët kanë pasur si qëllim politikën e mbrojtjes së nënshtetasve të perandorisë, cilido qoftë besimi i tyre, dhe këtë e patën shprehur edhe në fermanët mbretërorë dhe ligjet e shtetit perandorak. Për arritjen e kësaj ata në njërën anë mundësonin paqen dhe harmoninë mes nënshtetasve, dhe në anën tjetër e forconin atë duke qenë tolerantë.

Të drejtat e pakicave në të drejtën islame

Nuk ekzistonte ndonjë diferencim ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve që njihnin pushtetin islam sa i takon paprekshmërisë ligjore të pasurisë, jetës, nderit dhe banesës.

Feja islame është një besim mbarë botëror, prandaj ajo ka sistematizuar edhe marrëdhëniet me jomyslimanët. Që në kohën e profetit Muhamed (a.s.) u patën lidhur marrëdhënie fqinjësie dhe zyrtare me hebrenjtë dhe të krishterët që banonin në zonën e Hixhazit. Në mënyrë të veçantë gjatë sundimit të kalifëve të drejtë, kur ushtritë myslimane arritën të shtrijnë pushtetin e kalifatit edhe në viset e Sirisë dhe Irakut, marrëdhëniet me bashkësitë jomyslimane që përmendëm më lart shkuan drejt relacioneve më të hollësishme. Ashtu sikurse pati nga jomyslimanët që hynë në masë në besimin mysliman, po ashtu pati edhe nga ata që mbetën në besimin e mëparshëm, gjë që e siguruan në saj të lirisë që iu njoh nga myslimanët fitimtarë. Këtë të drejtë ata e siguruan në saj të mësimit islam sipas së cilës e vërteta u publikohet dhe u shpallet të tjerëve, nuk përhapet me dhunë.

Jomyslimanët që jetonin nën pushtetin mysliman meqenëse numëroheshin si bashkëqytetar të shtetit islam, u njihej e drejta që të angazhoheshin në të gjitha punët publike, me përjashtim të atyre që kishin lidhje të drejtë për drejtë me shërbimet fetare. Por pa dyshim që në këto detyra shtetërore nuk përfshiheshin kryesia e



shtetit, komanda e ushtrisë apo poste të tjera që i mundësonin atyre të merrnin vendime që i përkisnin shumicës. Vetëm pas Tanzimatit jomyslimanët arritën të zënë disa poste ministrore në qeverinë otomane.

Jomyslimanët që jetonin nën pushtetin mysliman mund të përfitonin për sa i takon fushës së të drejtave dhe lirive personale ashtu sikurse myslimanët. Me përjashtim të Hixhazit, ata gëzonin të drejtën që të lëviznin lirshëm dhe të vendoseshin ku të dëshironin nëpër territorin e shtetit islam, në dallim nga getot hebreje në Evropën mesjetare. Nuk ekzistonte ndonjë dife-

rencim ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve që njihnin pushtetin islam sa i takon paprekshmërisë ligjore të pasurisë, jetës, nderit dhe banesës.

Jomyslimanëve që njihnin pushtetin islam, u njiheshin të drejtat e besimit dhe lirisë së saj, u lejohej praktikimi i riteve të tyre të besimit dhe u është njohur e drejta e zbatimit në përputhje me botëkuptimin e tyre fetar në çështje nga fusha e martesës, shkurorëzimit, trashëgimisë, ndalesave dhe lejimeve fetare.

Një nga argumentet më të spikatura të tolerancës islame është edhe rasti i Sulltan Fatihut, i cili nuk i preku me dorë pakicat fetare dhe kombëtare jomyslimane pas pushtimit të Stambollit duke i lënë ata në besimin e tyre, paçka se këtë gjë mund ta bënte shumë mirë në përputhje me konceptet e të drejtave të fitimtarit të betejës që ekzistonin në atë kohë. I cituar shumë herë dhe i mirënjohur si dokumentacion është edhe fermami që u lëshoi në dorë Sulltan Fatihu jomyslimanëve të lagjes së mirënjohur Gallata të Stambollit, tetë nenet e së cilës siguronin të drejta të ndryshme për jomyslimanët.

Por duhet theksuar se jomyslimanët këto të drejta që gëzojnë mund t'i aplikojnë brenda kufijve dhe kritereve të caktuar në

rastin kur ata jetonin në një shtet mysliman. Ritet dhe adhurimet e tyre fetare ata mund t'i kryenin vetëm brenda ambienteve të faltoreve të tyre dhe jo në ambientet publike. Gjithashtu e drejta e tyre për mbledhje dhe arsimim zbatohet brenda kufijve, shkelja e të cilëve mund të shkaktohet turbullime për rregullin shtetëror dhe shoqëror.

Më se e natyrshme është që besimi islam, i cili u soll aq tolerant ndaj jomyslimanëve në periudhat më të egra të historisë, t'i hap krahët e mirëkuptimit më të thellë pasuesve të saj, besimtarëve myslimanë dhe të mëtojë fuqimisht të përhapë këtë frymë ndërmjet myslimanëve. Këto të drejta është e mundur t'i shohim të përmbledhura në hytben e lamtumirës që mbajti profeti ynë Muhamedi (a.s.) në vitet e fundit të jetës së tij.

Kjo shpallje e shprehur publikisht në vitin 632, në një kohë kur në mbarë botën, dhe veçanërisht në shoqërinë arabe, njerëzimi rënkonte nën thundrat e padrejtësisë dhe istibdat-it, ku gruaja trajtohej një hiç, madje asaj nuk i njihej as e drejta për trashëgimi, përfshin të gjithë principet e të drejtave të njerëzve dhe grave, duke garantuar barazinë e tyre përballë ligjit dhe duke refuzuar çdo lloj prirjeve që mbështetej mbi bazën e racës, ngjyrës dhe gjuhës. Mos përfshirja e kësaj shpalljeje publike gjatë trajtimit të të drejtave të njeriut dhe atyre kushtetuese në ditët e sotme, mos përmendja as në mënyrë tangjent e principeve dhe të drejtave universale islame kur flitet për të tilla tema në lëndët e fakulteteve të drejtësisë, ekonomisë dhe shkencave politike, është një mohim që i bëhet të vërtetave historike.

Pretendimi gjoja shkencor se disa nga të drejtat dhe liritë themelore, të cilat feja Islame i ka në thelbin e saj në të vërtetë, nisën të zbatohen për herë të parë gjatë pushtetit otoman vetëm pas

shpalljes së fermanit të Tanzimatit në vitin 1839, janë të pabaza. Arsyeja është se ky ferman më shumë se një deklaratë e lirive dhe të drejtave, që një rregullore icrai që parashikonte përmirësimin në praktikë të gabimeve të bëra në përputhje me vendimet juridike të të drejtës islame. Madje nga një fjali e vendosur në fund të këtij fermani kuptohet qartë se hartimi i tij u bë nën diktatit e represionit politik të shteteve të Evropës.

Fermani otoman i vitit 1856 që një dokument i përgatitur që nuk mund të quhej as një beyanname për të drejtat dhe liritë dhe as parandalues i shkeljeve të mundshme të bëra deri atëherë. Historia e tregoi se hartimi i një dokumenti të këtillë nuk që gjë tjetër vetëm një lojë e shteteve të fuqishme perëndimore për të arritur njohjen e të drejtave më të gjera për jomyslimanët nën pushtetin otoman, masa që do të parapërgatitnin terrenin që shumë shpejt myslimanët të kaloheshin në plane të tjera më të parëndësishme, nga të cilat ata nuk do të mund të merrnin vendime të rëndësishme jo më për të tjerët, por madje as për vetveten.

Këtu po riprodhojmë ato pjesë që kanë të bëjnë me të drejtat universale të njeriut që janë regjistruar nga goja e bekuar e profetit tonë Muhamed (a.s.):

“ O njerëz! U këshilloj t'ia kini frikën Allahut dhe u nxis që t'i mbështeteni dhe bindeni vetëm Atij. Dëgjojeni mirë ato që do t'u them se nuk e di nëse do të jem në mesin tuaj edhe vitin tjetër.

O njerëz! Gjaku, jeta, pasuria dhe dinjiteti juaj janë të shenjta për ju deri në ditën që do të takoheni me Zotin tuaj, ashtu si janë të shenjta kjo ditë, ky muaj dhe ky truall.

Njeriut, çfarë ti jetë lënë si amanet, atë duhet t'ia dorëzojë mbrapsht personit që ia ka dhënë më parë.

Gjakmarrjet që bënin mes jush në periudhën përpara islamit (xahilije), janë të pezulluara. E para gjakmarrje që do të marr fund pa u vlarë kush nga pala e hasmit, është e nipit tim Amr ibn Rabia.

Poqe se dikush e vret një person tjetër qëllimisht, dënimi për të është vetëm me vdekje. Ai që kërkon një dënim edhe më shumë se ky dhe në persona të tjera është nga njerëzit e periudhës së verbër të injorancës (xahilije).

«O njerëz! Ju keni të drejta mbi gratë tuaja, ashtu sikurse edhe ato kanë të drejta mbi ju. E drejta juaj mbi to është të mos përdhosin shtratin bashkëshortor që keni dhe të mos fusin brenda në shtëpi individë nga ata që ju i keni zët. Sigurimi material i nevojave shtëpiake dhe veshmbathja e tyre u takon juve si detyrë dhe përgjegjësi përpara Zotit.

Silluni mirë me gratë tuaja dhe trajtojini mirë ato, sepse ato u janë lënë nën strehën, mbrojtjen dhe ruajtjen tuaj si një amanet nga ana e Allahut për ju. Kijeni frikë Allahut dhe druajeni njëkohësisht sepse Ai u urdhëron të silleni sa më mirë me gratë tuaja.

O njerëz! Zoti juaj është një, paraardhësi juaj është një. Të gjithë rridhni prej Ademit, ndërsa Ademi u krijua prej dheu. Më i respektuari tek Allahu është ai person që ia ka frikën dhe drojën më shumë Atij. Nuk ka arabi ndaj jo-arabit ndonjë superioritet dhe as jo-arabi ndaj arabit ndonjë përparësi tjetër përveçse devotshmërisë fetare.

Ata që janë të pranishëm këtu le tua përcjellin këto fjalë të mija personave që nuk gjenden sot këtu në mesin tonë sepse mund të ngajë që ai që i dëgjon nga të tjerët këto fjalë i kupton më mirë sesa vetë personi që ia përcjellë ato”.

Mëso *të jesh shpirtmadh*

Ditët e sotme kasta e punonjësve të fesë të cilët kanë marrëdhënie me një grup të madh të shoqërisë dhe me bashkësitë myslimane që frekuentojnë xhami të caktuara, janë individët që duhet të sillen më mirë se të gjithë.

Puna që kryejnë është e rëndësishme dhe kërkon kujdes, gatishmëri dhe sakrifica të mëdha. Nuk do ta ekzagjeronim aspak poqe se do të shpreheshim se funksionet që mbulojnë njerëzit e fesë, si: imami, ligjëruesi (vaizi), myftiu dhe mësuesit e fesë, janë një art në vete. Një mendimtar e përkufizon artistin e çdo lloji si “njeriu që punon me duar, mendje dhe zemër njëkohësisht”. Personi që përmbush një funksion fetar, është njeriu që e ka të detyrueshme më shumë se çdokush tjetër nga aspekti afektiv-shpirtëror që të vërë në lëvizje, të përdorë dhe të përfitojë nga të gjithë cilësitë materialo-shpirtërore që ka. Çfarëdo vlere që të ketë shërbëtori i fesë, duhet ta kthejë në parim të tijin nevojën që të fitojë zemrat e njerëzve për të përqafuar besimin islam dhe të mund të krijojë lidhje më të forta me Islamin për njerëzit që janë të dobët në këtë aspekt. Ai duhet të gjejë shtigjet për t’u afruar dhe krijuar dialog me njerëzit që nuk kanë interesim për fenë dhe atmosferën e mësimave të fesë, apo mbajnë qëndrim opozitar ndaj tyre, të mundësojë vazhdimësinë e këtyre rrugëve të mirëkuptimit dhe ta mbajë të hapur përherë këtë udhë që shkon drejt mirëkuptimit.

Në përgjithësi unë ushqej një ndjesi të sinqertë se në kushtet e ditëve të sotme është e pashmangshme që të merren parasysh ambienti dhe rrethi, brenda të cilit gjendet pjesa e popullsisë së cilës dëshirojmë që t’i përcjellim mësimet e fesë islame. Ndodh që kur parashtrohet një nevojë e delikatesës së këtyllë ndokush mund t’u keqkuptojë dhe t’u atakojë se gjoja jeni duke bërë lëshime nga mësimet e fesë

islame, gjë që unë mendoj se nuk përputhet aspak me të vërtetat e dukshme dhe të lexueshme në ditët tona. Sot në shumë vende të jetosh në përputhje me normat e fesë afishohet si një veprim dhe qëndrim anormal, ndërsa të jetosh dhe veprësh jashtë këtyre rregullave trumbetohet si diçka normale. Zhvillimi shoqëror është vënë në shtratin e ngjarjeve që të shpien drejt opozitës së mësimave dhe parimeve fetare. Kafenetë dhe vendet e argëtimit kërkojnë të mbulojnë edhe kohën që do të duhej për t'u prehur në ambientet e institucioneve të fesë.

Një pjesë e madhe e shtypit, lajmet, fotografitë, kronikat dhe artikujt prej vitesh në rastin më të mirë kërkojnë t'i diktojnë opinionit publik qëndrimet dhe vlerësime të padrejta ndaj mësimave të besimit islam dhe bashkësisë myslimane që përpiqet t'i jetojë ato.

Programet në kanalet televizive që shtohen ditë ditës, nxjerrin drejtpërdrejtë ose indirekt shprehje të lakuriqësisë dhe degjenerimit seksual, saqë këto të fundit kanë hedhur rrënjë në shumë ambiente publike duke kërcënuar dhe mbarëvajtjen e shoqërisë. Shumë gjëra kanë marrë rolin e shmangies së njeriut ndaj fesë dhe mësimet shpirtërore. Çerdhet familjare nuk paraqesin ndonjë tablo shumë të ndryshme nga ato publiket.

Jetojmë në një mjedis ku secili dëshiron të bëjë si ka dëshirë pa menduar për të drejtën dhe të duhurën që ka nevoja shoqëria, një shoqëri në të cilën janë fshirë vlerat e dashurisë, respektit dhe varësisë të paktën në kornizat e mësimave islame. Prandaj një nga obligimet më të rëndësishme të cilën duhet të plotësojnë njerëzit e fesë në një ambient të këti-llë, është të mund të përftojnë myslimanë të ndër-gjegjësuar në mesin e atyre individëve që tregojnë prirje ndaj mësimave të fesë dhe përpiqen sadopak të jenë pjesëtar të familjes së madhe të besimit. E gjithë puna që mund të kryhet në këtë drejtim është e pamundur pa tolerancë dhe mirëkuptim. Askush në shekullin që jetojmë nuk ka më shumë nevojë për frymën mirëkuptimi sesa një thirrës dhe propagandues i mësimave islame. Ndodh që njerëzit që nuk janë të rregullt në zbatimin e praktikës islame ose nuk e kryejnë aspak atë, prandaj duke mos e kuptuar se me mënyrën sesi veprojmë po t'i sulmojmë në emër të rregullsisë së jetës fetare, jo vetëm që nuk i shtyjme që ta shtojnë jetën fetare por mbase bëhemi shkak që ata të ftohen edhe më shumë nga ajo dhe ta braktisin. Ndodh që individë të ndryshëm të mos mbajnë relacione me ta apo të shtojnë thashethemet rreth tyre duke i atakuar si myslimanë marginalë. Por harrohet në këtë mes që principi ynë duhet të jetë t'i fitosh ata njerëz, jo t'i humbasësh për fare.

E pamundur është të mos shohësh se miliona njerëz që u unifikuan në sajë të frymës mirëkuptuese të Mevlanasë dhe Junus Emresë, këtë gjë ia kishin borxh edhe frymës tolerante të këtyre dy figurave të larta, tolerancë që buronte vetëm nga fryma e mësimave të librit të Zotit, Kur'ani, dhe praktika profetike.

Nuk është aspak me vend dhe objektiv qëndrimi që kërkon të refuzojë apo minimizojë të vërtetën e tendencës për besimin në një qenie superiore, madje domosdoshmërinë ekzistenciale të këtij besimi apo atë tharm besimi në karakterin e krijesës që quhet njeri.

Këtë të vërtetë e shohim më së miri tek masat dhe në mënyrë të veçantë tek të rinjtë pedagogët dhe mësuesit e mirëfilltë dhe të përkushtuar në profesionin e tyre.

Puna e përhapësit të mesazhit fetar që vepron me sinqeritet dhe dëshiron t'ia arrijë qëllimit është e vështirë, barra e saj është e rëndë. Duhet ditur se nuk është aspak e lehtë ta presim si me thikë faktin se cili individ është më i prirur për t'u përdhur në rrugën e fesë. Njeriu që mund ta konsiderojmë si më larg besimit për shkak të veprimeve të tij të ashpra, mund të bëjë një kthim prej 180 gradësh në drejtim të besimit. Nganjëherë mund të ndeshemi me pengesa shumë të mëdha për ta fituar zemrën në besim të një individ që duket natyrë e butë dhe me prirje ndaj mësimave të fesë. Për këtë arsye përhapësi dhe propaganduesit e fesë nuk duhet të mërzhiten, të ndërpresin interesimin dhe të tërhiqen në lëvizhjen e tyre ideologjike kur shohin se kanë të bëjnë me njerëz që nuk pajtohen me mendimet e tyre, mbajnë qëndrime të ashpra apo këmbëngulin në mënyrën e tyre të jetesës jashtë normave të besimit islam. Para së gjithash ai duhet ta mbajë të hapur udhën drejt dialogut. Kjo është edhe pika që anashkalohet aq shumë në ditët tona.

Një përkufizime të skajshme mund të hasen sot në literaturë për sa i takon emërtimeve të ndryshme që i bëhen shekullit që jetohej, si "shekulli i masmedias". Tashmë organet e shtypit dhe televizionet dhe forcat që qëndrojnë pas tyre e orientojnë opinionin publik në mënyrën që dëshirojnë dhe kështu masat të tëra të njerëzve mbeten nën ndikimin e pikëpamjeve dhe këndvështrimeve të caktuara.

Kjo është në të vërtetë një nga mjetet më të mrekullueshme që teknologjia i ka shtënë në dorë njeriut. Prandaj edhe myslimanët që sot për sot nuk përfitojnë aspak nga ky mjet i fuqishëm, përderisa pretendojnë që ta shpallin publikisht të vërtetën islame, janë të detyruar që të avancojnë sa më shumë në zhvillimin e kësaj teknologjie në mesin e tyre.

Pacifizmi në Islam

Sipas Kur'anit, lufta paraqet një "obligim të padëshiruar" e që duhet vënë në zbatim, duke mbajtur rreptësisht parasysh vlerat e veçanta njerëzore dhe morale dhe që mund të përdoret në ato raste kur ajo është e pashmangshme.

Në një varg kuranor tregohet se ata të cilët e nisin luftën janë njerëzit pa besim dhe që Zoti nuk i pëlqen luftërat:

"...Sa herë që ndezën zjarr për luftë, Allahu ua fiku atë, e ata përpiqen për shkatërrime në tokë. Allahu nuk i do ngatërrestarët. " (Kur'ani 5:64)

Në rastin e një konflikti, besimtarët duhet të luftojnë vetëm nëse lufta është e nevojshme. Nëse kundërshtarët sulmojnë, nuk mbetet asnjë zgjidhje tjetër, andaj dhe lufta është e detyrueshme:

"Po nëse ata ndalen (nga provokimi), Zoti është Falës, Mëshirues." (Kur'ani 2:192)

Një hulumtim i hollësishëm i jetës së Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të) tregon se lufta është një metodë që përdorej për qëllime mbrojtëse vetëm në gjendje të pashmangshme.

Shpallja e Kur'anit Profetit Muhamed i vazhdoi për një periudhë prej 23 vjetësh. Gjatë 13 vjetëve të parë të kësaj periudhe, myslimanët jetonin si pakicë, nën një qeverisje pagane në Mekë dhe u ballafaquan me shtypje të shumta. Shumë myslimanë u munduan, u dhunuan, u torturuan, madje u vranë, shtëpitë dhe pronat e tyre u grabitën. Pavarësisht nga kjo, myslimanët vazhduan të jetojnë pa kaluar në dhunë dhe gjithmonë u bënë thirrje paganëve për paqe.

Kur shtypja e paganëve u bë tërësisht e padurueshme, myslimanët u shpërngulën në qytetin e Jethribit, i cili më vonë do të quhej "Medinë", ku ata do të vendosnin qeverisjen e tyre në një

Në rastin e një konflikti, besimtarët duhet të luftojnë vetëm nëse lufta është e nevojshme. Nëse kundërshtarët sulmojnë, nuk mbetet asnjë zgjidhje tjetër, andaj dhe lufta është e detyrueshme:

“Po nëse ata ndalen (nga provokimi), Zoti është Falës, Mëshirues.”



mjedis më miqësor dhe më të lirë.

Madje edhe vendosja e sistemit të tyre politik nuk i shtyu aspak ata që të rrëmbenin armët kundër paganëve të egër të Mekës. Profeti Muhamed i urdhëroi njerëzit e tij të përgatiten për luftë vetëm pasi mori shpalljen e mëposhtme hyjnore:

“Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtë, e Allahu ka fuqi për t’u ndihmuar atyre (myslimanëve). (U lejuan të luftojnë) Ata, të cilët vetëm pse thanë: “Allahu është Zoti ynë!” u dëbuan pa kurrfarë të drejte...” (Surja Haxh: 39:40)

Shkurt, myslimanët u lejuan të bëjnë luftë vetëm pse ishin shtypur dhe ishin dhunuar. Me fjalë të tjera, Zoti u lejoi të luftojnë vetëm për t’u mbrojtur. Në vargje tjera të Kur’anit, myslimanët paralajmërohen që të mos përdorin provokime apo dhunë të panevojshme:

“Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë, e mos e teproni! Se Allahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë luftën).” (Surja Bekare:190)

Pas shpalljes së këtyre vargjeve, ndodhën disa luftëra mes myslimanëve dhe paganëve arabë. Sidoqoftë, në asnjërën nga këto luftëra myslimanët nuk ishin pala e cila e nxiti luftën. Për më tepër, Profeti Muhamed krijoi një mjedis shoqëror të sigurt e paqësor për myslimanët dhe paganët, duke nënshkruar Marrëveshjen e Paqes (të Hudejbijes) e cila u plotësi pjesën më të madhe të kërkesave të paganëve. Pala që i shkeli kushtet e marrëveshjes dhe nisi luftën e re, ishte përsëri ajo e paganëve. Sidoqoftë, me konvertimet e shumta në fenë Islame, ushtria myslimane arriti të krijojë

një forcë të madhe kundër arabëve paganë dhe Profeti Muhamed e mori Mekën nën kontroll pa gjakderdhje dhe me një shpirt tolerance. Për më tepër, ai nuk lëndoi askënd, ai i fali ata dhe i trajtoi me tolerancën më të madhe. Paganët, të cilët më vonë do të pranonin Islamin me vullnetin e tyre të lirë, nuk kishin si të mos e admironin këtë fisnikëri të karakterit të Profetit.

Parimet islame, që Zoti shpall në Kur’an, flasin për këtë politikë paqësore dhe të matur të Profetit Muhamed. Në Kur’an, Zoti i urdhëron besimtarët që t’i trajtojnë jomyslimanët me mirësi e drejtësi:

“Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë. Allahu ju ndalon t’u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta...” (Kur’ani 60:8-9)

Vargjet e mësipërme kuranore qartësojnë se si një mysliman duhet të sillet ndaj jomyslimanëve. Myslimani duhet t’i trajtojë të gjithë jomyslimanët me mirësi dhe duhet t’i shmangët miqësisë vetëm me ata që shfaqin armiqësi ndaj Islamit. Në rast se kjo armiqësi shkakton sulme të dhunshme ndaj ekzistencës së myslimanëve, pra, nëse ndaj tyre është ndezur një luftë e hapur, në këtë rast myslimanët duhet të përgjigjen atyre me drejtësi dhe duke pasur parasysh përmasat njerëzore të situatës. Të gjitha format e barbarizmeve dhe veprat e panevojshme të dhunës dhe të sulmeve të padrejta janë të ndaluara në Islam. Në një varg tjetër kuranor, Zoti i paralajmëron myslimanët për këtë dhe shpjegon se urrejtja e



Myslimani duhet t'i trajtojë
të gjithë jomyslimanët
me mirësi dhe duhet t'i
shmangët miqësisë vetëm
me ata që shfaqin armiqësi
ndaj Islamit.

ndjerë ndaj armiqve nuk duhet t'i shtyjë besimtarët të bëjnë padrejtësi ndaj tyre.

“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos t'u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë se ajo është më afër devotshmërisë. Kine frikë Allahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni.” (Kur'ani 5:8)

KUPTIMI I KONCEPTIT TË “XHIHADIT”

Një tjetër koncept që për shkak të kontekstit të diskutimit vlen të sqarohet, është ai i “xhihadit”.

Kuptimi i saktë i fjalës “xhihad” është “përpjekje”. Kështu, në Islam “të bësh xhihad”, do të thotë “të mundohesh, të bësh përpjekje”. Ndaj “xhihadi më i madh është xhihadi që njeriu kryen ndaj vetvetes.” Kjo nënkupton përpjekjen e njeriut për të luftuar dëshirat egoiste. Lufta e hapur në rrafshin intelektual ndaj anti-fesë, pikëpamjet ateiste, gjithashtu janë forma të xhihadit në kuptimin e plotë të fjalës.

Përveç këtyre kuptimeve ideologjike dhe shpirtërore, edhe lufta në kuptimin fizik konsiderohet si “xhihad”.

Sidoqoftë, si edhe u sqarua më lartë, kjo duhet të jetë një luftë që bëhet vetëm e vetëm për qëllime mbrojtëse.

Përdorimi i konceptit të “xhihadit” për veprat e dhunës kundër njerëzve të pafajshëm, siç është terrori, do të ishte i padrejtë dhe shtrembërim tepër i madh.

DHEMBSHURIA, TOLERANCA DHE HUMANIZMI NË HISTORINË ISLAME

Thënë shkurt, doktrina politike e Islamit është

të jashtëzakonisht paqedashëse dhe e moderuar. Kjo e vërtetë gjithashtu pohohet gjerësisht nga historianët dhe teologët jomyslimanë. Një prej tyre është historiania britanike Karen Armstrong, ish-murgeshë dhe eksperte me famë e historisë së Lindjes së Mesme. Në librin e saj “*Lufta e shenjtë*”, i cili merr në shqyrtim historinë e tri feve me origjinë hyjnore, ajo parashton komentet e mëposhtme:

...Fjala “Islam” në gjuhën arabe rrjedh nga e njëjta rrënjë me fjalën “paqe” dhe Kurani e denon luftën si një gjendje anormale e çështjeve, në kundërshtim me dëshirën e Zotit... **“...Sa herë që ndezën zjarr për luftë, Allahu ua fiku atë, e ata përpiqen për shkatërrime në tokë. Allahu nuk i do ngatërrestarët.”** (Kurani 5:64) Islami nuk e arsyeton një luftë tërësisht sulmuese shfarosjeje, sikur që e bënë Teurati në pesë librat e Biblës. Një fe më reale se Krishterimi, Islami pranon se lufta është e pashmangshme dhe nganjëherë, një detyrë pozitive për t'i dhënë fund shtypjes dhe vuajtjes. **Kurani mëson se lufta duhet të kufizohet dhe të zhvillohet në një mënyrë sa më njerëzore të mundshme.** Muhamedit i është dashur të luftojë jo vetëm mekasit, por edhe fiset çifute në atë zone si dhe fiset e krishtera në Siri, të cilët planifikonin ta sulmonin atë në aleancë me çifutët. Megjithatë, kjo nuk e bëri Muhamedin që t'i denonconte ithtarët e Librit. Myslimanët u detyruan të vetëmbrohen, por ata nuk po zhvillonin një “luftë të shenjtë” kundër fesë së armiqve të tyre. Kur Muhamedi dërgoi njeriun e tij, Zejdin, kundër të krishterëve, në krye të një ushtrie myslimane, ai i porosi ata **të luftojnë në rrugë të Zotit me trimëri, por njerëzisht.** Ata nuk duhej të shqetësonin as priftërinj, murgj e murgesha, e as njerëzit e dobët e të pandihmë që nuk ishin në gjendje të luftonin. Nuk duhej bërë masak-

ra ndaj civilëve, madje nuk duhej prerë as edhe një pemë apo rrëzuar ndonjë ndërtesë. Kjo ishte krejt ndryshe nga luftërat e Joshuas. (1)

Pas vdekjes së Profetit, myslimanët vazhduan t'i trajtonin anëtarët e feve tjera me tolerancë dhe respekt. Shtetet islamike u bënë shtëpi të sigurt dhe të lira për çifutët edhe të krishterët. Pas marrjes së Jerusalemit, Kalifi Omer i qetësoi të Krishterët të cilët i kishte kapluar frika e masakrës, dhe u sqaroi se ata ishin të sigurt. Për më tepër, ai u bëri vizitë kishave të tyre dhe u deklaroi se mund të vazhdonin të lirë të praktikonin adhurimin e tyre.

Në vitin 1099, 4 shekujsh pas marrjes së Jerusalemit nga ana e myslimanëve, kryqtarët e pushtuan sërish Jerusalemin dhe i vunë shpatën të gjithë banorëve mysliman. Përsëri, përkundër frikës nga ana e të krishterëve, Salahudini, gjenerali mysliman i cili e rimori Jerusalemin dhe e shpëtoi qytetin nga invazioni i vitit 1187, nuk e preku as edhe një civil të vetëm dhe nuk lejoi asnjë ushtarë që të plaçkitë. Veç kësaj, ai i lejoi pushtuesit e krishterë që të marrin të gjithë mallin e tyre dhe të largohen nga qyteti në siguri.

NJË PORTRET I TOLERANCËS NDAJ TË KRISHTERËVE NË TOKAT ISLAMIKE

Periudhat e Turqve Selxhukë dhe Perandorisë Osmane janë shënuar gjithashtu edhe me tolerancën dhe drejtësinë e Islamit. Siç edhe është e ditur, çifutët që ishin dëbuar nga Spanja katolike gjetën paqen që e kërkonin pikërisht në tokat e perandorisë osmane, ku u strehuan në vitin 1492. Sulltan Mehmedi, sundimtari i Stambollit, lejoi edhe lirinë e fesë së çifutëve dhe të krishterëve. Lidhur me tolerancën dhe drejtësinë e ushtruar nga myslimanët, historiani A. Miquel thotë si më poshtë:

Të Krishterët u qeverisën nga një shtet shumë mirë i administruar e që një gjë e tillë nuk ekzistonte në sovranitetin bizantin apo latin. Ata asnjëherë nuk ishin nënshtruar shtypjes sistematike. Përkundrazi, Perandoria, dhe për më tepër Stambolli, u bë strehë për çifutët më të torturuar spanjollë. Ata asnjëherë nuk u detyruan ta pranojnë Islamin. (2)

Profesori i fesë dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Xhorxhtaunit, Xhon L. Espozito, e komenton njëjtë:

Për shumicën e popullsisë jomyslimane në territoret Bizantine dhe Persiane, tanimë të nën-

shtruar, qeverisja islamike përbënte një ndryshim qeverisësish, më shumë fleksibile dhe tolerante. Shumica e kësaj popullsie tani gëzonin autonomi më të madhe dhe paguanin taksa më të ulëta... Islami u vërtetua si fe më tolerante, duke u ofruar çifutëve dhe të krishterëve vendas, një liri më të madhe fetare. (3)

Siç edhe u sqarua në këto fjalë, historia asnjë-

**Të gjitha format e barbarizmave
dhe veprat e panevojshme
të dhunës dhe të sulmeve të
padrejta janë të ndaluara në
Islam.**

herë nuk i dëshmoi myslimanët si "shkaktues të ngatërresave".

Përndryshe, ata i sollën siguri dhe paqe të gjithë njerëzve pa dallim kombësie e feje, të banuar në territore të gjëra me të cilat ata qeverisën. (Për më tepër, shih Drejtësinë dhe Tolerancën në Kuran, nga Harun Jahja, 2000)

Shkurt, dhembshuria, paqja dhe toleranca përbëjnë bazat themelore të vlerave të Kuranit dhe qëllimet e Islamit që të fshijnë ngatërresat nga faqja e dheut. Urdhrat e Kur'anit dhe praktika e myslimanëve gjatë tërë historisë janë aq të qarta sa nuk lënë hapësirë për polemikë.

* * *

Shënime:

1-Karen Armstrong, Holy Ear, MacMillian London Limitet, 1988, faqe 25

2- Feridun Emecen, Kemal Beydilli, Mehmet Ypirli, Mehmet Akif Aydyn, Ylber Ortayly, Abdülkadir Özcan, Bahaeddin Yediyyildyz, Mübahat

Kütükoğlu, Osmanly Devleti Medeniyeti Tarihi, (The History of the Ottoman State), Istanbul: 1994, Yslam Tarih, Sanat ve Kültür Aratyrma

Merkezi, faqe. 467

3- John L. Esposito, The Islamic Threat: Myth or Reality, Oxford University Press, New York, 1992, faqe. 39

Islami dhe sistemi botëror i tolerancës

I gjithë sistemi botëror, kushtetutat për të drejtat e njeriut, nenet dhe paragrafët që ceken nëpër këto kushtetuta, me shprehje të ndryshme kanë vendosur dhe cekur lirinë e të shprehurit, menduarit, veprimit e praktikimit të bindjes dhe fesë së vet, mësimi dhe përhapjes së asaj bindje në mënyrën që dëshiron dhe formimit të institucioneve për të zhvilluar dhe përhapur idetë e veta.

Në mesin e shumë gjërave që janë duke e preokupuar dhe shqetësuar individin dhe bashkësinë njerëzore të botës janë edhe mënyra, mundësia e të jetuarit të më shumë se një bashkësie fetare në një vend, liria dhe toleranca fetare, burimet dhe mësimet e fesë, ndikimi i fesë tek opinioni etj. Kjo brengë ka marrë një bujë të madhe edhe në mediat botërore aq sa në shumicën e rasteve ekspertëve fetarë apo teologëve u nevojitet që të distancohen nga një debat i tillë, pasi që me këtë kanë filluar të merren personat jo kompetent duke ia zbehur kështu vlerën secilës fe. Megjithëkëtë, duke qenë të bindur në ligjet që ka caktuar feja islame dhe duke lënë anash pohimet dhe thashethemet e mediave, na mbetet të cekim të vërtetën e lirisë dhe së drejtës fetare.

Pa dyshim se çdo traditë popullore, sjellje, mentalitet apo stil i jetës, në një mënyrë ose tjetër, ka ndikuar dhe ndikon ende tek popujt e tjerë. Për këtë edhe feja ka ndikuar në shumë popuj dhe në shumicën e rasteve i ka nxitur dhe udhëzuar ata në vepra të mira, në

një sistem më të shëndoshë familjarë, duke i larguar nga rruga e gabuar. Për këtë All-llahu i Madhëruar thekson në Kur'anin Fisnik:

*“ (Ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë; në rrugë të Fuqplotit, të Falënderuarit”.*¹ Nga ky ajet dhe shumë të tjerë së pari vërejmë se:

a) Njerëzimi pa marrë parasysh periudhën në të cilën ka jetuar, ka qenë në errësirë – rrugë të shtrembër;

b) Krijuesi ka dërguar pejmamber për ftesën e njerëzve në rrugë të drejtë;

c) Pasi që feja islame deklaroi se është fe e vetme e vërtetë, nga këtu vërejmë se ajo kujdeset për anëtarin e sajë në veçanti dhe mbarë njerëzimin në përgjithësi;

d) Ky ligj hyjnorë nuk i lë anash dhe as të skllavëruar njerëzit, por i fton të gjithë ata në bashkëjetesë, duke u garantuar të drejta dhe liri në jetë.

Për këtë shkak, me plotë të drejtë

1 Ibrahim, 14/1

të mund të themi se ndjenja për fe, është një ndjenjë e natyrshme e cila gjendet thellë në shpirtin e njeriut. Sikurse që organizmi i njeriut ka nevojë për ushqim material, lojëra etj. po ashtu është i nevojshëm që të ushqehet edhe përmes besimit në diçka. Nevoja për fe ekziston tek çdo individ, kështu që përveç nevojave konkrete, feja ndihmon që ai të ketë raporte më të mira me familjen, njerëzit e tjerë dhe dashurinë ndaj çdo krijese. Sepse feja është e vetmja alternativë e cila bën orientimin e jetës së njeriut në vërtetësi dhe shpëtim.¹

I gjithë sistemi botëror, kushtetutat për të drejtat e njeriut, nenet dhe paragrafët që ceken nëpër këto kushtetuta, me shprehje të ndryshme kanë vendosur dhe cekur lirinë e të shprehurit, menduarit, veprimin e praktikimit të bindjes dhe fesë së vet, mësimin dhe përhapjes së asaj bindje në mënyrën që dëshiron dhe formimit të institucioneve për të zhvilluar dhe përhapur idetë e veta. Përveç kësaj, në këto kushtetuta merr pjesë edhe mundësia dhe liria e të qënurit pjesëtar dhe pasues në një fe tjetër. Të gjitha këto janë dokumentuar në Kushtetutën Internacionale të të drejtave njerëzore, gjegjësisht në nenin 18-të. Kjo kushtetutë është votuar dhe aprovuar nga 40 vota pro dhe 8 abstenues.

Për liritë dhe të drejtat e njeriut, po ashtu janë preokupuar edhe të gjitha shtetet evropiane. Janë organizuar shumë konferenca të cilat kanë debatuar gjerë e gjatë lidhur me liritë dhe besimet e njeriut. Kjo çështje merr vendin edhe në Kushtetutën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin e 9-të, duke theksuar se për të gjitha liritë fetare, besimet dhe të drejtat e njeriut, askush nuk ka mundësi t'i ndalojë ata, përveçse nëse shkelen, teprohen dhe tejkalohen rregullat e parapara.² Këtyre sferave nuk

mund që tu distancohet as lideri fetarë i kishës katolike Papa Benedikti i XVI gjatë vizitës që bëri në Turqi më 26 Dhjetor 2006, ku si temë kryesore në mes tij dhe myftiut të Komunitetit Musliman Turk Ali Bardakoglut ishte toleranca fetare në botën moderne.³

Edhe bota islame, përmes konferencave, kuvendeve dhe tubimeve të ndryshme në bashkëpunim me shtetet botërore, kanë marrë vendime lidhur me liritë e njeriut. P.sh. Kushtetuta Universale Islame, 15. 4. 1980 - Londër; Kushtetuta e përgjithshme Islame për të drejtat e njeriut, 19. 9. 1980 - Paris; Kushtetuta e Kajros për të drejtat e njeriut, 5. 8. 1990; Kushtetuta e Iranit, 1990 etj. Gati të gjitha këto bashkohen në shumë pika që po ashtu janë të cekura edhe në kushtetutat e vendeve jo islame.⁴

Nëse kthehemi tek myslimanët e Ballkanit, do të vërejmë një bashkëbisedim mjaft rigoroz në mes feve e sidomos tek shqiptarët, ku mund të cekim raste të shumta që festat e tyre fetare i festojnë së bashku.⁵

Gjithashtu sistemi i fesë islame, është sistem që për herë të parë ka formuluar kushtetutën e sajë në lidhje me të drejtat dhe liritë e njeriut, e kjo quhet Kushtetuta/Karta e Medinës. Sapo që arriti në Medine Pejgamberi a. s. formuloi këtë kushtetutë.

Feja islame e qetësoi popullin e shfrenuar arab, e lartësoi moralin e tyre dhe injorantin e lartësoi në një shkallë të dijetarit. Bëri shpëtimin e gruas dhe femrës nga mbytjet që u bënë për së gjalli, më pas ai u bë shembulli dhe mostra më e mirë e të gjitha mbretërve dhe perando-

rive në lidhje me mënyrën e trajtimit të krijesës njerëzore. Kështu që mund të themi se në këtë rast fitimtare doli gruaja, sepse trajtohej si krijesë jo njerëzore, si e pa pastër dhe se deri në lindjen e islamit, gjegjësisht në shekullin VII-të nuk kishte kurrfarë të drejtash.⁶ Ajo edhe në këtë shekull po çliron shpirtin e shumë shkencëtarëve të mëdhenj botëror.

Të gjitha këto të drejta burimin e kanë në Kur'anin Fisnik, e më pas edhe në hadithin e Muhammedit a. s., vendimet e dijetarëve, gjykatave, etj.⁷ Duhet të kemi parasysh se në shumë vende në Kur'an përmendet termi *el-insân*-njeri dhe *ed-dînu*⁸ - fe; që në kuptimin më të ngushtë të sajë është feja islame. Por në kuptimin më të gjerë të saj, ka për qellim edhe fetë tjera, sepse këtë vet Kur'ani e pohon de ekzistojnë edhe fe të tjera por si fe e vetme e pranuar është islami.⁹ Shumë dijetarë islam dhe jo islam, janë munduar që të mbushin librat e tyre me liritë e njeriut dhe paqen që kjo fe e ndershme ia solli atij. Sepse Islami është fe e harmonisë, në këtë gjithësi të madhe, e cila i përfshinë të gjithë elementet, që nga grimca e imët e deri tek llojet më të përsosura të jetës së ndërlkuar. Tek ai, ekziston harmonia e të gjitha energjive, si përpjekja fizike për nevojat të domosdoshme po ashtu edhe dëshira e madhe shpirtërore për ngazëllim.¹⁰ Andaj të gjitha ato fajësimet dhe ideologji që i bëhen islamit, assesi nuk kanë ndonjë burim për t'i argumentuar tezat e veta. Përderisa në kushtetutën islame - Kur'an, sunnet etj.- nuk ka vend manipulimi i të drejtave të njeriut, çdo pohim tjetër mbetet i pa vërtetë.

Din-Devlet İlişkileri, Fransa Örneği", f. 9-11. terc: İzzet Er.) Stamboll, 1998.

3 Fjalimin e mbajtur që bëri mytia, shih: Revista "Hëna e Re" no. 195, f. 14-15, përkth. Zymer Ramadani.

4 Prof. Dr. Servet Armağan, Islam Hukukunda Temel Hak ve Hürriyetler, f. 30-33, Ankara, 2004.

5 Mr. Xhabir Hamiti, "Islami dhe Toleranca Fetare ndër Shqiptar", Dituria Islame/202, f. 7-8.

6 Prof. Dr. Bekir Topaloglu, "Islam'da Kadın". Stamboll.

7 Prof. Dr. Servet Armağan, po aty, f. 25-27, Ankara, 2004.

8 M. Fuâd Abdullbâkî, "El-Mu'xhemu'l-Mufehres li elfâdhil-Kur'ân-i'l-Kerîm", termi "ed-dînu", Bejrut, 2003.

9 Bekare 2/ 30,31; Ali İmran, 3/85.

10 Prof. Sejjid Kutb, "Islami dhe Paqia Universale", f. 24, Tetovë, 2005.

1 Shih: Prof. Dr. Saffet Köse, "İslam Hukuku Açısından Din ve Vicdan Hürriyeti", f. 11. Stamboll, 2003.

2 Jacques Robert, "La Liberté Religieuse et le Rélégieuse des Altes (Bat'da

BALLKANI DHE TOLERANCA OSMANE NË SHEK. XIV-XVII

*"Në këtë shtet, përballë ushqimit
të frëngut (katolikëve), e preferojmë
çallmën dhe shpatën e osmanit"*

(Gennadios-lider shpirtëror në Bizant)

Ardhja e shtetit Osman Ballkanin e gjeti në një pozitë shumë të vështirë sa i takon respektimit të së drejtës nacionale dhe fetare të tjetrit. Këtu dominonte fryma asimiluese e iniciuar dhe e realizuar nga serbët dhe grekët, të cilët vepronin në emër të ortodoksizmit, dhe nga katolikët, të cilët vepronin si propagandues të lëvizjes uniate të mëvonshme. Kjo armiqësi ishte rezultati i skizmës së madhe (viti 1054) që ndodhi me ndarjen midis kishës lindore dhe kishës perëndimore. Ata që më tepër vuanin nga kjo ishin kundërshtarët e konceptit të jetës dhe politikës së kishës krishtere, gjegjësisht kishës ortodokse. Në mesin e tyre mund të numërohen myslimanët e pakët në numër të Ballkanit para ardhjes së shtetit Osman, bogomilët dhe paganët, pasi nuk ka mundësi të argumentohet se të gjithë ballkanasit, pa asnjë përjashtim, kanë qenë të krishterë.

Shteti Osman, i cili paraqitet në situatën e lartpërmendur, kronologjikisht është njëri prej shteteve islame. Ai ishte një shtet me një shoqëri multietnike dhe multikonfesionale, kurse në asnjë mënyrë nuk

ishte shtet njënacional. Shprehjet që përdoren për këtë shtet si ai ishte shtet turk e jo osman, se ata kanë qenë turq e jo osmanë, nuk janë për asgjë tjetër, vetëm se për ta minimizuar madhësitinë dhe përkatësinë fetare të shtetit. Të thuash shteti turk është vetë shteti Osman, në sferën historike, shkencore dhe kulturore është gabim shumë i madh. Pasi i pari është shtet nacional me kulturë, gjuhë dhe nation të kufizuar. Ndërkaq shteti Osman, edhe pse është e vërtetë se element dominues në të ka qenë elementi turk, ka kuptim shumë më gjithëpërfshirës. Osmanë nuk janë vetëm turqit, por të gjithë popujt shtetformues në të: arabët, shqiptarët, kurdët, boshnjakët etj. Prandaj, nëse thuhet se shteti Osman është vetëm shtet turk, atëherë për shqiptarët është një nënçmim shumë i madh, sepse atyre u mohohet pjesëmarrja aktive në atë shtet, e kaluara historike dhe besimi i tyre islam. Pasi është më se e ditur se kjo nuk është tjetër vetëm se një propagandë antishqiptare e realizuar nga qarqe të ndryshme. Kështu është rasti me politikën ortodokse pro greke, e cila shqiptarët myslimanë i quan *turkoalvanoi* (shqiptarë turq).

Për periudhën e hershme të shtetit Osman nuk ka argumente dhe të dhëna bindëse historike ku mund të bazohen mendimet e historianëve në lidhje me veprimtarinë e sulltan Osmanit I, të Orhanit dhe të Muratit I. Historia e atëhershme më tepër bazohet në një numër të dhënash gojore. Por, më vonë, sidomos në kohën e sulltan Mehmet II. Fatihut dhe më vonë, ka mundësi që të bisedohet për mësimin e dokumenteve konkrete historike dhe të dhënave arkivore, sikur që janë dokumentet e dhëna në formë të beratit, fermanit, bujurulldisë, dekretit etj., prej nga buron edhe *kanun-i osmani* (ligji osman).

Nga fundi i shek. XIV, pasardhësit e sulltan Osmanit I. Gaziut, duke falënderuar fuqinë e aftësisë së tij, i cili është themelues i dinastisë osmane, dhe zhvillimin e ngjarjeve historike, formuan një perandori e cila do të shtrihej prej Danubit e deri në Eufrat. Themeluesi faktik i kësaj perandorie ka qenë sulltan Bajaziti I. (1389-1402), i cili njihet me epitetin "*Jëlldërëm*" (rufeja). Sulltan Pajaziti I. pati një fitore të plotë në Nikopol në vitin 1396 kundër kryqëzatave, e cila ishte njëra prej ushtrive më mbu-

rrëse në Evropën e atëhershme. Ai gjithashtu ka treguar vendosmëri ndaj memlukëve, e ka provokuar Tamerlandin e Azisë së Mesme dhe të Iranit, edhe pse nga ky i fundit e ka humbur luftën.

Qëllimi i luftës së shenjtë nuk ka qenë shkatërrim, por ka qenë nënshtrim i botës së jomyslimanëve, gjegjësisht i *darulharbit*. Profesor I. Bardhi në një shkrim të tij me titull "*Lufta e 'shenjtë' në religjionet monoiste*", vë në pah tri kuptimet e xhihadit, të cilat shprehin edhe dimensionet më të rëndësishme të xhihadit të përmendur në Kur'an. Sipas profesor Bardhit xhihadi ka kuptimin e luftës kundër vetvetes dhe shpirtit që dëshiron keq, luftës për përhapjen e islamit apo luftës kundër pabesimtarëve dhe luftës brenda rradhëve të veta kundër mysli-manëve jo të mirë. Osmanët i kanë hedhur themelet e shtetit të tyre botëror duke e bashkuar Anadollin dhe Ballkanin e krishterë nën patronatin e tyre. Shteti Islam me anë të luftës së shenjtë ka kontribuar edhe si mbrojtës i kishës ortodokse dhe i miliona të krishterëve të tjerë ortodoksë. Islami i ka garantuar të drejtën e jetës dhe të pasurisë edhe për të krishterët edhe për Hebrenjtë, me një kusht që ata t'i nënshtrohen shtetit dhe të paguajnë tatim (xhizje). Islami u ka lejuar që ata lirshëm t'i zbatojnë bindjet e tyre fetare dhe të jetojnë në përputhshmëri me ligjet e fesë së tyre. Kështu Osmanët, duke jetuar bashkë në një bashkësi me të krishterët, nga ana e tyre ata me një zemërgjerësi dhe me një tolerancë të madhe i kanë realizuar këto parime të Islamit. Në vitet e para të themelimit të Perandorisë Osmane, politika e udhëheqësve ka qenë që të mundësojnë nënshtrim vullnetar të shteteve dhe të principatave të krishtera dhe të fitojnë besimin e tyre para se të kapin armën.

Kështu është rasti edhe me sinjorët (vasalët) shqiptarë, të cilët i kishin pronat e tyre dhe i takonin besimit të krishterë. Shteti Osman, me kusht që ata të pranojnë autori-

tetin e tij, familjeve vasale të krishtera shqiptare, si: balshajtë, topiajt, dugagjinët, zakariotët, muzakët, zenebisët, aranaitët, vullkashinët, kastriotët etj., gjegjësisht sinjorët e tyre i pranoi si legjitim, duke mos kërkuar që ata të ndërrojnë besimin e tyre. Hyrjen e viseve të Ballkanit nën sundimin osman e kanë kushtëzuar kushtet gjeografike. Osmanët duke ndjekur rrugën *Via Ignatia*, në vitin 1385, nëpërmjet qytetit Ser, Manastir dhe Ohër, nga ana perëndimore arrijnë deri te bregu shqiptar. Sinjorët e rajonit (Shqipëri) e kanë pranuar autoritetin e Shtetit Osman. Linja e dytë ka depërtuar nëpërmjet Selanikut (Thesalonika) në vitin 1387. Linja e tretë e ka ndjekur rrugën prej Stambollit (Konstantinopoli-sit) drejt Beogradit, kështu që fusha e Maricës pa ndonjë reaksion shumë të ashpër më 1365 bie nën Shtetin Osman. Koha e depërtimit të osmanëve përkon me përçarjen politike që ndodh në mes të shteteve ballkanike, pasi që në atë kohë shumë mbretër, dhespotë, princa të principatave kufitare, për t'i kryer problemet e tyre të brendshme, pa hezitim kanë kërkuar ndihmë nga jashtë. Brenda atij kaosi që dominonte në Ballkan, osmanët udhëhiqnin një politikë të përshtatshme dhe vetëm ata posedonin fuqi ushtarake dhe sistem qendror, e cila ishte e patjetërsueshme për mbajtjen e rendit në Ballkan. Osmanët kishin edhe një përparësi pasi posedonin korpusin e jeniçerëve, e cila, sipas profesor Inalxhikut, ishte ushtria e vetme e rregullt në Evropë. Shikuar nga një anë tjetër, në çdo ushtri ballkanike të krishterë ekzistonin fraksione, ku disa dëshironin të bashkohen me hungarezët, kurse të tjerat me osmanët. Për shembull, popullata greke ortodokse ka reaguar në mënyrë fanatike kundër dominimit të italianëve dhe kundër çdo lloji të ndikimit të kishës katolike. Kështu që, grekët filluan që osmanët t'i llogaritin për aleat dhe udhëheqës së tyre, pasi këto të fundit sinjorët e krishterë i kanë pranuar edhe si të tyre. Në periudhën mes



Shteti Osman, i cili paraqitet në situatën e lartpërmendur, kronologjikisht është njëri prej shteteve islame. Ai ishte një shtet me një shoqëri multi-etnike dhe multikonfesionale, kurse në asnjë mënyrë nuk ishte shtet njënacional.

viteve 1346-1352, osmanët u futën në Traki si aleat të Jovan/Gjon Katakuzinit. Po ashtu, edhe kur bizantinët, hungarezët dhe vllëhtë bënë presion ndaj mbretit bullgar në vitin 1356 dhe 1366, osmanët i dërguan përforcime ushtarake si një aleat i tyre.

Një tolerancë e tillë te Osmanët kuptohet se buron nga ajo frymë fetare islame që bazat i ka në Kur'an dhe e cila shumë qartë mund të shihet te këshillat e shejhulislamëve dhe të qëndrimeve të vet sulltanëve ndaj jomysli-manëve. Veprime këto që jo atëherë, por edhe sot është shumë vështirë t'i hasësh tek shumë udhëheqës apo të dijetarë eminent të botës.

Sulltan Selimi I. në hyrje të Jerusalemit ka qenë i prituri nga patriku ermen Serkisi III., ku të njëjtit sulltani (viti 1517) i jep një edikt: "...kishat, manastiret dhe vendet e tjera të shenjta me cilat kushte kanë vepruar deri tash, do të vazhdojnë edhe më tutje, pa ndonjë ndryshim...askush prej vezirëve të mi nuk ka të drejtë të përzihet

dhe të shqetësorë, të prish ose të ndryshojë diçka...”.

Historiani gjerman F. Babinger shprehet se, sulltan Mehmeti II. Fatihu, përfaqësuesve të kishës ortodokse ua ka garantuar tre privilegje: asnjë kishë nuk do të shndërron në xhami, askush nuk ka të drejtë të përzihet në rituale kish-tare dhe se të krishterët ortodoks kanë të drejtë që t'i manifestojnë Pashkët. (F. Babinger, *Fatih Sultan Mehmed ve Zamani*, Stamboll, 2003, f. 105. Shih, M. Todorova, *Podbrani izvori za istorijata na balkanskite narodi XV-XIX vek*, Sofje, 1977, f. 47-49; S. Gerlah, *Dnevnik na edno ptuvane do Osmanskata porta v Carigrad*, Sofje, 1976, f. 50. Janë disa arsye që një kishë të shndërron në xhami: nëse kisha tregon dominimin politik dhe fetar të vendit në fjalë; nëse në një kishë është thirrur ezani, i cili nuk ka qenë gjithmonë rregull për shndërrimin e një kishë në xhami; nëse myslimanët kanë pasur nevojë për realizimin e obligimeve të tyre fetare; nëse vendasit janë bërë mysliman kisha e tyre është kthyer në xhami etj. (Shih, Ph. Mansel, *Dünyanın Arzuladığı Şehir 1453-1924 Konstantinopolis*, Stamboll, 1996, f. 48-49; A. Refik, *Onüçüncü Asr-i Hicride İstanbul hayatı (1786-1882)*, Stamboll, 1988, f. 20; *Osmanlı Başbakanlık Arşivi İstanbul, Mühimme Defteri*, v. 71, nr. 584 (989/1581); v. 52, br. 44 (991/1583); v. 62, nr., 209 (995/1587); v. 62, nr., 403 (996/1588); v. 62, nr., 209 (995/1587); v. 62, nr., 403 (996/1588). v. 62, nr., 209 (995/1587); v. 62, nr., 403 (996/1588)) Ndërkaq Gobineau në një debat të tij për religjionet në Azi, është shprehur se nuk ka fe më tolerante se Islami. Kështu që, ne nuk duhet të ndalemi tek ndonjë padrejtësi që është bërë për ndonjë moment të caktuar. Kështu mendon edhe orientalisti tjetër gjerman Mez.

Shteti Osman me platformën e vet shumë të qartë dhe të trashëguar nga e kaluara religjioze dhe e bazuar në shpalljen hyjnore-Kur'an dhe Sunet, arriti që në Ballkan dhe më gjerë, madje edhe të jomyslimanët, të formojë bindjen se ata janë më të preferuarit se të tjerët. Nga kjo lind edhe shprehja “më mirë një fes osman se sa një mertek katolik”.

Pozita adekuate në planin religjioz e superfuqisë së ardhshme qëndron në atë se Shteti Osman është gjendur në vendin kufitar ku janë takuar, në një anë, dy religjio-

net më të mëdha monoteiste botërore, islami dhe krishterimi, kurse në anën tjetër, ekzistonte atmosfera e tendosur, e cila ishte rezultat i anatemizmit reciprok (skizma e madhe-1054) në mes të dy kishave të mëdha të krishtera, katolicizmit dhe ortodoksizmit. Kurse pak më vonë krishterimi, sidomos kisha ortodokse, dhe hebraizmi do të marrin pozitën e tyre në strukturën sociale dhe ekonomike të Shtetit Osman, gjegjësisht në kuptimin multikonfesional dhe multinacional të tij.

Një moment tjetër me rëndësi që duhet theksuar dhe përmendur këtu dhe i cili paraqet një faktor

Xhiahadi ka kuptimin
e luftës kundër
vetvetes dhe shpirtit
që dëshiron keq,
luftës për përhapjen
e islamit apo luftës
kundër pabesimtarëve
dhe luftës brenda
rradhëve të veta
kundër myslimanëve
jo të mirë.

relevant dhe vendimtar në Evropë dhe Ballkan, por që ka qenë jashtë kufijve të Shtetit Osman, është prezenca e kishës katolike, gjegjësisht e papës si një tutor dhe si një dirigjent i jetës politike dhe fetare të evropianëve, periudhë kjo në të cilën Evropa e atëhershme vuante nga presioni i mentalitetit inkuizicionar i luftërave të kryqëzatave. Luftërat e kryqëzatave, kolonializmi klasik dhe anatemizmi i ushtruar ndaj botës islame vërtetohet me anë të qëndrimit negativ që ka ndikuar në formimin e qëndrimit fetar të të krishterët ndaj islamit, sidomos të bota katolike. Gjatë kë-

tij studimi është me rëndësi dhe me interes të theksohet se gjatë periudhës historike prej shek. XII e deri në shek. XV, është bërë një literaturë e tërë, përmbajtja e së cilës është përplot me paragjykime dhe qëllime propagandistike në lidhje me personalitetin e të dërguarit të Allahut (xh.sh.), Muhamedit (a.s.) dhe me autenticitetin e librit hyjnor islam, Kur'anit. Gjë kjo e cila nuk ndodh në botën islame, gjegjësisht në Shtetin Osman, kundër jomyslimanëve. Po ashtu, periudha historike para dhe gjatë paraqitjes së Shtetit Osman, është një periudhë e humbjes së rolit të fesë (hyjnore-metafizikës) përballë shkencës dhe jetës sociale e ekonomike në shoqëri në kontinentin evropian, ku vend të rëndësishëm zë edhe Gadishulli Ballkanik. Kjo ishte periudha kur është paraqitur renesanca, për të cilën mendimtari islam bashkëkohor, S. H. Nasr, thotë se, ajo në bazë është jo islame dhe ka frymë jo religjioze. Këto përpjekje që fillojnë në shek. XII, në kohët e mëvonshme do të përfundojnë me koncepte jo religjioze të të jetuarit, të të mësuarit, të të studiuarit dhe të të organizuarit e jetës në përgjithësi. Ai vazhdon duke thënë se, ky koncept/sistem më vonë do të quhet sekularizëm/shekullarizëm, i cili definohet si mënyrë e dorëheqjes së njeriut nga mënyra e të të jetuarit në mënyrë religjioze, si dhe prej metafizikës. Në këtë drejtim Shteti Osman me karakterin e tij religjioz dhe me prezencën e tij në këtë rajon, ka luajtur një rol të madh në riaktivizimin ose rehabilitimin e jetës fetare, religjioze dhe metafizike.

Shikuar në aspektin religjioz, është me rëndësi të potencohet se, në atë kohë në Ballkan ekzistonte edhe një kishë tjetër e quajtur kisha bogomile (patarene, babun), e cila e mori emrin sipas priftit Bogomil. Kjo kishë ballafaqohej me atë që të shpëtojë veten nga asimilimi që ushtrohej nga mbretëria Hungareze dhe papa. Kështu që, ishte e detyruar të kërkojë strehim në qytetet osmane, gjegjësisht të bëhen

myslimanë.

Sipas historianit A. B. Kopanski, në fillim të shek. XIV politika serbe ka filluar konkretisht të zgjerohet në jug të Ballkanit, e cila pjesë më herët ka qenë nën Perandorinë Bizantine. Serbët prej bizantinëve kanë trashëguar dy ideologji religjioze. E para, idenë për superioritetin e krishterimit. E dyta idenë e armiqësisë ndaj myslimanëve, e cila buronte nga frymëzimi i priftërinjve bizantin që ata e kanë marrë në malin Athos. Ashtu që, mbreti serb, Stefan Dushani, vetveten e ka deklaruar: "Lider i të gjithë të krishterëve dhe kundër myslimanëve". Kurse mbreti Stefan Nemanja qysh në vitin 1169 e ka okupuar Bosnjën, kurse popullatën e cila nuk e ka pranuar besimin ortodoks (bogomilët) e ka maltretuar dhe torturuar.

Dokumentet osmane janë ato që flasin për ekzistimin e një të drejte të qytetarëve, pa dallim feje dhe kombi që ai i takon-*sistemi Millet*, në shtetin Osman.

Sistemi *Millet* në shtetin Osman paraqiste një etnikum, i cili nuk kuptohej vetëm si një etnikum nacional, por ai në vete ngërthen një grup njerëzish që i tejkalojnë kufijtë nacionalë. Në konceptin osman termi *Millet*, shikuar në aspektin historik, paraqet një fakt *sui generis*, që tregon se shteti Osman është një bashkësi origjinale kulturologjike dhe sociologjike. Ky sistem nuk mund të krahasohet as me statutin e pakicave në shtetet kolonizuese e as me strukturën e shoqërive federative. Ndërkaq, nga e gjithë kjo del se në shtetin Osman njerëzit në aspektin religjioz janë klasifikuar në myslimanë (muslimler) dhe në jomyslimanë (gajrimuslimler). Dallimi në mesin e tyre ka qenë në bazë të obligimeve që ata kanë pasur ndaj shtetit. Jomyslimanët kanë pasur edhe obligimet edhe të drejtat e tyre.

Lirisht mund të themi se, asnjëherë të krishterët dhe hebrenjtë në shoqërinë multi-etnike islame nuk janë trajtuar ashtu sikur shteti

Lirisht mund të
themë se, asnjëherë
të krishterët dhe
hebrenjtë në
shoqërinë multi-etnike
islame nuk janë
trajtuar ashtu sikur
shteti katolik në
Spanjë i ka trajtuar
hebrenjtë në shek.
XIV-XV.



katolik në Spanjë i ka trajtuar hebrenjtë në shek. XIV-XV.

Prej obligimeve të jomyslimanëve ndaj shtetit Osman janë haraçi dhe xhizeja. Fjala haraç është fjalë arabe dhe ka kuptimin e taksës, gjegjësisht taksës për tokën. Kurse xhizeja është një taksë që merrej prej pasurisë materiale të cilën dhimmii e posedon dhe është një marrëveshje në mes të shtetit islam dhe jomyslimanëve që jetojnë në atë shtet. Xhizeja është detyrim që paguhet për të fituar garancinë dhe mbrojtjen shtetërore, me të cilën një dhimmi do të jetë i liruar nga shërbimi ushtarak. Pra një jomysliman i krishterë do të paguaj xhizje për t'i shërbyer arkës së shtetit, kurse një mysliman një gjë të tillë e bën duke dhënë zeqatin, për të cilin jomyslimani nuk është i obliguar. Dallimi në mes të haraçit dhe të xhizjes është se nëse një jomysliman bëhet mysliman, prej xhizjes lirohet, kurse prej haraçit jo.

Një çështje tjetër që duhet të përmendet është sistemi i devshirmesë. Devshirme ishte një sistem nëpërmjet të cilit zmadhohej numri i ushtarëve në shtetin Osman. Ligji për aktivizimin e devshirmesë daton nga koha e sulltan Muratit II., sipas të cilit ligj shteti Osman prej popullatës jomyslimane (krishtere), gjegjësisht prej çdo 40 shtëpive

të krishtera ka marrë nga një fëmijë mashkull të moshës të caktuar prej 8 deri në 18 vjeç, kurse më e realizueshmja ka qenë prej moshës 14 deri në 18 vjeç. Ky ligj është praktikuar vetëm sipas nevojës së shtetit. Në çdo kadilluk, kudo që të ishte, në fillim popullata është lajmëruar për grumbullimin e devshirmesë. Pastaj fëmijët e krishterë me prindërit e tyre ose me shoqërimin e priftërinjve janë tubuar në vendin e caktuar. Me vete ata kanë pasur edhe defterët ku kanë qenë të regjistruar emrat e fëmijëve devshirme. Të tillët u janë dorëzuar kompetentëve si kadiut, spahiut ose qehasë së fshatit. Të gjithë ata që janë marrë me devshirmenë janë paguar nga ana e shtetit. Ky ligj në fillim është realizuar vetëm në pjesën evropiane të shtetit Osman (Ballkan), kurse ka fundi i shek. XV ka filluar të praktikohet edhe në popullatën e krishterë në Anadoll. Sistemi devshirmesë një jomyslimanit ia mundëson që ai të marrë pjesë në ushtrinë dhe administratën osmane, kurse një mysliman nuk merret si devshirme, por ai shkon ushtar. Ky është një lloj balansi që shteti Osman e ka bërë në mesin e njerëzve, pa dallim feje.



Jë kapërdish zemërimit

Prandaj edhe vesi i
parë i mbrapshtë që
duhet të asgjësojë nga
vetvetja individi për të
bërë para në udhën
e drejtë, është pa
dyshim zemërimi, sepse
zemërimi, është më i
tmerrshmi nga veset
e mbrapshta dhe më
fatali nga fatkeqësitë
shpirtërore, i cili mund
të përngjasohet me
një perde që i mbulon
mendjen dhe shpirtin.

Njeriu, i ardhur në këtë botë si panoramë e bukurive hyjnore, është lënë kokë më kokë vetëm me veprat e mbrapshta dhe mëkatore të egos së tij dhe me tendencat drejt devotshmërisë që gjenden në botën afektivo-shpirtërore të tij. Duam të themi se njeriu ka prirje si ndaj të mirës dhe të bekuarës, ashtu edhe ndaj të gabuarës.

Nga ky aspekt del në pah edhe domosdoshmëria e pastrimit të cilësive dhe tendencave njerëzore të ulëta dhe perfeksionimi i karakteristikave shpirtërore me anë të pastrimit të egos, mbarështrimit të zemrës dhe zbukurimit të moralit. Prandaj edhe vesi i parë i mbrapshtë që duhet të asgjësojë nga vetvetja individi për të bërë para në udhën e drejtë, është pa dyshim zemërimi, sepse zemërimi, është më i tmerrshmi nga veset e mbrapshta dhe më fatali nga fatkeqësitë shpirtërore, i cili mund të përngjasohet me një perde që i mbulon mendjen dhe shpirtin. Njeriu i zemëruar është një qenie fatkeqe, bota e brendshme e të cilit është e

mbushur përplot me ndjenjat e hakmarrjes, mllëfit, fyerjes, zënkave dhe krimeve.

Perdja e zemërimit në librin e jetës është historia e një katastrofe. Shpëtimi nga ky rrezik është të përdorësh forcën e vëllazërisë dhe durimit përballë kësaj situate të pakëndshme dhe të mbështillesh nga atmosfera e qetësisë pa e prishur ekuilibrin. Kur Ebu Derda e pat pyetur të dërguarin e Allahut Muhamedin (a.s.) që t'i rrëfente një gjë që po ta kryente do ta dërgonte në parajsë, Muhamedi (a.s.) iu përgjigj:

- Mos u zemëro!

Kur një herë tjetër dikush i pat thënë:

“- O i dërguar i Allahut! Nuk kam takat të bëj shumë gjëra që më urdhërohen! Më mëso diçka të shkurtër që do të më siguronte lumturinë në këtë botë dhe tjetrën!”

Muhamedi (a.s.) i qe përgjigjur:



Perdja e zemërimit në librin e jetës është historia e një katastrofe. Shpëtimi nga ky rrezik është të përdorësh forcën e vëllazërisë dhe durimit përballë kësaj situate të pakëndshme dhe të mbështillesh nga atmosfera e qetësisë pa e prishur ekuilibrin.

“-Mos u zemëro!”

Në një tjetër hadith thuhet:

“Allahu ia mbulon gabimet personit që di ta përmbajë zemërimitin e tij!”

“Nuk ka kafshatë më të begatë se të kapërdish zemëratën tënde në mënyrë që të sigurosh pëlqimin hyjnor në agorën e Allahut!”

“Trim i madh nuk është ai që mund me trup çdokënd që i del përpara, por ai njeri që e përmban veten në momentet e zemërimit.”

Profetët, dijetarët dhe të devotshmit në fe (evlija) përherë kanë treguar një zell dhe delikatësi në mënyrë që të mposhtin zemërimin që i kaplonte dhe e patën shndërruar në hare ndjenjë e faljes së gabimeve të tjetrit. Kur profeti Jusuf (a.s.) i pati falur vëllezërit e tij që patën menduar aq keq për të sa që të përgatitnin edhe komplot për asgjësimin fizik të tij, megjithëse ai e kishte në dorë rastin dhe

fuqinë për ta bërë këtë gjë, ata u patën penduar për mëkatet që kishin kryer, i patën kërkuar falje Allahut dhe e patën dorëzuar vetveten tek Jusufi duke thënë:

“Betohemi se me të vërtetë Allahu të ka bërë ty superior mbi ne. Ne kemi gabuar rëndë rreth teje.” (Jusuf, 91)

Kurse Jusufi (a.s.) u qe përgjigjur me këto fjalë:

“Trim i madh nuk është ai që mund me trup çdokënd që i del përpara, por ai njeri që e përmban veten në momentet e zemërimit.”

“Sot nuk do të ketë ndaj jush asnjë qortim. Allahu u faltë; Ai është Mëshiruesi Mëshirëmadh.” (Jusuf, 92)

Shembujt më të bukur të mëshirës dhe faljes së gabimeve që kryen tjetri, gjenden në jetën e bekuar të profetit Muhamed (a.s.)

Profeti Muhamed (a.s.) e pat falur ditën e ngadhënjimit në Meke edhe gruan e quajtur Hint e cila më përpara ia kishte bluar me dhëmbë mushkëritë xhaxhait të dashur të Profetit, Hamzait. E fali edhe Habir ibn Esedin, personin që u bë shkak që Zejnepja me fëmi në barkë të rrëzohej nga deveja me ç’rast u plagos mjaft rëndë, vetëm në këmbim të fjalëve të shehadetit që ai i shqiptoi.

Kur zemërohej profeti Muhamed (a.s.) nuk ngrihej nga vendi ku qe i ulur. Nuk e zemëronte asgjë tjetër përveç rasteve ku dillej kundër urdhrave të Zotit dhe abuzohej me të drejtën e dikujt.

Zemërohej edhe kur shtypej ndonjë e drejtë paçka se të tjerët nuk e vinin re këtë situatë dhe nuk i kalonte zemëratat përderisa e drejta të mos shkonte në vendin që e meritonte.

“Të devotshmit janë ata që dhurojnë për hir të Allahut edhe kur janë mirë materialisht edhe kur janë ngushtë, e gëlltisnin zemëratën dhe ua falin gabimet të tjerëve. Allahu i do njerëzit bamirës që sillen në këtë mënyrë.”

(Al-i Imran, 134)



Qetësohej shpirtërisht vetëm kur shihte që ngado përhapej drejtësia. Kurrë nuk ka ngjarë të jetë zemëruar për arsye personale. Nuk hidhej në mbrojtje të vetvetes dhe nuk debatonte me kënd për shkaqe vetjake.

Kjo gjendje e tij është përmendur me fjalë respekti në agorën hyjnore, ndërsa Kurani e paraqet si një nga faktorët kryesor në suksesin që pati profeti Muhamed (a.s.) gjatë shërbimit të tij të thirrjes në fenë islame:

“(O Muhamed!) Atëherë ti u pate sjellë butë me ta me anë të mëshirës nga ana e Zotit tënd. Poqe se ti do të silllesh rëndë me ta dhe do të qëndroje zemërgurë, nuk ka dyshim se njerëzit do të qëndronin larg teje. Prandaj fali ata, lutu të fitojnë faljen hyjnore, merru mendim për punë të kësaj bote! Kur të marrësh ndonjë vendim, mbështetu në Allahun dhe besoji Atij! Allahu i do ata që sillen në këtë mënyrë.” (Al-i Imran, 159)

Në një tjetër ajet të Kuranit, Allahu (xh.sh.) i karakterizon njerëzit bamirës si personat që e përmbajnë zemërimin e tyre dhe ua falin gabimet të tjerëve:

“Të devotshmit janë ata që dhurojnë për hir të Allahut edhe kur janë mirë materialisht edhe kur janë ngushtë, e gëlltisnin zemëratën dhe ua falin gabimet të tjerëve. Allahu i do njerëzit bamirës që sillen në këtë mënyrë.” (Al-i Imran, 134)

Sipas një rrëfimi tregohet se Xhafer Sadiku zotëronte një skllav, i cili i shërbente për nevojat e tij të përditshme. Një ditë prej ditësh, teksa po i

shpinte pjatën me supë për ta ngrënë, skllavi pa dashje e derdhi atë mbi Xhaferin (r.a.). Xhaferi, koka dhe rrobat e të cilit u përlyen sa andej-këndej me supë, i hodhi një vështtrim të egër dhe të zemëruar skllavit, i cili duke lexuar një pjesë nga ajeti kur'anor i tha:

-Imzot! Në Kur'an thuhet “ata që e kapërdijnë zemërimin e tyre”.

Atëherë Xhaferi (r.a.) tha:

-Edhe unë e përmbaj zemërimin tim!

Skllavi vazhdoi të thotë:

-Në të njëjtin ajet të Kur'anit thuhet edhe “ata që ua falin njerëzve gabimet që bëjnë!” dhe lexoi pjesën e ajetit në lidhje me këtë.

Xhaferi (r.a.) tha:

-Mirë pra, të kam falur!..”

Këtë herë skllavi tha:

-Në të njëjtin ajet të Kur'anit thuhet edhe “Allahu i do njerëzit që bëjnë vepra të mira dhe dhurojnë në rrugën e Zotit!»

Xhaferi (r.a.) tha:

“-Ik, je i lirë. Ta fala lirinë për hir të Allahut!..”

Sa shfaqje e bukur e konkretizimit në jetën personale të moralit që na mëson Kurani dhe e pat jetuar profeti ynë Muhamedi (a.s.) është ngjarja që sapo rrëfem.

Një tjetër shembull të rrallë

dhe të bukur të individit që në Kur'an cilësohet si "ata që e përmbajnë zemërimin" është ekspozuar edhe në jetën personale të Aliut (r.a.)

Në një betejë Aliu e kishte vënë përposh ushtarin e kundërshtarit dhe kishte ngritur shpatën që ta vriste. Ushtari që e ndjeu vetveten të mbërthyer fort nga kthetrat e vdekjes, vendosi të bëjë një akt të neveritshëm përballë pafuqisë që e kishte kapluar dhe e pështyu në fytyrë Aliun (r.a.)

As që bëhej fjalë që Aliu (r.a.) mos t'ia kishte fluturuar kokën ushtarit armik që e kishte gju-njësuar në fushë të betejës, por ai duke ia pasur frikën forcës dhe cytjeve të egos personale ndali një çast dhe duke e ulur dalëngadalë poshtë shpatën e bekuar që i kishte dorëzuar profeti Muhamed (a.s.), hoqi dorë nga akti i vrasjes së armikut të luftës.

Njeriu i ngratë i shtrirë pa shpresë në tokë në pritje të furisë që do t'i jepte fund jetës së tij, shtangu nga habia përballë kësaj situate.

Ai ishte i bindur se me veprimin e fundit që kreu Aliu do ta kishte copëtuar edhe më keq më shpatën e tij për shkak të indinjimit dhe zemëratës, madje më keq nga ç'kishte menduar më parë. Nuk ngjau ajo që mendoi dhe ai u ballafaqua me një të vërtetë që nuk do ta kishte fantazuar. Ushtari armik që nuk e kuptonte sjelljen e Aliut (r.a.), ngadhënjimtarit mysliman të shpirtave, e pyeti Aliun me çudi:

-O Ali! Pse ndale pikërisht në

atë moment ku me një të sëlluar të shpatës, do të ma kishe marrë jetën? Pse nuk më vrave? Ç'ngjau që nga tërbimi i pafre kalove në qetësi të pashpëguar! Pse u shndërrova nga një shkrepitimë përcëlluese në një qiell të pastër dhe të qetë?

Aliu (r.a.) tha:

- Unë këtë shpatë të bekuar që më ka dhuruar Muhamedi (a.s.) e tund vetëm në rrugën e Allahut. Me të ua pres kokën armiqve të fesë dhe tradhtarëve po për hir të Zotit. Asnjëherë nuk e përziej egon time në këtë mes, sepse unë jam luani dhe shpata e Allahut dhe nuk jam skllav i mendjemadhësisë dhe krenarisë vetjake. Duke më pështyrë në fytyrë ti kërkove të më fyeje dhe të më xhindosje edhe më shumë. Po që se në atë moment do të më kishte kapluar tërbimi, do të kisha vrarë për shkak të fyerjes që ti më bëre mua si person, gjë që nuk i ka hije një besimtar. Unë nuk luftoj ta qetësoj shpirtin tim luftarak dhe egon personale, por luftoj për hir të Allahut.

Si përfundim zemra dhe shpirti i ushtarit armik u ringjallën përballë këtij morali sublim të lavdëruar. Pastaj e kuptoi enigmën e miqësisë dhe duke marrë pjesë nga cilësitë që e karakterizonin Aliun (r.a.), siç janë zemërbutësia, toleranca, mëshira, butësia dhe pengesa ndaj egos, besoi dhe u bë mysliman.

Këtë ngjarje Mevlana na e rrëfen me këtë mënyrë në stilin e tij metaforik:

Me veprimin që kreu Aliu sikur t'i thoshte ushtarit armik:

O njeri! Dije mirë se shpatën time e përdor vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut, rob i të cilit jam unë. Unë jam luani i Allahut, jo i dëshirave të mia të kësaj bote. Fakti që shpata ime nuk mposhtet nuk më takon

Shembujt më të bukur të mëshirës dhe faljes së gabimeve që kryen tjetri, gjenden në jetën e bekuar të profetit Muhamed (a.s.)



mua por Allahut. Unë e kam numëruar me zero shpirtin tim në rrugën e Allahut dhe për sa kohë që të jem me Të kërkoj vetëm kënaqësinë e Zotit tim. Unë jam shkrirë në enigmën e ajetit kur'anor "Kur të gjuash me shigjetë nuk je ti që e lëshon shigjetën nga harku, por Allahu (xh.sh.) (el-Enfal, 17). Unë jam vetëm mbajtësi dhe rojtari i kësaj shpate, por ai që të mëshon me të është Allahu (xh.sh.) Unë e njoha egon time. Ruhem nga gabimet e saj. Prandaj edhe u kthej shpinën të gjitha gjërave që nuk më shpien tek kënaqësia e Allahut (xh.sh.) Të gjitha gjërat që i bëj në rrugën e Allahut, janë larg imitimit të verbër, fantazisë dhe dyshimit. Unë preferoj që të jem në rrugën e Allahut jo një pikë ujë, por një burim që gjarpëron furishëm ngaherë. Kjo është rruga e vetme që një ditë të mund të mbërrish në detin e takimit me Zotin tënd. Unë jam si një shpatë e stolisur me margaritarët që vezullojnë forcën e njësisë hyjnore. Prandaj edhe nëpër beteja dëshiroj t'i ringjall shpirtrat e

ushtarëve armiq, jo ti vras ata.

Prandaj edhe gjatë kësaj beteje kur ti më pështyve në fytyrë dhe ndjeva se në shpirtin dhe zemrën time lëshoi rrënjë ndjesia e hakmarrjes personale, preferova që ta fusja shpatën në mill për ta nxjerr prej aty vetëm atëherë që të përgëzohem se

"Njerëzit e Mëshiruesit janë ata që ecin nëpër botë me modesti dhe përlule dhe kur injorantët u drejtohen me shprehje të ulëta ata u përgjigjen "paqe"."

(el-Furkan, 63)

jam nga njerëzit që dashurojnë vetëm për hir të Allahut dhe urrejnë po për hir të Tij.

Dëgjo fjalën e dëshmisë të një personi të lirë në rrugën e Allahut, sepse dëshmia e njeriut që është kthyer në skllav të egos së tij nuk vlen as sa dy kokrra meli. Liri do të thotë të

shpëtosh nga cytjet e vetvetes. Ai që është skllavi i egos dhe epshit vetjak gjendja e tij është më e keqe edhe se e skllavit dhe robit të luftës, pasi që skllavi edhe mund të fitojë një ditë lirinë pasi ta ketë marrë këtë të drejtë nga zotëria i tij, ndërsa ai që është skllavi i egos dhe pasioneve do të zgjohet nga dehja e kënaqësive temporale që përjeton vetëm kur të përfundojë në një humbje të përhershme apokaliptike. Ata që i shkojnë pas egos dhe pasioneve të tyre e hedhin vetveten në një pus aq të thellë sa që nuk ka litar aq të gjatë që do të mbërrinte aty ku janë dhe t'i nxirrte jashtë pusit.

O njeri! Nuk ka në mua cilësi tjetër të ndryshme nga atributet që gëzon Zoti. Poqe se dëshiron të hysh nën hijen e këtij pusheteti, afromu! Të fitosh lirinë në sajë të mirësisë dhe mëshirës së Allahut, sepse mëshira e Tij e tejkalon hidhërimin e Tij.

Ja pra, tani ti shpëtove nga reziqet. Më parë ti ishe një gur i rëndomtë i pavlerë, ndërsa



tani, në sajë të eliksirit të besimit, u shndërrova në një margaritar të rrallë. Shpëtova nga kufri dhe gjembishtja e saj. Tani ti do të çelësh si një trëndafil në kopshtin hyjnor. O ti, që nderova me dritën hyjnore! Ti je prej meje dhe unë jam prej teje. Edhe ti u bërë tashmë një si Aliu. Atëherë kur situata të jetë e tillë si mund ta vras unë vetveten?!

Ashtu sikurse Umerin (r.a.), para se të bëhej mysliman, dëshira për të vlarë Muhamedin (a.s.) e pat shpënë drejt e tek streha hyjnore e mëshirës, edhe mëkati yt e morri me vete shpirtin tënd për ta shpënë në melhemin e përudhjes hyjnore. Ai që diti t'u shmanget gjembave të mosbesimit, u shndërrua në trëndafilin e besimit. I lumi ti!

Ç'portë sublime i hapi Aliu (r.a.) personit që e pështyu në fytyrë duke i dhuruar jetë personit që ishte nisur të përleshej me të për jetë a vdekje, duke e vlerësuar të merituar për lumturinë e vërtetë personin që ia

lejoi vetvetes dhimbjen dhe fyerjen e Aliut (r.a.)

Ai i shërbeu si një urë madhështore që zgjatet drejt qiejve të përjetësisë dhe begatisë personit që për veten e tij kërkonte të keqen duke hapur pusë të thella përreth vetvetes. Iu përgjigj me trëndafilë kriminelit që deshi ta therte me gjemba. Një shpirt të vrazhdë e ujiti me ujin e mëshirës së papërshtatshme, pa u dhënë rëndësi, gjembave që i hynin nëpër duar dhe i nguleshin në fytyrë, dhe kështu arriti ta shndërrojë atë në një burbuqe të rrallë, duke u sjellë në këtë mënyrë ashtu sikurse Musai (a.s.), i cili i pat zhytur në prehjen dhe kënaqësinë e besimit magjistarët që kërkonin ta frikësonin me anë të magjive dhe namatisjeve. Përballë këtij morali të lartë djalli i mallkuar plasi nga zilia dhe smira dhe u bë dysh.

Allahu urdhëron dhe thotë:

“(Profeti im!) Zë rrugën e faljes, urdhëro për të mirën dhe

kthejua shpinën injorantëve!..” (el-A'raf, 199)

Në një ajet tjetër Allahu (xh. sh.) i karakterizon me këto cilësi robërit që e besojnë Atë me sinqeritet:

“Njerëzit e Mëshiruesit janë ata që ecin nëpër botë me modesti dhe përlulje dhe kur injorantët u drejtohen me shprehje të ulëta ata u përgjigjen “paqe”. (el-Furkan, 63)

Imam Shabi, një nga të mëdhenjtë e tabinëve, një mëkatari që e pat fyer rëndë, i qe përgjigjur:

“-Poqe se janë të vërteta ato që thua Zoti më faltë! Poqe se je duke shpifur Zoti të faltë!”

O Zot! Na shpëto prej të qënit zebun të shpirtrave tanë! Na i stolis zemrat tona me moralin e lavdëruar me të cilin Ti mbetesh i kënaqur!

Amin!



I pafuqishëm

Idashuri lexues që në këto momente i ke mbërthyer sytë e tu dhe po vështron me kujdes rreshtat e këtij shkrimi...

Fakti që ti i lexon këto rreshta më shtyn më tepër që të jem pranë teje...

Prandaj të jam shumë mirënjohës. Edhe Allahu i Lartë urdhëron e thotë: "Falënderimi ndaj robit është edhe falënderim ndaj Meje" Kjo është edhe arsyeja që të falënderoj ty për zemërsisht.

Në fakt, nuk e di se ku ndodhesh tani që e lexon këtë shkrim. Nuk e di as se kush je? Çfarë moshe ke? Ç'punë bën? Çfarë ndjenjash ke dhe në ç'prova kalon? Nuk e di as edhe çfarë të pëlqen apo ç'të mërzit. Kjo është edhe arsyeja që dëshiroj të ndaj me ty atë që kam për zemër, atë që ndjej. Gjithsesi jam i bindur dhe kam besimin e plotë që në një mënyrë apo në tjetrën ke për t'u ndikuar nga këto rreshta. Pasi në fund të fundit ne jemi vëllezër... Kjo pasi ti me hidhërimin apo gëzimin tënd, pak apo shumë më ngjason mua... Atëherë unë do të shkruaj me dëshirën që në çdo fjalë apo fjali të gjesh vend edhe ti, të zgjerosh horizontin tënd

dhe të gjesh prehje në të... Por, sa e lehtë është kjo? Mendoj se nuk është aspak e lehtë, por je ti i dashur lexues, që më jep forcë dhe kurajë për të qenë bashkë në çdo moment të leximit.

Shumë herë njeriu e ndien veten të pafuqishëm nga shumë e shumë ndodhi dhe ngjarje që sjell çasti. Mbetet përherë në një vetmi që as vetë nuk di ta shpjegojë, nuk di t'i gjejë një rrugëzgjidhje, e ka të vështirë për momentin të pranojë pafuqishmërinë e tij për realizimin apo kryerjen e asaj pune, por ja që vjen një çast kur e pohon me vetëdije të plotë se është i pafuqishëm dhe kërkon ndihmë. Dhe kjo ndodh tek çdo njeri, pa dallim moshe.

I pafuqishëm është fëmija që në çastet e para të zhvillimit të tij. Mundohet dhe përpiqet me të gjitha mënyrat që t'i realizojë gjërat pa ndihmën e "tjetrit", por që në një moment të caktuar dorëzohet dhe kërkon ndihmën e njeriut të tij më të afërt, pra të prindërve të tij. Dhe raste të tilla ndeshen shpesh, në rrugë, në ambiente sociale, në familje. Fëmija kërkon hapësirë të mjaftueshme për të manovruar gjithmonë në kërkim të vetvetes, në kërkim të realizimit të dëshirës e cila në të shumtën e rasteve mbetet dëshirë e momentit. Në botën e tij mendon se forca e tij është e mjaftueshme, por vjen shpejt çasti që pendohet dhe kërkon menjëherë mbështetje.

I pafuqishëm është i riu apo e reja të cilët në ballafaqim me të ashtuquajturën "adoleshencë" mbeten pre apo viktimë e shumë momenteve të padëshi-

Dhe të gjithë ne jemi pjesë e këtyre realiteteve dhe sidoqoftë mbetemi përherë të pafuqishëm përpara një fuqie absolute siç është fuqia e Allahut të Lartë. Kërkojmë ndihmë tek Ai gjithmonë në një emërues të përbashkët, pra në "lutje".

rueshme edhe për ta dhe në ato çaste pendohen duke pohuar në një mënyrë apo në një tjetër pafuqishmërinë e tyre dhe kërkojnë tek "të tjerët" përkrahje dhe rrugëzgjidhje për dalje nga situatë. Sa raste të tilla hasim në të përditshmen tonë ku fillimisht kemi një vullnet të fortë dhe pothuajse të plotë në vazhdimësinë e rrugës, por që është "e mëvonshmja" ajo që sjell atë që në fakt në një farë mënyrë parashikohej dhe dihej. Por çfarë u mungonte këtyre të rinjve pikërisht në ato çaste? Pse vallë kishin mbetur pre të viktimizuar të atyre trishtimeve të errëta dhe të pafundme? Kush duhet t'u jepte forcë që të përballonin me sukses atë rrugë të vështirë që kishin nisur?

Të pafuqishëm janë edhe ata që e kanë marrë emrin "prindër" pasi në fund të fundit kanë mbi supe përgjegjësi të mëdha, "edukimin e qenieve" porosi këto të pashtershme. Shumë herë edhe ata mbeten pre e atyre viktimizimeve, shumë herë të padëshiruara, në çaste tepër delikate mendojnë se çdo gjë u ka shkuar bosh pasi pesha e tyre tashmë ka ndryshuar formën e saj duke u bërë mjaft e lehtë përpara atyre arsyeve me

të cilat hasen pothuajse përditë. Kërkojnë të ndryshojnë moshë, por sa e mundur është për t'u arrirë? Dhe këtu mbetemi tek thënia e famshme e Sokratit "Ajo që di unë, është se nuk di asgjë"

Të pafuqishëm janë edhe moshat e vjetra. Këtu ndoshta kemi një situatë më ndryshe pasi këtu mendohet se kemi një pafuqishmëri që sjell mosha dhe ku brishtësia mbisundon mbi fizikun dhe arsyen. Gjithashtu ndryshimi i kohërave bën që edhe gjykimi i njeriut të kalojë në faza të ndryshme. Paralelisht me këtë kemi lidhjen shpirtërore ku gjyshërit tanë kërkojnë të pasqyrojnë tek më të vegjlit. Një dorë e moshuar prek një të mitur, një fëmijë jetim, një zemër të plagosur, një shpirt të përvuajtur, një fytyrë të vrarë që nuk ka parë për shumë kohë "mirësi" dhe "buzëqeshje".

Dhe të gjithë ne jemi pjesë e këtyre realiteteve dhe sidoqoftë mbetemi përherë të pafuqishëm përpara një fuqie absolute siç është fuqia e Allahut të Lartë. Kërkojmë ndihmë tek Ai gjithmonë në një emërues të përbashkët, pra në "lutje". Është e vetmja gjë që na bashkon në çdo moment. Virtytet e larta njerëzore mbeten përherë urë kalimi nga një zemër në tjetrën, mbeten gjithmonë një lehtësim për punët tona, duke gjetur përherë mirëkuptimin dhe tolerancën e shumëkërkuar. Dhe këto virtyte i gjejmë vetëm tek ato që njohin vetëm një emër, "devotshmërinë" për të arritur në tiparet konkrete të të qenit "njeri".

MREKULLIA E KRIJUESIT BIMA MIZËGJUAJTËSE

Përveç gjallesave të panumërta të krijuara nga i Plotfuqishmi ekzistojnë edhe bimë që “gjuajnë” me metoda vërtet të jashtëzakonshme.

Disa prej këtyre janë bimët mishngrënëse të cilat ushqehen me insekte.

Sistemi i gjuajtjes së këtyre bimëve vepron në këtë mënyrë: miza (insekti) e cila kërkon ushqimin, vendoset në bimën e cila është shumë tërheqëse (bima mishngrënëse). Kjo bimë ngjason me duart që mbajnë pjatën, ngjyra e saj kuqe është shumë tërheqëse, gjithashtu edhe aroma e ëmbël që lëshojnë gjëndrat të renditura rreth petaleve të saj

Miza e tërhequr nga kjo aromë e këndshme pa u luhatur fluturon dhe vendoset te kjo bimë. Duke lëvizur kah burim i ushqimit, ajo prekë qimet e parrezikshme të bimës. Shpejtë

të pas kësaj, bima menjëherë mbyllë petalet. Miza ngecë e ndrydhur fuqishëm në mes dy petaleve. Bima mishngrënëse atëherë fillon të tajojë lëng për “zbërthimin e indeve”. Ky lëng bën që miza të transformohet në një substancë xhelatinoze, të cilën e thithë bima.

Shpejtësia me të cilën kjo bimë e kapë mizën, është e pabesueshme. Shpejtësia me të cilën ajo mbyllë petalet e saj është më e madhe se shpejtësia e mbylljes së shuplakës që bën njeriu.

Si kjo bimë, e cila nuk ka muskuj as eshtra, mund ta bëjë këtë lëvizje kaq të shpejtë?

Hulumtimet shkencore treguan se brenda bimës mishngrënëse ekziston një sistem elektrik i cili funksionon në këtë mënyrë: prekja e qimeve të kësaj bime, përcillet deri te receptorët e vendosur nën qime. Nëse prekja mekanike është mjaft e fuqishme, këta recepto-

rë dërgojnë sinjale elektrike, si valët e ujit, deri tek petalet.

Këto sinjale transmetohen deri te qelizat motorike të cilat lëvizin petalet, dhe kështu përfundimisht aktivizojnë sistemin i cili rrëmben mizën.

Sistemi mekanik me të cilin kurtha mbyllet, gjithashtu është konstruktuar në mënyrë të përkryer.

Në brendinë e bimës pasi pranohet stimuluesi elektrik, qelizat e ndryshojnë përqendrimin e ujit në to. Atëherë qelizat në brendinë e kurthës e lëshojnë ujin nga trupi i tyre. Në anën tjetër, qelizat nga ana e jashtme e kurthës, e pranojnë tepricën e ujit dhe rriten. Kështu kurtha mbyllet në të njëjtën mënyrë sikurse njeriu shtrëngon shuplakën, një muskul tkurret e tjetri hapet. Miza e kapur brenda bimës padyshim prekë shumë herë qimet, duke kontribuar që forca elektrike përsëri të li-



rohet, dhe kurtha mbyllet edhe më fort. Ndërkohë aktivizohen gjëndrat për tretje, që ekzistojnë në kurthë. Si rezultat i stimulimit këto gjëndra e mbysin insektin dhe fillojnë ta tretin. Kështu bima thithë lëngun e begatë me albuminë. Në fund të tretjes, mekanizmi i cili bëri që kurtha të mbyllet, përsëri aktivizohet dhe hapet.

Ky sistem ka edhe një veçori kryesore interesante: për t'u aktivizua kurtha, qimet duhet të preken dy herë radhazi. Prekja e parë shkakton ndryshim elektrik statik, por kurtha nuk mbyllet. Kurtha mbyllet vetëm gjatë prekjes së dytë, pasi që ndryshimi statik arrin një vlerë të caktuar dhe paraqitet zbrazja. Pra, meqë kemi të bëjmë me sistem të dyfishtë të aktivizimit, bima mishngrënëse asnjëherë nuk mbyllet pa arsye.

P.sh: Kurtha nuk aktivizohet kur në të bie pika e shiut.

Të mendojmë tani këtë sistem, të jashtëzakonshëm që krijoi I Plotfuqishmi.

Tërë ky sistem ekziston te kjo bimë për ta kapur gjahun e saj dhe për ta tretë në mënyrë përshtatshme. Mungesa vetëm e një elementi do të thoshte vdekje për këtë bimë. P.sh: nëse në brendinë e petaleve nuk do të kishte qime, bima nuk do të mbyllej, sepse reaksioni asnjëherë nuk do të fillonte pa marrë parasysh që insekti do të sillej rreth dhe brenda bimës.

Nëse sistemi për mbyllje do të ekzistonte, por bima nuk do të kishte veçorin e tajitjes së substancës për tretjen e insektit, tërë sistemi do të ishte i pavlerë. Shkurtimisht mungesa e cilitdo element të sistemit, do të thoshte vdekje për bimën. Kjo bimë, që nga momenti kur është krijuar, ka pasur gjithnjë karakteristikat e përmendura. Dhe me siguri as "aktet magjike të rastësishme" nuk e kanë

bërë këtë bimë të jetë gjuajtëse profesioniste

Më e rëndësishme në tërë këtë është fakti që kjo gjuajtëse profesioniste nuk ka aftësi të mendojë. Përfaqësuesit e teorisë së evolucionit pa dyshim këtu do të ngecin pa përgjigje. Këtu kemi një sistem gjuajtës të bimës, organizëm i cili nuk ka strukturë nervore apo diç të ngjashme me të, dhe sigurisht që nuk ka vetëdije.

Ajo është e krijuar nga Allahu i Plotfuqishëm me një sistem të caktuar, me ndihmën e të cilit vet pa kurrfarë mudi të ushqehet, sikur që bëjnë edhe bimët tjera.

Mesazhi i Kuranit fisnik është i qartë:

"Atëherë pra, a është Ai që krijon njësoj, sikurse ai që nuk krijon?

A nuk po mendoni?"

(En - Nahl, 17)

Ajetet Kuranore për familjen dhe fëmijët

1. Në fe nuk ka dhunë. E vërteta është bërë e qartë nga e qota. Kush nuk i beson të pavërtetat e i beson All-llahut, ai është kapur pas lidhjes më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues i dijshtëm (Bekare, 256)

2. Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin që të gjithë ç'ka në tokë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?! (Junus, 99)

3. Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe debato me kundërshtarët me mënyrën që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit (Nahl, 125)

4. Kush e udhëzon veten në rrugën e drejtë, ai e ka udhëzuar vetëm vetveten e vet, e kush e humb (rrugën), ai e ka bërë humbjen kundër vetvetes së vet, e askush nuk do ta bart barrën e tjetrit. E Ne nuk dënuam askënd para se t'i dërgojmë të dërguarin (Isra, 15)

5. Atij i thuani fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet (Ta Ha, 44)

6. Besimtarët të mos i miqësojnë mosbesimtarët, e t'i lënë anash besimtarët. E kush bën atë, ai nga feja e All-llahut nuk ka asgjë. Përrjashtim bëjnë rastet nëse kanë për qëllim të ruhen prej të keqes së tyre. All-llahu ua tërheq vërejtjen me dënim prej Tij, sepse vetëm tek All-llahu është e ardhmja (Ali Imran, 28)

7. Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtojeni begatinë e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi

zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehennemit dhe Ai ju shpëtoi prej saj. (Ali Imran, 103)

8. E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh! (Ali Imran, 105)

9. Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi natyrë të ndjeshme dhe sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shpërndaheshin prej teje, prandaj ti fali ata dhe kërko nga Zoti ndjesë për ta. Konsultohu me ta në të gjitha çështjet, por kur të vendosësh atëherë mbështetu në All-llahun. (Ali Imran, 159)

10. Allahu është ai që bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur ta shpenzoje gjithë atë që është në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por All-llahu bëri që ato të bashkohen. Ai është i gjithëfuqishëm dhe i urtë! (Enfal, 63)

11. Besimtarët e vërtetë janë ata që u shmangen mëkateve të mëdha e të shëmtuara, dhe kur i hidhëron, ata falin (Shura, 37)

12. Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe të së njëjtës masë, ndërsa kush fal e bën pajtime, shpërblimi i tij është tek All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët (Shura, 40)

13. S'ka dyshim se është virtyti më i lartë (i lavdishëm) është për njeriun të bëjë durim dhe të fal të tjerët (Shura, 43)

14. S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti) (Huxhurat, 10)

Njohja e të ndaluarës dhe e të lejuarës çështje e domosdoshme në sheriatin islam

Harami si dispozitë është gjithëpërfshirës d.m.th. nuk mund të konsiderohet për dikë haram e për dikë jo haram; nuk mundet një haram në një vend të jetë haram e në një vend tjetër jo

Njohja e asaj që është e ndaluar (haram), e asaj që është e lejuar (mubah) dhe e asaj që është e obliguar (farz) është një nga parimet që duhet të njohë doemos myslimani, i cili me anë të kësaj njohurie do të dijë të kryejë obligimet e caktuara nga Ligjdhënësi i vetëm All-llahu (xh. sh.) Përveç kësaj, në anën tjetër ai do të dijë të largohet nga ato që ia ka ndaluar Ligjdhënësi. Të gjitha ligjet e Allahut (xh.sh.) që janë përcaktuar nga Ai janë në dobi të njeriut dhe kurrsesi nuk janë në dëm të tij, pavarësisht nëse njeriu është në gjendje të kuptojë urtësinë e atyre obligimeve, ndalesave dhe dëshirave apo jo.

Të lejuarit e ushqimeve të këndshme ka për qëllim res-

pektimin dhe nderimin e krijesës së përsosur, njeriut. Ndaliimi i ushqimeve të papastra dhe i disa llojeve të mishrave të disa shtazëve është bërë për shkak të mbrojtjes së shëndetit dhe natyrshmërisë së njeriut nga gjërat e neveritshme dhe largimi nga çdo gjë që ia dëmton trupin, mendjen dhe shëndetin e tij nga shumë sëmundje dhe dëme. Për këtë Allahu (xh.sh.) thotë: **“O ju njerëz, hani nga ajo që është në tokë e që është e lejuar dhe e mirë, e mos shkoni pas gjurmëve të djallit se ai është armik i hapët i juaj!”**¹ Gjithashtu edhe Pejgamberi (a.s.) thotë: **“Nuk ka dëm e as të dëmtuar (reciprok)”**.²

1 El-Bekaretu: 168
2 Malik, Ahmed, Nesai, Behjeki, Darekutni dhe Ibn Maxhe.

Rregullimi dhe sistemimi i të drejtës trashëgimore në mënyrë të hollësishme nga Kur’ani dhe syneti synon garantimin e drejtësisë në ndarjen e trashëgimisë familjare dhe largimin nga çdo nxitje e zilisë dhe hidhërimit ndërfamiljar.

Pa dyshim se e lejuara (mubahi) dhe e ndaluara (harami) janë dy antonime që secila ka kuptimin e vetë gjuhësor dhe terminologjik.

Me shprehjen *mubah* (e lejuar) në terminologjinë e sheriatit nënkuptohet ajo vepër e cila është e lejuar të veprohet, por mbetet në zgjedhjen e të ngarkuarit me obligime (mukelef) që ta zbatoj apo të mos e zbatojë atë.

Haram konsiderohet ajo vepër e cila është rreptësisht e ndaluar të zbatohet dhe se vepruesi i saj ndëshkohet. Vepruesi i haramit (të ndaluarës) ndëshkohet në botën tjetër, por në disa raste ndëshkohet edhe në këtë botë si krimineli ndëshkohet në këtë botë, shpifësi në moral, ai i cili bën zina (prostitution) etj.

Statusi i haramit sipas dijetarëve hanefi ndahet në dy grupe:

Harami që nga vetvetja është i ndaluar (haramun li dhatihi). Ky lloj i haramit është ai lloj i cili qysh në parim është i ndaluar ngase në të ka dëme dhe pasoja. Si psh. vjedhja, prostitucioni, pirja e pijeve dehëse, ngrënia e coftirës etj. Në këtë lloj të haramit hyjnë të gjitha ato lloje të haramëve që sjellin dëme dhe pasoja në çështjet të cilat sheriatu islam i konsideron interesa vitale (el-maslehatul muteberetu) siç janë: besimi, mendja, pasuria, jeta dhe nderi.

Harami që për shkaqe të tjera konsiderohet haram (haramun ligajrihi). Ky është harami që në parim është i lejuar (mubah), por për shkaqe të ndryshme bëhet haram. Si shitblerja në parim është e lejuar, por nëse ajo bëhet duke i mashtruar njerëzit, atëherë kjo shitblerje konsiderohet haram; agjërimi në parim është i lejuar, por nëse agjërohet dy ditë (Duhet sqarimi "jashtë ramazanit". I.D.) pa ndërprerë nuk lejohet etj.

Pavarësisht se me çfarë harami kemi të bëjmë, për ne është e qartë se harami është në dëmin tonë dhe për këtë shkak Ligjdhënësi e ka ndaluar. Këtë në mënyrë shumë të qartë Allahu (xh.sh.) e sqaron: **"Dhe thuaj:**

Pavarësisht se me
çfarë harami kemi
të bëjmë, për ne
është e qartë se
harami është në
dëmin tonë dhe
për këtë shkak
Ligjdhënësi e ka
ndaluar.

"Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, le të jenë të hapta ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t'i vishni Allahut shok pa pasur për të kurrfarë argumenti, dhe ndaloi të thonë për Allahun atë që nuk e dinë se është e vërtetë".¹

Duke u bazuar dhe analizuar rregullin e sheriatit që thotë: **"Çdo gjë që të shpie deri te harami konsiderohet haram"**, e bën të qartë se myslimanit i vihen ndalesa që të mos afrohet haramit, ngase kur njeriu i përdor dhe i zbaton gjërat që e shpien deri te harami, i tilli pa dyshim bie në haram. Mbyllja e rrugëve që shpien deri te harami është një begati e madhe për njeriun që dëshiron të ruhet prej haramit. Për këtë do të sjellim si shembull ajetin: **"Ju mos ua shani ata (zota) që u lutën (idhujtarët), pos Allahut, e si (hakmarrije) të shajnë Alla-**

hun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij)".² Po ashtu mund të përmendim edhe hadithin e Pejgamberit (a.s.) i cili me një rast i është drejtuar as'habëve të tij duke u thënë: "Vërtetë njëri prej mëkateve të mëdha është sharja e prindërve! As'habët i thanë: A mund t'i shaj njeriu prindërit e tij? (Pejgamberi a.s.) u përgjigj: "Po, kur dikush ta shajë babanë e dikujt, edhe ai ia shan babanë e tij. Kur dikush ta shaj nënën e dikujt, ai i shan nënën e tij".

Si nga ajeti ashtu edhe nga hadithi vërehet qartë se si myslimanit i mbyllen rrugët që e shpien deri te harami. Preventivat që pengojnë arritjen deri te harami në sheriatin islam njihen si **"Seddu dheria"**.

Harami si dispozitë është gjithëpërfshirës d.m.th. nuk mund të konsiderohet për dikë haram e për dikë jo haram; nuk mundet një haram në një vend të jetë haram e në një vend tjetër jo; harami e përfshin prijësin dhe njeriun e zakonshëm, gjykatësin dhe atë që është duke u gjykuar etj.

Domosdoshmëria e qëndrimit larg nga harami është i prerë dhe i qartë, por gjithashtu duhet të distancohemi edhe nga ato gjëra që janë të dyshimta nëse janë haram apo jo, pasi që largimi nga gjërat e tilla do të thotë mbrojtje prej të ndaluarës (haramit). Kur ndodh që çështja është e dyshimtë nëse është haram apo jo, atëherë duhet të largohemi nga ajo vepër në mënyrë që të mos biem në dyshim se a kemi vepruar një akt haram apo jo. Një veprim i tillë kuptohet qartë nga hadithi i Pejgamberit (a.s.): **"Në të vërtetë hallalli (e lejuara) është e qartë,**

Mbyllja e rrugëve

që shpien deri te

harami është një

begati e madhe

për njeriun që

dëshiron të ruhet

prej haramit.

por dhe harami (e ndaluara) është e qartë. Ndërmjet tyre janë gjërat e dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë. Kush ruhet nga gjërat e dyshimta, është i siguruar në pikëpamje të besimit dhe të nderit, ndërsa kush bie në gjërat e dyshimta, ka rënë në të ndaluarën, njësoj si bariu i cili e ruan kopenë rreth vendit (kullotës) të ndaluar, në këtë moment kopeja mund t'i ik dhe të kullosë në të. Çdo sundues e ka vendin (kullotën) për të tjerët të ndaluar, kurse vendi i ndaluar i Allahut janë ndalesat (haramet) e Tij..."¹. Duke u mbështetur në këtë tekst kuptojmë qartë se myslimani e ka obligim të domosdoshëm të largohet nga harami dhe ta veprojë atë që i është urdhëruar sipas mundësive. Pa dyshim se gjithmonë vjen në shprehje largimi apo mënjanimi i të keqes para se të veprohet e mira dhe e dobishmja.

Te dijetarët është e diskutuar çështja e gjërave për të cilat nuk

ka tekst: a duhet të konsiderohen haram apo të lejuara. Rreth kësaj çështje dijetarët ndajnë këto mendime:

1. Një grup i dijetarëve janë të mendimit se në parim çdo gjë është e ndaluar derisa të mos sillen argumente se ajo është e lejuar. Të këtij mendimi janë disa mutezili, Ibn Hamid dhe Kadi Ebu Jala prej hanbelive.

2. Esharitët dhe ehli hadithi janë të mendimit se për atë çështje që nuk ka argument ajo duhet konsideruar e ndaluar dhe të mos gjykohet pa sjellë argument.

3. Disa dijetarë shafi janë të mendimit se gjërat e dobishme rreth të cilave nuk ka argumente fetare duhen konsideruar të lejuara, ndërsa gjërat që janë të dëmshme ato në parim konsiderohen të ndaluara.

4. Shumica e hanefive dhe shafive janë të mendimit se çështjet për të cilat nuk ka argument, në parim konsiderohen të lejuara.

Mendimi më i saktë është ai që çështjet për të cilat nuk ka argumente duhen konsideruar të lejuara përderisa nuk ka argumente që ajo vepër duhet vlerësuar haram – e ndaluar. Mendimi i tillë mbështet në këto argumente:

1. Fjala e Allahut xh.sh.: **"Ai është i cili ka krijuar në tokë për ju gjithçka..."**².

2. Ajeti: **"Thuaj: "Kush i ndaloj bukuritë dhe ushqimet e mira, që Allahu i krijoi për robët e vet?"**³

3. **"Sot u janë lejuar ushqimet e mira..."**⁴

4. **"Thuaj: "Në atë që më është**

të shpallur mua (në Kur'an) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveçse cofëti-në, gjak i derdhur ..."⁵.

5. Fjala e Pejgamberit (a.s.): "Më i madhi krim i myslimanëve është që nëse dikush është pyetur për diçka që nuk është e ndaluar, i është përgjigjur pyetësit duke i thënë se ajo është haram".⁶

6. Hadithi i Pejgamberit (a.s.): "E lejuar konsiderohet ajo që e ka lejuar Allahu në librin e Tij, po ashtu haram konsiderohet ajo që e ka ndaluar Allahu në Librin e Tij, e atë që e ka lënë në heshtje ajo është e lejuar për ju".⁷

Nga të gjitha këto argumente bëhet e qartë se ato çështje të cilat i ka lënë në heshtje Ligjdhënësi d.m.th. nuk i ka përcaktuar se a janë haram (të ndaluara) apo të lejuara (mubah) konsiderohen të lejuara, për shkak se po të ishin të ndaluara Allahu (xh.sh.) kishte për t'i ndaluar, sepse e ndaluara është e dëmshme. Për këtë Allahu (xh.sh.) thotë: "Ç'keni ju që të mos hani nga ajo për të cilën është përmendur emri i Allahut, e Ai ju sqaroi juve se çka është e ndaluar për ju, përveç kur jeni të detyruar..."⁸

Thënë shkurt sheriati islam buron nga Ligjdhënësi i vetëm, Allahu (xh.sh.) në dallim nga ligjet e tjera të cilat burojnë nga njeriu dhe janë me të meta dhe të papërkryera.

Kto njerëz janë jetim...

Orvaten me i dhanë kuptim jetës me kukullat e tyre
I grisim, e mandej ndërtojnë kasolle prej leke.
Jetojnë tue u rruajt vetëm prej erës..
Armik tjetër nuk njohin kto të verbër.

Kto janë jetim...

Kanë harrue Zotin e tyre
E përpigen me shpik një nanë të madhe
Prej putnash përftue...

Kto janë jetim o Zot!
Të mbetun pa fjalë e tinguj
Mbështeten mitesh për me pa të nesërmen.
E nesërmja do të vijë, por jo si dojnë ata...

Kto janë vetëm...!

Pa Zot, kërkojnë me gjetë Zotin.
E gjejnë vetëm epshin e tyre
Në çdo qoshe të mendimit jetim.

Kto janë takorë
E vetëm të tillë o Krijues
A thue se toka i lindi vetëm,
Pa Ziellin, pa Ty...

Çdo harrues i Zotit asht në të vertetë jetim

Imam Vehbi Ismaili

Imam Vehbi Ismaili ndërroi jetë. U shua edhe një dijetar i shquar i kombit tonë, një njeri që gëzoi popullaritet të madh, një burrë i nderuar nga të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen, në Shqipëri, ku lindi, në Kosovën fisnike, për lirinë e së cilës punoi aq shumë, në diasporë ku jetoi e punoi. Emri i tij, vepra e tij e lënë pas janë dëshmi e një jete të vrullshme në dobi të fesë islame, të atdheut dhe të të gjithë besimtarëve islamë dhe shqiptarëve kudo që ndodhen.

Imam Vehbi Ismaili ka lindur në qytetin e Shkodrës më 25 nëntor 1919 në gjirin e një familjeje të njohur për tradita atdhetare, fetare dhe kulturore. Babai i tij, Ismail Hakiu, qe hoxhë i ditur, i aftë dhe i nderuar.

Imam Vehbiu fëmijërinë e kaloi në disa qytete. Ndër ta Shkodra, qyteti i lindjes, ishte ai që i la mbresat më të bukura për të sepse këtu i lindi pasioni për diturinë në përgjithësi e për

fenë në veçanti. Ndikime ushtruan edhe qytete të tjera; Kruja si qytet i qëndresës legjendare të Skënderbeut, Vlora si qytet i shpalljes së Pavarësisë, Tirana si kryeqytet e si pasqyrë e zhvillimit, emancipimit dhe qytetërimit të vendit.

Mësimet e para i mori në Shkodër, kurse prej klasës së pestë i vazhdoi në Krujë, me që babai iu transferua prej Shkodrës atje, vazhdoi Medresenë e Tiranës për katër vjet, më 1928 shkoi në Egjipt, ku u regjistru në Fakultetin Teologjik. Studimet i mbaroi më 1945 në Kajro.

Që në bankat e shkollës në Medrese e më vonë në Universitet u shfaqën prirjet e tij publicistike, që me kalimin e kohës u shndërruan në një pasion të bukur në veprimtarinë e tij të pasur krijuese, studimore, përkthyes e botuese.

Situata e krijuar në vendin tonë pas Luftës së Dytë Botërore, vendosja e sistemit komunist në Shqipëri e bënë të pamu-

ndur kthimin e Imam Vehbiut në vendlindje.

Në prill të vitit 1949 arriti në Detroit i ftuar nga Shoqëria Shqiptaro-amerikane e këtij qyteti, me shpresën se do t'i shërbente fesë dhe Shqipërisë. Puna e parë e nisur në këtë qytet ku jetonte një grumbull emigrantësh ekonomikë shqiptarë ishte sigurimi i një lokali për kryerjen e riteve fetare, si dhe për t'u dhënë fëmijëve mësimet për fenë islame dhe për gjuhën shqipe. Me 30 korrik 1949 ai organizoi kongresin e parë të shqiptarëve të Detroitit. Duke parë prapambetjen kulturore, Imam Vehbiu mori nismën të nxirrte revistën kulturore me titull "Jeta myslimane shqiptare" Më 1951 hapi një fushatë ndihmash për të blerë një lokal, për ta përshtatur e për ta përdorur si xhami, që të shërbente si çerdhe e veprimtarive fetare e kombëtare. Me 6 qershor u organizua veprimtaria e inaugurimit të saj. Kjo Shoqëria Shqiptaro-amerikane më vonë

Ndoshta pas vdekjes sime do te jete me lehte te sigurohen keto. Me qe ketu eshte zakon per vdekje te dhurohen lule dhe ne vend te tyre Qendra Islame Shqiptare do te lutet miqevete mij qe te dhurojne te holla ne vend te luleve per te derguar librarine time ne Shkoder.



u quajt Qendra Islame Shqiptare- Albanian Islamic Center. Duke u rritur numri i besimtarëve u inaugurua xhamia e re në shkurt të vitit 1963 me kapacitet 600 vendesh e me anekse te nevojshme për punë, për bibliotekë e për mësim.

Vitet nuk e lodhen Imamin tonë të nderuar, ai gjithnjë tregojë i gjallë, i shkathtë e këmbëngulës, bënte një jetë aktive fetare, intelektuale dhe atdhetare. Ai që nga viti 1962 bënte kërkesa të vazhdueshme për të vizituar Shqipërinë, por përherë merrte përgjigje negative. Vetëm në vitin 1988, pas 49 vjetësh arriti të shohë vendlindjen. Pas proceseve demokratike ai e vizitoi atdheun me një delegacion të Detroitit, New Yorkut, New Xhersit e të Kenerikës, së bashku me personalitetet e nderuara, Imam Isa Hoxhën, e Imam Qemal Lamin, me të cilët vizituan shumicën e qyteteve të Shqipërisë ku u njohën me nevojat e rimëkëmbjen e fesë.

Imam Vehbi Ismaili është karakterizuar edhe nga një letër këmbim i gjerë me të tërë bashkatdhetarët në të katër anët e globit, ai shkruan e merr përgjigje me letra e telegrame, ai komunikon me ta me këshilla e porosi, me urime e falënderime, ai çmallet me ta me biseda e intervista në shtyp, në radio e në televizion, ai kuvendon me ta me ligjëratat e bukura e me

librat e tij të vyer, propagandon me fjalimet e përshëndetjet në tubimet e ndryshme, bisedon e dialogon për fenë, për kulturën, për atdheun, për demokracinë në takimet e përzemërta e vëllazërore..

Me 10 korrik 1993 u mbledhën përfaqësuesit e të gjitha Qendrave Shqiptare të Amerikës dhe të Kanadasë, krijuan forumin bashkëdrejtues dhe zgjodhën njëzëri Imam Vehbiun Kryetar të Komunitetit Mysliman të Shqiptarëve të Amerikës dhe të Kanadasë. Mbledhja e dytë e këtij forumi vendosi të nxirrte revistën tremujore, fetare, kulturore e shkencore "Thirrja Islame".

Imam Vehbi Ismaili është një predikues i shquar. Duke i lexuar materialet e tij të botuara çuditësh për nivelin e kulturës filozofike, fetare, shkencore e kulturore, për profesionalizmin e tij në aspektin pedagogjik, didaktik e psikologjik, për qartësinë e mendimit, për forcën e argumentit, për bukurinë e stilit, për pasurinë e saktësinë e fjalorit, për efektin emocional e për ndikimin edukativ të tyre. Mes predikimeve të tij të shquara mbizotërojnë ata me përmbajtje për tolerancën fetare dhe atdhetarizmin që duhet të karakterizojë çdo shqiptarë. Në një intervistë është përgjigjur: "... Një gjë duhet të kenë të qartë intelektualët shqiptarë

se fetari i vërtetë është edhe atdhetar i vërtetë, se ka frikë nga Perëndia. U kam thënë, si Z. Adem Demaçit, Ibrahim Rugovës dhe Sali Berishës se, po të studionin historinë e Lëvizjes Kombëtare, udhëheqës të lëvizjes kanë qenë ose fetarë myslimanë, ose fetarë të krishterë, të tillët, sa kanë udhëhequr, nuk kanë kursyer të sakrifikojnë për fe e atdhe".¹ Një himn i vërtetë është "Lutja e Ditës së Flamurit" që Imam Vehbiu ka mbajtur ditën e shpalljes së Pavarësisë më 28 Nëntor 1912, ku mes tjerash thuhet: "O i Plotfuqishmi Zot, të lutemi përunjësisht që t'i dhurojsh lumturi kombit shqiptar, të rrojë me nder e lavdi, i lirë dhe i pavarur... të lutemi që t'i përkrahësh, t'i ndihmojsh të gjithë ata që punojnë për të mirën e Shqipërisë, qofshin persona ose shtete... Të lutemi me gjithë shpirt që të na falish Dashuri, Bashkim e Vëllazërim ne shqiptarëve, që të jemi në gjendje t'i përgjigjemi kurdoherë të bashkuar zërit të Atdheut".²

Fusha kryesore e veprimtarisë së Imam Vehbiut kanë qenë botimet, ata janë tregues i aftësive të tij organizative, drejtuese, kulturore, fetare, shkencore, atdhetare, intelektuale dhe gjuhësore. Ka botuar nën

¹ Besimtari i vërtetë, art. i cituar.

² Vehbi Ismaili, Islamizmi dhe 1 - tjet, USA, 1976, fq. 172-3.

etiketën “Biblioteka Myslimane Shqiptare” në emër të “Albanian Islamic Centër” 46 libra. Këto janë origjinalë, përkthime dhe përmbledhje e botime të veçanta të autorëve shqiptarë. Disa nga librat origjinalë janë: “Islamizmi dhe lutjet”, “Muhammedi- Profeti Islam”, “Një tufë lule-tregime nga historia islame”, “Studime islame”, , “Predikimet e xhumave dhe të bajrameve”, Dritë nga Kur’ani-Dhjetë porosi kryesore”, “Muhamedi-Profeti i fundit”, “150 hadithe-Fjalë të Profetit Muhamed”, “Kujtime të rinisë”, etj. Por Imam Vehbiu është një përkthyes i shquar i shumë veprave të autorëve më të nderuar, ka nxitë botimin e veprave të hartuar prej të tjerëve ose ka shkruar parathëniet, hyrjet e shumë veprave të së kaluarës të botuara në vendin tonë shumë vite më parë. Tërë kjo veprimtari e krijimtari botuese kanë sjellë në letërsinë islame shqiptare dhe më gjerë një ndihmesë të konsiderueshme, kanë ndihmuar për një ndërgjegjësim e forcim të mëtejshëm fetar tek besimtarët, kanë vlerësuar e bërë të paharruara personalitetet fetare, kulturore e atdhetare shqiptare, kanë kontribuar për të ndriçuar mjaft probleme që kanë të bëjnë me edukimin shpirtëror, moral dhe atdhetar të popullit, kanë evidentuar para të huajve vlerat e kulturës sonë kombëtare.

Imam Vehbi Ismaili është një figurë e madhe e kombit tonë, atdhetar e personalitet i gjerë e poliedrik, ishte një erudit i shquar dhe një poliglot i rrallë. Ndonëse jetoj e punoj larg, nuk e humbi për asnjë çast dashurinë dhe interesimin për Atdheun e dashur, për Shqipërinë, për Kosovën e për të gjitha viset

tjera. Presidenti i Republikës së Shqipërisë Prof. Dr. Sali Berisha e dekoroi atë me medaljen “Pishtar i Demokracisë” me këtë motivacion: “Klerik dhe patriot i ndershëm që u shqua për veprimtarinë e tij fetare dhe patriotike për një Shqipëri të lirë dhe të bashkuar”.¹

Leter e dates 15 dhjetor 2004

I dashuri dhe i nderuari mik Z. Islam,

Javen e kaluar mora letren tuaj dhe te dashur dhe u gezova që jeni mire, sikur dhe neve ka dashur Zoti, qofte lavderuar, tani, sipas

Vitet nuk e lodhen
Imamin tonë
të nderuar, ai
gjithnjë tregohej i
gjallë, i shkathhtë e
këmbëngulës, bënte
një jetë aktive fetare,
intelektuale dhe
atdhetare.

moshes, jemi mire.

U gezova që kishit kethyar në punë në medrese Dega e vajzave, uroj sukses. Njeriu kur ka vullnet në çdo moshe është në gjendje të punoj në degen e tij. Une i mbusha 85 vjetet, dhe po mos të lexoj ose shkruaj një ditë smurem.

Kam dashur tu dergoj tre volumet që kam botuar mbi Jeten e Pejgambereve që të shtypen në një volum, pasi të jeni korrigjuar, duke menduar se nuk kishte një liber të tillë në gjuhën shqipe. Por kur lexova në librin: Opinione mbi Libra, Ngjarje dhe njerez” se atje ishte botuar libri: “Vargu i Profeteve nën Dritën e Kuranit” nga turqishtja. E ndërrova mendimin se nuk është i nevojshëm.

1 Dekreti nr. 1045, datë 23.3.1995 i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

Per ceshtjen e Bilbliotekes sime: une e kam vendosur per tja derguar Medreses ne Shkoder, dhe pasi qe ju jeni ne ate te vajzave, me ndihmen e Zotit, do te dergohet aty. Por problemi eshte qe dergimi i tyre ne Shqiperi kushton afro 30 mij dollaresh, shume qe une nuk kam fuqi ta derdhi. Jam duke munduar te mos gjeje ndonji shoqeri mirebererese qe te marri persiper dergimin e tyre ne Shqiperi. Librat jane ne tri gjuhe: Arabishte, Inglisht dhe Shqip. Ju perqafoj duke ju uruar te gjitha te mirat.

I juaji,

Dhjetor me 15, 2004

Leter e dates 8 gusht 2005

Ju kerkoj ndjese qe nuk ju kam shkruar deri me sot, me qe kam gene i semure ne spital per disa dite, dhe nuk kam mundur tu shkruaj deri me sot.

Mu kenaq shpiri kur mora vesh-te se ne Medrese kishit 400 studente, ato do te jene nenat e brezave te ardhem dhe do te sherbejne ne prodhimin e rinise muslimane me edukate te larte fetare, dhe me ndihmen e Zotit, te kethehet Shkodra sikur ka gene ne te kaluaren Mekka e fese Islame ne Shqiperi.

Para dy ditesh mora e-mailing e fundit tuajin, dhe u gezova qe Libraria e Medreses se vajzave eshte pasuruar dhe ne teper me librarin e te Ndjerit Faik Luli, paste rahmet. Dhe biblioteka e ime, me ndihmen e te Madhit Zot, do ti dhurohet atij instituti. Por deri me sot nuk kam mundur ti siguroi fundet e duhura per dergimin e saj. Ndoshta pas vdekjes sime do te jete me lehte te sigurohen keto. Me qe ketu eshte zakoni per vdekje te dhurohen lule dhe ne vend te tyre Qendra Islame Shqiptare do te lutet miqevete mij qe te dhurojne te holla ne vend te luleve per te derguar librarine time ne Shkoder. Kjo nuk do te thote se une nuk do te kujdesem e te siguroj fondet per ta derguar sa jam gjalle, me ndihmen e te Madhit Zot.

E perfundoj duke ju uruar te gjitha te mirat.

REPORTAZH:

NJË DITË ME MUALIMIN E NJOHUR NGA TETOVA MULLA MAHMUD EF. ASLLANIN

Një ditë maji me shi pranveror, u nisa drejt Xhamisë së Larme (apo të Pashës, ashtu siç njihet nga populli) në Tetovë kjo xhami mjaft e bukur. Kësaj here s'do mend se i tëri isha përplot me emocione, mall dhe nostalgji, gjithë këto ndjesi të përziera përnjëherësh...

Ndjeja mall ngase në kujtesën time menjëherë m'u shfaq fëmijëria ime dhe ditët e kaluara pranë mektebit të kësaj xhamie... Nostalgji për ato ditë të këndshme që kurrë më nuk kthehen, dhe emocione, ngase kësaj here shkoja tek hoxha im i nderuar

dhe i çmuar Mulla Mahmud ef. Asllani, ky pishtar i dijes dhe ekspert i nxjerrjes së hafizëve, jo thjesht vetëm për vizitë, por për të bërë një reportazh mbi punën kolosale të këtij hoxhe të nderuar e bujar.

Ashtu i tëri i mbërthyer me emocione u ngjita shkallëve të mektebit të Xhamisë së Pashës, i cili ndodhet në katin e dytë të kësaj xhamie. Posa hapa derën, veshi më zuri plot zëra të cilët gumëzhnin sikur bletët në zgjua, zëra këta të nxënësve të cilët nga gojët e tyre të njoma recitonin vargje të Kur'anit Fisnik dhe përpiqeshin sa më shumë t'i shqiptojnë ashtu siç duhet.

Posa hyra, hoxha më buzëqeshi ëmbël, me atë buzëqeshjen e tij karakteristike... Pasi iu afrova e përshëndeta (i dhashë selam) dhe ai ma ktheu po me buzëqeshje. Më pas, llafosëm njëçikëz, dhe unë avash-avash dola pikërisht aty, për çka edhe kisha vajtur, pra për të bërë një reportazh mbi të, punën dhe veprimtarinë e tij, për lexuesit e

nderuar të revistës ETIKA.

Nga përvoja e dija se hoxha i çmuar, është njeri tejet modest dhe aspak nuk pëlqen që të ekspozohet para gazetave apo medimeve, thjesht ai e ka zakon të shprehet *"Këtë që e bëj, e bëj vetëm për hir të Allahut. Ndaj, mjafton vetëm Allahu ta dijë. Nuk ka nevojë të më jepet publicitet"*.


Mirëpo, pasi pak insistova dhe duke llafosur, ashtu spontanisht rodhi edhe biseda jonë, e cila ishte sa e këndshme aq edhe e shkurtër, thjesht koha ikte fluturimthi, akrepat e orës thuja se lëviznin më shpejtë se herave tjera... Në ndërkohë, gjersa ne të ty bisedonim, ai njëherit vazhdonte që çunave t'ua dëgjoj mësimin (dersin- ashtu siç shprehet vetë hoxha i çmuar).

Në fillim e luta për një biografi të tijën, i cili nuk ngurroi dhe ma tregoi në pika të shkurtëra:

BIOGRAFIA E MULLA MAHMUD EF. ASLLANIT

Mulla Mahmud efendi Asllani është lindur më 15.03.1932 në fshatin Çiflik të Dervenit të Poshtëm, Tetovë. Aty qysh si fëmijë, i mori mësimet e para fillestare në mektebin e fshatit, te Mulla Beqiri.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, fshehurazi ka vijuar mësimet në fshatin Merovë të Mulla Tahiri, ku për çdo ditë, tri vite rresht, dimër e verë ka udhëtuar nga katër orë në ditë. Aty ka patur rastin që të njoftohet



me elementet e para të sarfit e të nahvit (të gramatikës dhe të sintaksës).

Pas kryerjes së shërbimit ushtarak, aty diku nga viti 1954, është caktuar imam në Novo Sellë të Dervenit të Poshtëm, ku shërbeu 9 vjet. Në ndërkohë, intensivisht i është rrekur punës, dhe ka arritur të marrë provimin për imam, sepse asokohe ky kualifikim ishte i domosdoshëm për ata që shërbenin si imamë.

Në këtë kohë legalizohet edhe mësim-besimi. Me rastin e dhënies së provimit për imam, anëtar komisioni ka qenë edhe Haxhi Bedriu, kryetari i atëhershëm i Bashkësisë Islame të Maqedonisë. Në këtë provim, përveç lëndëve fetare janë përfshirë edhe lëndët shkencore, ku me sukses i ka mbrojtur, dhe ka marrë diplomë përkatëse.

PUNA DHE AKTIVITET E

Sa i përket aktiviteteve të tija fetare (da'vetit), ato aspak nuk i kanë munguar. Këtë ai e bënte duke i mbledhur më të rriturit nëpër çajtores, nëpër shtëpi (sera), zijarete e herë duke organizuar edhe ekskurzione.

Ajo që vlen të përmendet dhe nuk duhet të harrohet, është kursi i leximit të Kur'anit që e mbante në Xhaminë e Pashës, për çdo ditë, gjysëm ore para namazit të akshamit, ku çdo kush kishte mundësi të dëgjojë apo të merr pjesë aktive. Po-

Ajo që vlen të përmendet dhe nuk duhet të harrohet, është kursi i leximit të Kur'anit që e mbante në Xhaminë e Pashës, për çdo ditë, gjysëm ore para namazit të akshamit, ku çdo kush kishte mundësi të dëgjojë apo të merr pjesë aktive.

ashtu edhe pas namazit të sabahut, edhe sot e kësaj dite, akoma vazhdon të mbajë kurs për leximin e Kur'anit për të gjitha grup moshat.

Vlen të përmendim se realizimi i këtij programi ka hasur në vështirësi dhe pengesa, të cilave mualimi në fjalë u ka bërë ballë me dinjitet, derisa ato u bënë realitet i përditshëm, që pastaj askush më nuk kishte forcë t'i pengojë. Ai, gjithashtu edhe gjatë muajit të Ramazanit ka pasur angazhime të veçanta.

Mulla Mahmudi tani i mbush afër 40 vjet punë si mualim në Xhaminë e Pashës (Larme), ku gjendet edhe sot e kësaj dite.

Mulla Mahmud ef. Asllani aktualisht është mualimi më i njohur dhe më aktiv në mbarë trojet etnike shqiptare dhe më gjerë. Me punën e tij vetëmohuese ka arritur sukses të jashtëzakonshëm në mësimin e Kur'anit fëmijëve. Është shembull markant i një pishtari të dijes, dërsin e të cilit e morën qindra e qindra fëmijë, jo vetëm nga qyteti, por edhe nga fshatrat e afërta, dhe nga jashtë territorit të Maqedonisë.

Meritë e tij e veçantë është ajo që Mulla Mahmud ef. Asllani deri sot nxo-

rri mbi 130 hafizë. Këtë mision të shenjtë e ushtroi edhe gjatë viteve 60, atëherë kur feja dhe mësim-besimi ishte i ndaluar nga pushteti ortodoks sllavokomunist, por edhe pas viteve të 80-ta, kur mësim-besimi me urdhër "nga lartë" ushtrohej vetëm gjatë të shtunave e të dielave. Ai këtë detyrë vazhdon ta ushtron edhe sot e kësaj dite me mjaft sukses.

Numri momental i hafizëve që kanë dalë nga mualimi dhe muhafizi i shquar Mulla Mahmudi është, ashtu siç theksuam edhe më sipër mbi 130 hafizë.

Vlen të përmendim se mosha e hafizëve është nga më e ndryshmjat:

Fjala bie, hafizi më i ri për nga mosha që ka mbaruar hifzin i ka pasur vetëm 7 vjet, akoma pa hyrë në klasë të parë të shkollës fillore. Kuptohet që ka edhe nxënës të moshave të ndryshme, por më të shumtë janë ato të moshës 9, 10, 11, 12 vjeçare e më tej, dhe të të dy gjinive, si djem ashtu edhe vajza.

Shumica e tyre, pas përfundimit të hifzit, regjistrohen në Medresenë e Isa Beut, por ka edhe prej atyre që regjistrohen në Kosovë, Bosnjë, Turqi, Siri, Jordani, Egjipt, Arabinë Saudite, etj.

Një numër bukur i madh i tyre kanë diplomuar në universitetet e ndryshme islame, ka prej atyre që edhe kanë magjistruar, ndërsa njëri edhe ka doktoruar. Gjithashtu vlen të përmendim se një numër bukur i madh i tyre, aktualisht ushtrojnë detyra fetare dhe të ndryshme në Tetovë, në fshatrat e Tetovës dhe jashtë territorit të Maqedonisë, në Kosovë, Bosnjë, Turqi etj.

Por si duket në të vërtetë një ditë pune e hoxhës së nderuar Mulla Mahmud ef. Asllanit:

Ai del nga shtëpia e vet që në

kohën e namazit të sabahut dhe kthehet në shtëpi pas namazit të jacisë. Gjithë ditën qëndron në xhami, përkatësisht mekteb, dhe asnjë ditë nuk ka pushim, përveç 2 ditëve të Fitër Bajramit (Bajramit të Ramazanit) dhe 3 ditëve të Kurban Bajramit. Ai përkundër moshës që ka, aspak nuk ngurron që gjithnjë të jetë në shërbim të Islamit, përkatësisht në mësimin e fëmijëve me dijet nga Kur’ani Fisnik dhe veçanërisht mësimin e hifzit. Përveç kësaj, ai për çdo vit kryen me nxënësit e tij edhe nga një hatme.

Hoxha në fjalë është i shkathtë për të nxjerrë hafizë të Kur’anit në shek. XX, ngase tërë jetën ia ka përkushtuar këtij qëllimi të lartë e sublim. Ai është tamam një pedagog i vërtetë dhe psikolog i lindur... dhe ta them të vërtetën s’di a ka ndonjë tjetër në botën arabe apo atë islame dhe më gjerë, që ia ka tejkaluar në këtë çështje.

Me plot të drejtë mund të themi, fare pa e tepruar se hoxha i nderuar është vetë shkollë (medrese) e nxjerrjes së hafizëve. Zoti na bëftë sikur ai!

METODA SE SI KRYHET HIFZI DHE PROMOVIMI HAFIZËVE:

Sipas të dhënave që munda të ofroj nga biseda që zhvillova me hoxhën e çmuar, në vijim jam munduar që së paku ta sqaroj ecurinë e procesit të mësimin të hifzit:

Nxënësi (talebja-siç e quan hoxha) kur vendos t’ia nisë hifzit, e ndjek këtë metodë mësimi: Së pari e mëson faqen e 20 të xhuzit të parë, pastaj ç’do faqe të 20 të ç’do xhuzi, pastaj faqen 19 (kuptohet duke e përsëritur edhe faqen e 20, pra atë që e ka nxënë përmendësh më herët), pastaj 18, 17, 16, 15 e kështu me rradhë, gjersa arrijnë me sukses ta përfundojë hifzin.

Nxënësi pasi e përfundon hifzin, ai edhe njëherë, kuptohet, për një periudhë kohore fare të shkurtër, e përsërit tërë Kur’anin përmendësh, me qëllim që të jetë sa më mirë i përgatitur, dhe pas kësaj, Mulla Mahmud ef. Asllani, lajmëron organet kompetente të Myftinisë, dhe e cakton terminin pranë organeve të Myftinisë së Tetovës, për kandidatin që e ka përgatitur hifzin, që kandidati edhe zyrtarisht ta mbrojë titullin hafiz i Kur’anit Fisnik. Kandidatët, zakonisht hifzin e kryejnë për një periudhë dy vjeçare, por ka edhe nga ata që e përfundojnë hifzin edhe për një kohë më të shkurtër.

Myftinia e Tetovës cakton datën dhe komisionin tre antarësh, për mbajtjen e provimit të kandidatit të ri, i cili provim vazhdon tri ditë me rradhë, nga dy orë, ku kandidatit i parashtrihen mbi një mijë pyetje, dhe në fund nga komisioni tre antarësh, bëhet vlerësimi dhe suksesi i kandidatit. Kandidatit të ri, në bazë të suksesit të arritur, komisioni i jep titullin “Hafiz i Kur’ani Kerimit”, dhe hafizi në fjalë pajiset me një Diplomë të lëshuar nga Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë.

Në të shkruhet emri, mbiemri, viti i lindjes, viti i fillimit dhe viti i mbarimit të hifzit, emri i muhafizit (pra ai i Mulla Mahmud ef. Asllanit) dhe emrat e anëtarëve të komisionit, dhe në fund vula dhe nënshkrimi i Reisul-Ulemasë së Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë.

Kjo në pika të shkurtëra, ishte biografia e përpjekjeve në rrugë të Allahut e këtij pishtari, që me të vërtetë meriton çdo lëvdatë dhe respekt, por që fjalët janë të pakta dhe kurrë nuk mund ta përshkruajnë punën kolosale, që ai ka bërë dhe që akoma edhe sot e kësaj dite vazhdon

ta bëjë, për nxënien e Kur’anit përmendësh, gjegjësisht kultivimin e institucionit të hifzit, për të cilën gjë, sot për fat të keq shumë pak ka prej atyre që punojnë në këtë rrugë.

U ndava me hoxhën e nderuar Mulla Mahmud ef. Asllani, duke i uruar shëndet, lumturi, mbarësi, jetë të gjatë dhe mbi të gjitha suksese në misionin e tij fisnik e sublim, nxjerrjen e sa më shumë hafizëve të tjerë.

Kur dola nga xhamia, shiu akoma vazhdonte të binte prashëm. I tëri isha i pushtuar nga nuri rrezatues i fjalëve të ngroh-ta e të sinqerta të hoxhës tim të çmuar Mulla Mahmud ef. Asllanit, që vazhdonin të më shoqëronin gjatë gjithë kohës...

Të nderuar lexues!

Mendoj se deri diku u përpoqa t’i hedh në letër përshtypjet që pata nga takimi me hoxhën e nderuar, dhe ato t’i ndajë edhe me Ju, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm se fjalët gjithnjë janë të pakta dhe kurrë e kurrës nuk mund t’i shprehin ato ndjesi dhe punën kolosale të Mulla Mahmud ef. Asllanit.

Megjithatë uroj që së paku një freski shpirtërore sado-kudo të përcjell deri tek Ju, ashtu edhe siç thashë pa pretenduar se i kam shprehur të gjitha, përkundrazi...

Për fund s’më mbetet gjë të shtoj, pos ta lus Allahun e Madhërishëm që këtij pishtari të rrallë t’i jep jetë të gjatë, ndërsa në Ahiret ta shpërblejë me Xhennetin Firdeus dhe në shoqëri me Pejgamberin s.a.v.s. Amin!

Linguist dhe analist i pavarur

ARKITEKTURA E HERSHME ISLAME

Në historinë e religjoneve vëmë re se fetë e njohura kanë sjellur sëbashku me besimin edhe artin. Me fjalë të tjera arti i së kaluarës në përgjithësi ka lindur nga ndikimet e besimeve dhe është zhvilluar nën varësinë e tyre. Sepse fetë e mëdha si Budizmi, Kristianizmi dhe Myslimanizmi u kanë sjellë popujve të botës vizione të reja, mënyra të jetuari etj. Formimi i strukturave të ndryshme tek popujt e ndryshëm ka ndikuar edhe në të menduarit, shijet dhe botëkuptimet e ndryshme. Kjo gjë i ka shtyrë edhe artistët që të kërkojnë forma të ndryshme të artit në shërbim të qëllimeve të tyre.

Ndryshimet e formave dhe planimetrive të monumenteve kanë luajtur rol sa në mënyrën e të jetuarit, po aq edhe në format e adhurimeve. Ashtu siç janë përshtatur për popujt dhe familjet planimetria e shtëpive, po ashtu që e nevojshme edhe ndërtimi i faltoreve sipas nevojës së tyre.

Qytetërimi islam, është një ndër qytetërimet më të hershme dhe më jetëgjatë që ka shënuar historia e njerëzimit. Kultura islame e cila ka

filluar që në shek. VII ka arritur të përhapet për një kohë të shkurtër në një hapësirë të madhe gjeografike. Në një kohë fare të shkurtër, për dhjetë vjet, i gjithë populli arab që bashkuar rreth idealit islam. Ende pa kaluar koha e sundimi të dy halifëve të parë, ushtria muslimane arriti të fus nën kontrollin e vet pjesën më të madhe të perandorisë bizantine dhe asaj perse dhe brenda një shekulli, kufijtë e shtetit islam u zgjeruan nga Deti i Zi deri në Detin Indian, nga Turkistani në Francë. Kjo hapësirë gjeografike posedonte një kulturë të pasur 4000 vjeçare. Mesopotamia posedonte monumente, Symerët, Akatët, Asurët, Babilonia kishin të zhvilluar artin plastik dhe atë së të shkruarit, po ashtu në këtë hapësirë gjeografike ekzistonin qytetërimet e mëdha si; Egjipti i lashtë, Hititët, Greqia, Roma, Bizanti, Sasani etj. Myslimanët kanë arritur të marrin kulturat e vjetra nga këto shtete. Duke u qëndruar besnik detyrave fetare dhe sociale arritën t'i gërshetojnë mirë me kulturat e tjera dhe të nxjerrin në pah një model të ri arkitekturor. Në historinë e botës të gjitha kulturat janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Në një qytetërim të ri jeton trashëgimia e së kaluarës. Natyrisht që pëson disa ndryshime dhe forma të reja. Në fillimet e periudhës islame, myslimanët ndeshen me disa kultura të huaja dhe natyrisht që edhe ndikohen nga disa monumente të tyre. Gjatë ndërtimit të këtyre monumenteve janë shfrytëzuar edhe arkitektët dhe punëtorët vendas. Veçanërisht në ndërtimin e monumenteve fetare e sociale në Siri janë zbatuar metodat e ndërtimit sipas planimetrive të monumenteve bizantine dhe të krishtera. Në shek. VII. në krahinën Surije të Perandorisë Bizantine (Urfa, Antakja, Ezra, Basra, Havran) kishte një mori kishash të stilit bizantin. Në planet e këtyre monumente vërehen qemerë të rrumbullakët, mozaikë dhe dysHEME, dhoma të vogla gjysëm harku që janë bërë shkas për forma të reja në arkitekturën islame.

Sasanët të cilët sunduan për katër shekuj në Iran dhe Irak kanë lënë shumë monumente kulturore. Ata trashëgjuan nga Asurët dhe Keldanët mënyrën e të ndërtuarit duke përdorur gëlqere, tulla, qemerë, kube etj. ku luajti rol të rëndësishëm në formimin më të plotë të arkitekturës islame. Sasanët, për zbulimin e monumenteve përdornin bimë të stilizuara, figura kafshësh, pemë, boxhe pishë, figura njerëzish, kuçedrash etj. të cilat kanë vazhduar edhe më tej në arkitekturën islame.

Veçanërisht mendohet që dekorimet zbuloheshin nga indianët, të krishterët e Egjiptit kanë qenë ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në arkitekturën islame. Në monumentet arkitekurore të bien në sy ndikimet si druri, qeramika, mbulesa.

Në lindjen e arkitektyres islame, faktorët kryesorë janë ato fetarë dhe sociale. Emocionit që u falnin feja dhe politika u bënë shkas për ngritje të lartë shpirtërore, rritjen e mirqënies etj. Po ashtu artet e ndryshme të popujve mysliman, qytetërimet e lashta, klima dhe kushtet natyrore, kanë qenë faktor ndikues në zhvillimin e metodave të ndryshme të artit islam.

Në momentin e lindjes së fesë islame, Meka dhe Medina ishin shumë pak qytete të zhvilluara. Gjëja e parë që ka bërë Profeti (a.s.) pasi emigroi në Medinë ishte ndërtimi i një xhamie në Kuba. Profeti (a.s.) ka marrë pjesë edhe vetë në hedhjen e gurthemelit të parë të kësaj xhamie. Por xhamia e parë e myslimanëve numërohet ajo e Profetit (a.s.) në Medinë. Xhamitë e ndërtuara në vitet e para të islamit nuk kanë arritur deri në ditët e sotme ashtu siç kanë qenë të ndërtuara. Meqenëse xhamitë e para kanë pësuar ndryshime me kalimin e kohës, në vend të tyre janë ndërtuar xhami të reja duke u bazuar në zhvillimin arkitekturore. Xhamitë e para qenë ndërtuar me murë qerpiçi, me degë hurmash për hije, tavan të hapur etj. Për këtë shembulli më i mirë është xhamia e Profetit (a.s.) në Medinë. Dihet se me rikonstrukcionet e bëra nga Hz. Umeri dhe halifi emevit Velid dhe Mehdi Bilah kanë humbur kufijtë e vjetër pothuajse plotësisht. Më vonë janë ndërtuar edhe nëntë xhami të tjera. Arkitekti i parë mysliman thuhet se është Ammar b. Jasir.

Faltoret e para nuk kanë pasur për qëllim paraqitjen e jashtme, por kanë qenë të thjeshta dhe kanë pasur për qëllim faljen e namazeve së bashku me xhemat. Gjatë periudhës emevite (661-749), meqenëse qendrat e artit dhe kulturës bizantine dhe ato sasane kaluan në sundimin musliman, arkitektët e atëhershëm muslimanë këmbëngulnin që të ndërtonin monumente që mund të identifikonin qytetërimin dhe madhësinë.

Pasi pushtohet Siria dhe Mesopotamia në vitin 639 është ndërtuar xhamia e Kufes, nga ana e Sad b. Ebi Vakas (xhami e tipit të Kufes), kurse në vitin 642 me pushtimin e Egjiptit ndërtohet xhamia Amër b. Asit në qytetin Fustat. Kjo xhami e cila njihet me këtë emër është rindërtuar përsëri sipër themeleve të vjetra. Xhamia e ndërtuar në periudhën që sundoi halifi emevit Muavije është zgjeruar në vitin 683.

Të dhëna rreth hoxhallarëve nga treva të ndryshme të Maqedonisë

Në këtë punim jemi përpjekur të shqipërojmë të dhëna rreth disa hoxhallarëve nga treva të ndryshme të Republikës së sotme të Maqedonisë. Disa prej tyre nuk i kemi përmendur në rastet kur personat në fjalë që në moshë të re kanë shkuar nëpër Turqi dhe nuk janë kthyer pas më vonë. Urojmë se shqipërimi i këtyre të dhënave do tu vlejë studiuesve dhe hulumtuesve të ndryshëm që synojnë të mbledhin të dhëna për jetën fetare, objektet e kultit dhe nëpunësit e fesë të trevave shqiptare.

Hafiz Abidin: Djali i zëvendësgjykatësit (naip) Osman efendi, lindur në kasabanë e Dibrës së Sipërme në vitin 1292 H. Njihte dhe fliste gjuhët shqip, turqisht dhe bullgarisht. Pas detyrës në stazh që kreu në gjykatën e shkallës së parë në kazanë e Dibrës së Poshtme, me datë 9 mars 1322 R caktohet në sekretariatin e të njëjtës gjykatë. Me datë 23 Teshrini I ngrihet në detyrë në sekretariatin e avokatisë së së njëjtës gjykatë. Merr pjesë vullnetarisht në luftën ballkanike gjatë së cilës bie rob për një vit në duart e serbëve gjatë pushtimit të kalasë Selimije nga këta të fundit. Gjatë luftës kryente edhe detyrën e imanit të taborit të ushtrisë. Me datë 10 prill 1335 R caktohet si sekretar i klasës së katër në gjykatën fetare të Gallatës në Stamboll.

Hafiz Xhemal efendiu: Biri i myderiz Shaqir efendiut dhe nipi i Sylejman efendiut, i datëlindjes 1299 H. Lindi në Dibrën e Sipërme të sanxhakut të atëhershëm të Manastirit. Pas mësimave në fillore me datë 13 korrik 1313 R diplomohet edhe në shkollën plotore (ruzhdiye). Më pas shkon në Stamboll ku merr pjesë në rrethin e nxënësve të Abdullah Mynip efendiut nga ku ndahet me datë 22 zilkade 1323 H pasi del me sukses në provim dhe merr diplomën përkatëse (ixhazetname). Përveç gjuhës së nënës, shqipes, fliste dhe shkruante edhe turqisht, arabisht, bullgarisht dhe persisht. Detyra e tij e parë si nëpunës i fesë që mësimdhënia fetare duke u caktuar si mësues i Kur'anit në Dibër me datë 1 gusht 1317 R. Pas pesë vjetësh caktohet me datë 24 Rebiulevel 1324 H si sekretar në Këshillin e Hulumtimeve Fetare (Meclis-i Tetkikat-i Sherije) duke u ngritur shumë shpejt në shkallën e sekre-

tariatit të shkallës së parë. Gjithashtu vazhdonte të qe mësues feje në zhaminë fatih të Stambollit. Personi që mori disa grada të fesë të akorduara nga shteti osman për nëpunësit e fesë me datë 5 Teshrini II 1330 H caktohet në zyrën e përpunimit të fundit të dokumentacionit të zyrës së Fetvave Fetare. Me datë 11 shkurt 1332 R merr diplomën me vlerësim maksimal nga Insituti i Gjykatësve të Fesë (medresetu kudat).

Me datë 8 kanuni II 1340 H / 1924 Mehmet Xhemal efendiu njofton eprorët për lejen e marrë për të shkuar në Shqipëri, nga ku kohë më pas Konsullata Turke e Shqipërisë njofton se është përzgjedhur deputet në parlamentin shqiptar. Me këtë rast konsullata i kërkon zyrës së financës së myftinisë së Stambollit që ti ndërpriten të gjithë rrogat që ai merrte prej kësaj zyre.

Mehmet Xhelaleddin Efendiu: Biri i haxhi Nimetullah efendiut, nga paria e vendit, lidur me datë gusht 1839) në lagjen Bajram Bej të kasabasë së Dibrës.

Mësimet e para të fesë i morri nga myftiu i Dibrës Ahmet Hilmi efendiu në xhaminë e ndërtuar me fondet e sulltan Ahmetit. Në prill të vitit 1901 caktohet në detyrën e vaizit për Dibrën, por me shkriren e kësaj njësie me datë gusht 1909 mbeti në rezervë. Vdiq me datë 15 dhjetor 1913 ndërsa merrej me mësimdhënien e nxënësve të fesë, detyrë për të cilën edhe paguhej.

Mehmet Nazif Efendiu: Biri i Ahmet Efendiut, dijetar i fesë për atë zonë, i lindur me datë 1283 H në lagjen Dervish Mustafa të kazasë së Dibrës së Sipërme. Pas përfundimit të shkollës fillore mësoi gramatikën dhe sintaksën arabe nga Sylejman efendiu në Medresenë e Teqes. Caktohet me datë shtator 1328 R në zyrën kryesore të kadiut për vilajetin e Shkodrës, nga e cila largohet me datë shtator 1329 R. Vdiq me datë 16 prill 1914.

Isa Ruhi Efendiu: Biri i Ibrahim Efendi Kornishit. Lindi me datë Kanuni I 1279 H në lagjen Salih Çelebi të kazasë së Tetovës. Në Stamboll mëson prej Arnavut Mustafa Efendi Peqinasit. Me datë

Kanuni I 1311 R kthehet në vendlindjen e tij, në Tetovë, ku nis të meret me mësimdhënien e mësimëve të fesë, grupit të parë të të cilëve iu lëshon me datë gusht 1325 R diplomat e fesë (ixhazet). Në korrik 1320 R caktohet në qyrsinë e Xhamisë së Madhe të tetovës dhe i lidhet një rrogë. I dhurohet një dekoratë mexhidije e klasit të pestë për shërbimin e madh që kreu në mbledhjen e fondeve për ndërtimin e konakut ushtarak në Tetovë.

Me vdekjen e Myftiut të Tetovës Haxhi Abdullah Efendiut me kërkesë së Këshillit Drejtues së kazasë së Tetovës me datë 17 Korrik 1324 R bëhet Myfti i Tetovës. Vdiq në vitin 1913.

Ismail Hakkı Efendi: Biri i Ibrahim Efendiut. Lindi në vitin 1280 H në Tetovë. Në vitin 1318 R me zgjedhje nga populli caktohet myderriz në kazanë e Grebenesë që asaj kohe varej nga sanxhaku i Manastirit dhe pas disa kohësh caktohet Myfti i kësaj kazaje. Në Qershor 1322 pasi fiton provimin që do ti mundësonte në vitet më pas shumë poste si nëpunës feje në Stamboll, mes të tjerash edhe caktimin në Drejtorinë e Degës së Tefsirit në medresenë Sulejmanije, jep dorëheqje nga detyra. Vdiq me datë 7 mars 1926.

Dosje ekzistojnë edhe për Mehmet Hurshitin, djalin e tregtarit Ismail begun e Nuredin begut të ditëlindjes 1870; Mehmet Vehbiut, djalin e Maksut Efendiut të datëlindjes 1284 R; Ymer Atifi i datëlindjes 1287 R, birin e myftiut Shehvar Efendi; Rexhep Xhudin, të datëlindjes 1859, birin e bujkut Nuredin Efendi, i cili gjatë debatit mbi alfabetin e shqipes pat mbështetur rrymën e përkrahësve të alfabetit shqip me gërma arabe dhe me këtë rast pat hartuar edhe një abetare të tillë.

Abdylhamit Hamdi efendi: i datëlindjes 1279 H, biri i Mehmet Sherif Hatipit. Lindi në lagjen Tekke të kazasë së Kërçovës. Pas mësimëve në medresenë e Kërçovës në muajin gusht të vitit 1299 R shkon për studime të mëtejshme në Stamboll. Pasi morri ixhazetin këtu kthehet në vendlindjen e tij ku nis të japë mësimdhënie fetare dhe në muajin kanuni sani 1311 R në bazë të kërkesës së popullatës caktohet si myderriz në Korçë, ndërsa me datë 12 Teshrin e vitit 1327 R caktohet myderriz në medresenë e Haxhi Mahmut Beut në Manastir. Me datë 1 teshrin sani 1329 R me kërkesë të popullatës muslimane simpatinë e së cilës e gëzonte prej kohësh caktohet myfti i Manastirit. Pas heqjes së pushtetit Osman edhe ai largohet për në Turqi ku e gjejmë në detyrën e myderrizit në vitin 1333 R në medresenë e Manisës.

Hajreddin Efendi: Biri i Hajdar Efendiut. Lindi në vitin 1287 H në fshatin Nikoshtak të kazasë së Kumanovës. Në Mars 1302 R fillon mësimet në Medresenë Isa Beu në Shkup. Në vitin 1313 R shkon në Stamboll. Pas marrjes së ixhazetit me datë qershor 1318 R caktohet myderriz në kazanë e Kumanovës, ku punon 9 vjet. Me datë 3 Teshrin II 1326 H caktohet myderriz në Shtip.

Ismail Hakki Efendi: Biri i Ahmet Hamdi Efendiut, që vdiq në vitin 1294 H teksa qe naib në vilajetin e Vanit. Gjyshi i tij është Sulejman Farisi Efendi, i cili për një kohë qe Myftiu i Manastirit. Lindi në vitin 1278 H në lagjen Sinan Bej të Manastirit. Nga prilli 1307 deri në maj 1308 R punoi si zëvendësgjykatës në Durrës. Vdiq me datë 1901.

Mehmet Dehhar Efendi: Biri i Spahi Xhafer Sadik Agaut nga familja e Myftijve (Myftyzade). Lindi në vitin 1834 në lagjen Iskender të kasabasë së Ohrit. Mësimet e para i mori nga gjyshi i tij (babai i nënës) myfti Sulejman Efendi dhe pas vdekjes së tij nga myftiu Edhem Efendi Shkodrani. Më pas i vazhdoi mësimet në medresenë e Sherif Beut që gjendet në Ohër me myderriz Shahin Efendi Dibranin nga i cili morri edhe ixhazetin.

Kreu për plot 20 vjet detyrën e zëvendës myftiut nga të cilat 4 vjet me Sulejman efendiun, 12 vjet me Edhem efendiun dhe 4 vjet me Ibrahim efendi Topxhiun nga Dibra. Me rastin e dorëheqjes së Ibrahim Efendiut caktohet si myfti i Ohrit në vitin 1870. Në vitin 1911 ishte në gjallje.

(Arslan) Hasan Fehmi Efendi: Biri i Jashar Nuri Efendiut. Lindi në vitin 1273 H në fshatin Vizikçe të Shkupit. Pasi mësoi nga myderrizi i Shkupit Haxhi Shaqiri dhe Myftiu i zonës Ismail Hakki Efendi shkoi në Stamboll. U caktua myderriz në Medresenë e Atijje Hanmit në Shkup. Autor i dy veprave të botuara me titull Zubdetu'-Talim dhe Risale-i Imanije. Ky i dyti është përkëthyer dhe botuar edhe në gjuhën shqipe. Nga data 17 korrik 1317 R deri me datë 13 kanuni sani 1318 H qe anëtar i gjykatës së apelit të vilajetit të Kosovës dhe me datë 1 Prill 1322 R caktohet në Myftininë e Kosovës. Me fillimin e Luftës së Ballkanit, me datë 1 Kanuni II 1328 H shkon në Stamboll.

Mehmet Emin: Biri i Syleyman Efendiut i datëlindjes 1862. Me datë Janar 1901 R caktohet myfti nderi i kazasë së Koçanisë, detyrë që e kreu deri në vitin 1904.

VOTIMET NË MAQEDONI

Votimet e fundit në Maqedoni kanë treguar edhe një herë paaftësinë e forcave të politikës shqiptare për të mos mundur të bashkohet në një strategji më konkrete që do të mundësonte që shqiptarët e Maqedonisë në përputhje me përqindjen e tyre në republikën e Maqedonisë të mund të sigurojnë të drejtat e tyre që u takojnë, të drejta të njohur dhe të sanksionuara në frymën e Bashkimit Evropian, në të cilën Maqedonia përpiqet të aderojë në një kohë sa më të shkurtër. Nga këto votime fitimtar i plotë ka dalë partia e kryeministrit aktual Gruevski, fitore e cila në marrëdhëniet e jashtme mendohet se nuk do ti sjellë ndonjë përmirësim marrëdhënieve me Greqinë sa i përket çështjes së emrit të shtetit të Maqedonisë. Ndërkohë kreu i PDSH-së, Menduh Thaçi, ka përjashtuar mundësinë që partia e tij, së bashku me BDI-në, të jenë pjesë e qeverisë së ardhshme, të kryesuar nga Nikolla Gruevski. Kryetari i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) në Maqedoni, Jovan Josifovski, shpalosi rezultatet e para jozyrtare të zgjedhjeve të 1 dhe 15 qershorit, duke shpallur fitues tek maqedonasit VMRO-DPMNE-në, ndërsa tek shqiptarët BDI-në. Sipas Josifovskit, pjesëmarrja e votuesve në mbarë vendin ka qenë 57.16 për qind.



KOSOVA HAP SELITË E SAJA DIPLOMATIKE NË SHTETET MË TË RËNDËSISHME NË PERËNDIM

Duke u bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, si dhe pas konsultimeve me Kryeministrin Hashim Thaçi, presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka dekretuar themelimin e institucioneve diplomatike në nëntë vende të botës.

Institucionet diplomatike të Republikës së Kosovës do të themelohen në:

Këto misione diplomatike do të vendosen në nivel ambasadash. Në këtë kuadër, siç bëhet e ditur nga një komunikatë për media, udhëzohet Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës që të zhvillojë procedura të mëtejshme për zbatimin e këtyre dekreteve, duke pasur parasysh bashkëpunimin me këto vende.

Ndërkohë, presidenti Sejdiu do të marrë vendim për themelimin e misioneve diplomatike edhe në vende të tjera.

AMBASADORI AMERIKAN MERR PJESË NË AKTIVITETIN E MEDRESESË SË SHKODRËS



Ambasadori amerikan Withers mori pjesë në aktivitetin “Projekti qytetar” të organizuar nga medreseja Haxhi Sheh Shamia në bashkëpunim me një organizatë OJF me qendër në Tiranë dhe të mbështetur nga vetë ambasada. Përveç fjalëve të tija të mirënjohura për tolerancën fetare në Shkodër ambasadori amerikan në këtë program mes të tjerash tha se: “Tek ne ekziston një fjalë e urtë që thotë se të vegjëlit duhet të mësojnë nga më të rriturit, por sot këtu në Shkodër dhe përballë këtij programi të përgatitur nga ana e këtyre nxënësve të dalluar ne vërtetojmë edhe të kundërtën e kësaj shprehjeje pasi ne të rriturit sot këtu në këtë aktivitet patëm shumë gjëra për të mësuar nga këta nxënës të talentuar. Për mendimin tim një rol të rëndësishëm në edukimin e këtyre të rinjve si qytetarë të ardhshëm të ndjeshëm dhe të përgjegjshëm për të ardhmen e qytetit dhe vendit të tyre ka edhe fryma dhe edukimi fetar që ata marrin në shkollën e tyre.”

Më pas ambasadori u dhuroi çertifikata falenderimi nxënësve të dalluar në këtë aktivitet.

JA ARSYEJA PSE DUHET TË PINI MË SHUMË UJË

Shkencëtarët gjermanë kanë zbuluar se si brenda një ore pas konsumimit të ujit të pastër, harxhimi metabolik i energjisë rritet për 24%, ndërsa kjo nuk ndodh nëse pihet sasi e njëjtë e tretësirës fiziologjike.

Sipas një teorie, mendohet se organizmi harxhon energji për ta bërë temperaturën e ujit të pirë të ngjashme me temperaturën trupore.

Megjithatë edhe pas eksperimenteve me ujë të ngrohur në temperaturë 37°C (sa është edhe temperatura trupore), janë arritur rezultate të ngjashme në harxhimin e energjisë. Kështu që mendohet se flitet për ndonjë proces të komplikuar fiziologjik.

Studimet kanë treguar se rritja e harxhimit energjik pas konsumimit të ujit, të meshkujt pasohet me harxhimin e yndyrave, ndërsa organizmi i femrave i shfrytëzon më shumë karbohidratet.



USHTRIMET TRUPORE ULIN RREZIKUN E SËMUNDJES NGA KANCERI



Metoda më e mirë për tu mbrojtur nga kanceri theksohet të jenë ushtrimet trupore.

Ekspertët fizioterapeut theksojnë se rruga më e mirë për të parandaluar kancerin janë stërvitjet trupore. Stërvitjet që zhvillohen rregullisht dhe pandërprerë e ulin në minimum riskun e sëmundjes së kancerit.

Studimi i bërë në Universitetin Haxhettepe të Turqisë, rekomandon që se paku duhet 3 deri në 4 herë brenda javës të bëhen ushtrime trupore dhe sport. Ushtrimet e tilla duhet të shndërrohen në një stil jetë

dhe që të krijohet efikasiteti preventiv karshi sëmundjeve të kancerit.

Të sëmurit nga kanceri të cilik kanë filluar të praktikojnë në regjim sporti deklarojnë se e ndiejnë veten shumë më mirë dhe apelojnë tek të gjithë për aplikimin e sportit në jetën e tyre.

ASPIRINA SHPËTON JETËN POR..

Vërtetohet shkencërisht se aspirina, ilaç i dobishëm për kurimin e shumë sëmundjeve, bën më efektiv nëse merret në darkë para se të bini të flini.

Sipas një studimi të bërë në Universitetin Vigo të Spanjës, është vërtetuar se nëse jeni të detyruar të merrni nga një tabletë aspirinë çdo dhe këtë e bëni para se të bini të flini, kjo ndihmon në parandalimin e infarkt, ul kolesterolin dhe e mban tensionin në gjendje të rregullt. Shkaku për këtë është fakti se hormone me të cilat bashkohet aspirini për të "bashkëpunuar" natën kur individit është në gjumë aktivizohen më shumë. Profesor Ramon Hermida, në cilësinë e kryetarit që ndjek këtë studim, shprehet se: "Sipas kërkimeve të deritanishme që kemi bërë kemi vënë re se gjaku mpikset më shumë atëherë kur trupi është në pushim. Prandaj edhe mendojmë se aspirini duhet marrë para kësaj periudhe të ditës 24 orëshe."

Vedat & Eda



ZBULOHEK GJENI QË SHTON KOLESTEROLIN I MIRË

Shkenctarët kanë zbuluar në 1/3 e njerëzve gjenet që luftojnë me infarktin

Në një studim shkencor që është kryer mbi mijëra njerëz nga ana e shkenctarëve hollandezë dhe anglezë është zbuluar se në të 1/3 e njerëzve gjenden gjenet që luftojnë em infarktin.

Sipas kërkimit shkencor që është kryer me 147 mijë persona dhe të publikuar në revistën mjekësore të Shoqërisë Amerikane për Zemrën, u kontantua se disa lloje të gjenit CETP, nga të cilat janë zbuluar gjashtë varacione, mund të rrisin sasinë e kolesterolit "të mirë" dhe se tek individët që kanë në organizmin e tyre këtë gjen mundësia për të kaluar infarkt ulet me 5 %.

Mbështetur në kërkimet e shkenctarëve të gjenetikës në universitetin Cambridge të Anglisë dhe ato të Groningennit në Hollandë dhe duke i ripunuar të dhënat e mbledhura deri më tani mendohet se gjetjet do të ndihmojnë në prodhimin e ilaçeve të reja në këtë drejtim.

Shkencëtarët e kishin vërtetuar deri tanimë se ulja e kolesterolit të "keq" në gjak ruan zemrën dhe se ilaçe si statini e arrijnë deri diku këtë gjë, por ende nuk ishte e qartë për ta marrëdhënia midis kolesterolit të "mirë", HDL dhe një zemre të shëndetshme.

AVJONI QË FLUTURON 5 VJET PA NDËRPRERJE

Pentagoni ka shpikur avionë që mund të fluturojnë për pesë vjet në qiell të hapur pa zbritur në tokë edhe pa karburant. Avioni i ri i quajtur "Vulture" punon me anë të valëve të radios, telefonit dhe videos. Thuhet se gjatë kohës që avioni është në fluturim ka aftësi riparuese për problemet e shkaktuara në rrjetin e informacionit etj. Po ashtu mendohet se ky lloj avioni mund të përdoret në rastet e fatkeqsive natyrore. Theksohet se ky avion pa u dalluar nga njerëzit bën zbulimin e vendeve të fshehta. Me një fjalë ky avion mund të përdoret për nevoja ushtarake dhe civile.



Firmat Boeing dhe Martin Lockheed kanë zhvilluar këtë tip avioni duke marrë licencën e firmes "Dariba" e cila posedon planin "Aurora Flight System". Ky avion mund të fluturojë deri në lartësitë 20-30 mij km.

Perfaqësuesit e kësaj firme pohojnë se rëndesa e këtij avioni është 500 kg, dhe se mban rekord për fluturimin në lartësi. Avioni Vulture përbëhet nga tre avion të lidhur me njëri-tjetrin. Përmban një lloj gjeneratori që me anë të kornizave të vendoura sipër avionit merr energjinë e rrezeve të diellit dhe e transformon në atë elektrike. Avioni nuk përhap gaze helmuese dhe punon me energji elektrike. Pritet që në të ardhmen ky lloj avioni të ndërhyjë në difektet e shkaktuar në satelite.

FLETORË DIXHITALE PËR TË MBAJTUR SHËNIME

Tani i erdhi fundi mundimit të letrës. Firma Aiptec hodhi në treg një fletore dixhitale shënimesh. Aiptec nxori në treg MyNote Premium II-shin. Fletorja dixhitale posedon memorien e brendshme prej 32 MB; nëse është e nevojshme kjo memorie mund të rritet me kartat SD.

Sipërfaqja e faqes është në formën e një letre DIN-A4. Kabloja e USB-së mund të lidhet me aparatet PC. Shkrimi i dorës është përfshirë brenda një kutie njohëse shkrimesh. Me bateri të karikueshme mund të punohet afërsisht 20 orë pa ndërprerje.




SHBA RUAN PËRPARSINË NË SHKENCË DHE TEKNOLOGJI



Sipas raportit RAND institucioni i mendimit në SHBA thuhet se amerikanët s'kanë përse të shqetësohen ndaj shteteve të tjera rivale në këto dy fusha. Është pohuar se SHBA është para dy shteteve rivale kryesore, kurse shtetet e tjera që janë në zhvillim të shpejtë në shkencë dhe teknologji si Kina, India, Korea e Jugut etj. përsëri mbeten pas saj për shkak se prodhimet teknologjike i kanë ende në shkallë të ulët dhe mbulojnë vetëm një pjesë të vogël të globit.

Sipas raportit në fjalë fondet për zbulimet dhe zhvillimet shkencore të botës i ka SHBA-ja me 40 %. Po ashtu në të thuhet se ndër 40 universitetet më të mira të botës $\frac{3}{4}$ të tyre dhe 70 % të çmimeve Nobel i posedon ajo. Sipas RAND-it rol kresor në ruajtjen e vendit të parë në shkencë dhe teknologji, luajnë studentët e huaj, shkenctarët dhe inxhinierët.

Po sipas raportit thuhet se 70 % e studentëve që doktorojnë dhe marrin grada shkencore në SHBA preferojnë të qëndrojnë për punë atje, ndërkohë që rreth 60 % të tyre përbëjnë studentët që kanë doktoruar në fushën e inxhinierisë.



BAKTERET NË TASTIERË

Shkenctarët anglezë pohojnë se tastierat posedojnë bakterie më shumë madje edhe se vendet e pista. Ata theksojnë se për përdoruesit e këtyre tastierave si shkak i bartjes së bakterieve u hapet rruga për infektimin e sëmundjeve të ndryshme si; diare, të vjella etj. Ndër bakteriet që bëhen shkas për infeksione të ndryshme, janë kolibasili etj.

Sipas një studimi të bërë në revistën "Which?" janë marrë për eksperiment tridhjet e tre tasteria dhe bakteriet e ndodhura në klavie i kanë krahasuar me bravat e dyerve të tualetit. Shkencëtarët pohojnë se shkak kryesor i përhapjes së bakterieve në tasterie është rënia e thërmiave të bukës ndërkohë që jemi duke përdorur kompjuterin. Ata theksojnë se një shkak tjetër i marrjes së bakterieve është të përdorurit e kompjuterave duke mos qenë të vëmendshëm në larjen e duarve pas përdorimit të tastierave.